ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 9 TETOR 2021. NUMËR 151 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Bashkim Kuçuku, kritik letrar e studiues, redaktor në gazetën letrare "Drita" (1974-1985), kryeredaktor i gazetës "Çamëria-vatra amtare" (1991-1995), kryeredaktor i revistës "Universi Shqiptar i Librit" (1997-2001), është profesor i letërsisë shqipe në Universitetin e Tiranës (1986). Ka botuar dhjetra artikuj e studime në revista shkencore e letrare në shqip, si dhe në gjuhë të huaja, ka kumtuar në Konferenca Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare, në hapësirën shqipfolëse dhe jashtë saj, në Greqi, Itali, Rusi, Bosnjë, etj.

BASHKIM KUÇUKU

Libri do të zhduket kur të zhduket autori dhe lexuesi, njeriu i dijes

Bisedoi Andreas Dushi

TRI DITË KULTURORE NË BERAT

Nga Xhevair Lleshi (fq. 5)

Ditë kulturore? Po, pse jo! Pa merak, aty fshihet edhe libri. Pastaj pa librin s'ka më politika kulturore dhe jo më ditë kulture. Mirëpo kur thua se këto ditë janë në Berat mendja të shkon se gjithçka do të ketë të bëjë me traditat historike, shtëpitë e jashtëzakonshme...

NË HOMAZH PËR MIGJENIN ME RASTIN E 110-VJETORIT TË LINDJES

SHKRIMTARËT QË RRJEDHIN NGA PASARDHËSIT

Nga Rudolf Marku (fq. 6)

PROZËPOEZIA E MIGJENIT NJË REFREN I QYTETIT TEM" – "FRAGMENT"

Prof. dr. Alfred Çapaliku (fq. 7)

SHËNIME PËR LIBRAT

Novelat "Cipa e dëborës" dhe "Heretiku i Mirditës" të Fatos Arapit

DY UDHËTIME NË PYJET E TREGIMTARISË

Nga Alisa VELAJ (fq. 10)

QEMAL DRAÇINI, PAVDEKSIA E KRIJUESIT

Nga Enver Kushi (fq. 11)

(Ramadan Rexhepi: Udhëkryqi, roman, Agoraprint, Shkup, 2021)

DRITËHIJA, KËNDI NGA VËZHGOHET BOTA

Nga Nehas Sopaj (fq. 8)

PYETËSORI "LIBRAT E JETËS SIME"

AGRON TUFA:

Libri që më ndryshoi mendjen? Proza e Kafkës, poezitë dhe esetë e Brodskijt

(fq. 12)

"MENDOVA SE ISHTE NJË RRENG". U SHPREH ABDULRAZAK GURNAH, FITUESI I ÇMIMIT NOBEL NË LETËRSI 2021

Gurnah, i cili ishte në kuzhinë kur u informua për fitoren e tij, nuk besonte se ishte e vertetë.

"Mendova se ishte një reng", - tha ai. - "Këto gjëra zakonisht dalin javë përpara, ndonjëherë edhe muaj të tërë përpara, mbi finalistët, kështu që nuk ishte diçka që ishte në mendjen time. Thjesht po mendoja: kush do ta marrë?"



(fq. 17)

BIBLIOTEKË

Sadik Bejko (fq. 14)
Nuk mund të fle

Susan Hill (fq. 15)
Sugjerim

Enver Cakaj (fq. 16)
Takimi i fundit me Petro Markon

NGA VIJMË? ÇFARË JEMI? KU PO SHKOJMË?

Dr. Bledar Kurti (fq. 20)

TIRANA – GATE 2021, FESTIVALI NDËRKOMBËTAR LETRAR I TË RINJVE

Me rastin e Festivalit Ndërkombëtar Letrar të të Rinjve "Tirana-Gate 2021" në datat 8-10 tetor 2021, Tirana do të kthehet në një pikëtakim me lexues, autorë, përkthyes, shtëpi botuese e kritikë letrarë.

(fq. 22)

BASHKIM KUÇUKU

Libri do të zhduket kur të zhduket autori dhe lexuesi, njeriu i dijes

Bisedoi Andreas Dushi

A. D.: *Profesor Bashkim, së pari, më lejoni të shpreh kënaqësinë e veçantë që ndiej për këtë bisedë, si ish studenti juaj. Dhjetorin e vitit të shkuar, këtu në ExLibris botuat një shkrim se si e kishit realizuar një intervistë me prof. Eqrem Çabejn, kur punonit si redaktor në gazetën Drita. M'u ndërmend thuajse i plotë kur vendosa t'jua propozoja këtë intervistë, pasi provova po atë drojë që përshkruani edhe ju, ndaj shumë faleminderit që pranuat.*

B. K.: Në fillim të bisedës sonë hyri një emër i madh, Eqrem Çabej. Kjo kënaqësi e papritur është «shenjë» mbarësie! Meqenëse jeni shkrimtar dhe studiues i brezit më të ri, më lejoni, të shpjegoj si e mendoj «drojën» tuaj. Ajo, fare mirë, mund të jetë tregues i mirësjelljes dhe i respektit, që keni për bashkëpunëtorët dhe profesorët. Droja ime para Prof. Eqrem Çabejit ishte e njëmendët. Veç njëkohësisë, që jetonim, dhe rastit, që më shpuri në derë të kabinetit të tij, ai ishte shumë larg e lart prej meje. Emri dhe autoriteti i tij «i frikshëm» buronte nga thesari i veprës gjuhësore, gjithashtu, prej formimit shkencor, kulturës, dhuntive të rralla studimore, prej etikës së komunikimit. Brezi ynë, dhe të mëpasmit, që u formuan në Shqipërinë e mbyllur nga të katër anët, për ata që kishin studiuar më parë në Perëndim, madje dhe në ish Bashkimin Sovjetik e në vendet socialiste të Lindjes europiane, kishim adhurim, i shikonim si qenie të një bote të paarritshme. Ata kishin parë mënyra jetese të tjera, kishin mësuar në universitete shekullore, zotëronin gjuhë të huaja, të mësuar me rrënjë aty ku fliteshin. Ne vuanim për këtë inferioritet kulturor. Sa për Çabejin, atë e çmonin për të rrallë edhe miqtë e tij të afërt, të të njëjtës kulturë gjermane, akademiku Aleks Buda, Lasgush Poradeci, Prof. Mahir Domi i kulturës frënge. Profesorët tuaj, të ardhur nga ajo kohë e mbylljes, kanë përvojën shkencore dhe dijet përkatëse. Por ju, në kohën e studimeve dhe në fillimet e karrierës, jeni mjaft më përpara në formim profesional, në kulturë, në liri komunikimi, në krahasim me brezat e mëparshëm, kur ishin në moshën tuaj.

Përfytyroni, për një çast. Dijet e disiplinave, metodat shkencore moderne dhe letërsia bashkëkohore perëndimore të jenë të ndaluara për ju, me rrezik ndëshkimi ligjor, shoqëror e moral. Çfarë do t'i mbetej horizontit kulturor? Cilat do të ishin mundësitë studimore në një kontekst kaq të kufizuar, e, mbi të gjitha, të mbikëqyrur?

A. D.: *Si e kujtoni periudhën, kur keni punuar në gazetën* Drita*? Nuk e di, mund ta përshkruani procesin nëpër të cilin kalonin materialet, shkrimet, tregimet a poezitë, por edhe kritikat para se të botoheshin?*

B. K.: Redaksia e *Dritës*, organ letrar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, për të cilën po pyesni, ishte një vend i lakmuar me xhelozi nga të rinjtë, deri sa nuk e dinin si funksiononte dhe si do të dilnin prej andej. Mendonin, se do kërkohej prej tyre letërsi. Njëmendësisht, kërkohej ideologji. Arti mbetej dytësor, i ndërvarur. Shkoje me dashuri për letërsinë, tjetërsoheshe në përcjellës ideologjik. Zhgënjimi ishte pak.

Atë periudhë e kujtoj të tmerrshme, ashtu, e ndjeja dhe atëherë. Për fat të keq, më pranuan në redaksi pas një plenumi partie famëzi në të cilin u dënua Festivali i 11-të i Radio-Televizionit, që pasoi me ndëshkime të disa udhëheqësve të lartë dhe të shumë shkrimtarëve dhe artistëve. Tehu i ndëshkimit ishte më i prehur se çdo herë tjetër. Kjo nënkuptonte kujdes të skajshëm. Kërkesat e redaksisë u shndërruan në një laborator sterilizimi. Poezinë, tregimin, kritikën e sterilizonte vetë shkrimtari/vetcensura. Në se gjendej "ndonjë qime në perpeq", si thonë në Shkodër, sterilizimin e vazhdonte redaksia/censura institucion. Kryeredaktori thërriste redaktorët, të cilët mblidheshin si thneglat rreth shkrimit, që ngjallte dyshim, dhe, secili e shihte me lupën e frikës së vet. Tek e fundit, në rastet, që nuk gjendej miratim, zgjidhja ishte më e lehtë. Veprohej sipas shprehjes proverbiale "*Po dyshove, hiqe*", e cila kishte dalë nga zyrat e shtypit në aparatin e KQ. Në vitet '70 *Drita* përngjasoi nga Revolucioni Kulturor Kinez, që fshiu edhe Shekspirin e Bet'hovenin. Po të shfletohen koleksionet e saj do të gjenden gjedhe letërsie didaktike për bujqësinë dhe himnizime për industrinë, furrënaltat. Me vështirësi gjendej lënda e numrit me një lloj niveli të pranueshëm në kohë krize. Disa shkrimtarëve me emër e të lexueshëm u ishte hequr e drejta e botimit, disa të tjerë kishin frikë se e pësonin. Rrallë dërgonin krijime shkrimtarë që bënin letërsi. Porta mbetej e hapur për amatorët, krijues punëtorë dhe grafomanë, që mbushnin zyrën e Vath Koreshit, redaktor për krijimtarinë, të cilët nuk ngurronin t'i hakërreheshin, kur nuk u botonte poezitë a tregimin. Varfëri intelektuale e shpirtërore! Mungesë motivesh për të krijuar. Monotoni e frikshme, pa horizont me zëzë mizash, pa probleme, pa debate. Monotoninë gjumëndjellëse e theu poezia e Ismail Kadaresë *Në mesditë Byroja Politike u mbodh*, e njohur *Pashallarët e kuq*, për të cilën pati mbledhje pas mbledhjesh me akuza nga më të rëndat për autorin dhe ndëshkime për redaktorë. (Për këtë ngjarje, tanimë, është botuar dosja).

Për kritikën letrare, redaktor i së cilës isha unë, vështirësitë ishin edhe më të mëdha. Me aq pak kritikë me emër, *Drita* do të duhej të dilte në numra të kufizuar në vit, dhe jo për javë me shkrime studimore, recensione, kryeartikull. Gjithë kohës endesha poshtë e lart me biçikletë, sa në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, në Institutin e Arteve/Akademia e Arteve, në Sallën e Bibliotekës Kombëtare, në shtëpi të bashkëpunëtorëve, duke bindur, apo, qerasur njërin e tjetrin për të nxjerrë shkrimet e numrave.

Kush do kishte dëshirë të punonte në këto kushte dhe rrethana? Unë ngeca atje për njëmbëdhjetë vjet, mezi u shkëputa, pas kërkesave dhe lutjeve të vazhdueshme, i zhgënjyer, që në muajt e parë të punësimit. Nga pikëshikimi i të sotmes, ajo periudhë më duket dhe absurde. Një rropatje me ankth të vazhdueshëm për gabimin e mundshëm fatal, që përfundoje me rrënim!

A. D.: *Përveçse në redaksinë e gazetës* Drita*, ku keni punuar disa vjet (1974 – 1985), keni qenë edhe kryeredaktor në të tjerë organe të shtypit si* Çamëria – vatra amtare *(1991 – 1995),* Universi Shqiptar i Librit *(1997 – 2001). Sot, shpesh nuk ngurrohet të shpallet vdekja e shtypit, pasi ai është shtypur nga interneti. Mendoni se, në ndonjë rrethanë, mund të zëvendësohen nga portale, apo, të tjera forma online të medias?*

B. K.: *Interneti* është një nga shpikjet e mëdha, që ka masivizuar plotësisht gjithë llojet e informacioneve, duke i shpënë në çdo cep të globit, madje dhe në shtresat shoqërore kulturalisht më anësore. Edhe bariu, kudo qoftë, mjafton të ketë lidhjen, për të parë pamjet e fundit nga Marsi, të ndjekë mbarështimin e bagëtive në vende të tjera. Është një lehtësi e madhe e ndërqarkullimit të dijeve dhe të arritjeve më të reja të shkencave; ka zhdukur largësinë e bibliotekave, të cilat, tani, të vijnë në shtëpi; ka minimizuar humbjen e kohës me lëvizje fizike e kuturisje në bibliografi mbetur në rafte të errët, dhe lehtësira të tjera. Funksioni i shtypit është tkurrur dukshëm. Mund të tkurret edhe më. Megjithatë, mbetet i pazëvendësueshëm. Gazetat dhe revistat kanë stafe specialistësh të zgjedhur e të përzgjedhur, procedura të rregullta të miratimit, redaktimit dhe botimit, një "sitë" të hollësishme profesionale, që siguron cilësi, saktësi dhe besueshmëri. Më të pazëvendësueshme janë revistat shkencore profesionale, që, me programe të caktuara porosisin, kërkojnë, mbledhin, verifikojnë saktësinë shkencore dhe botojnë studime për fushat përkatëse. Në se funksionin e shtypit e shohim si fletë letre të shpërndara në kioska, apo, nga postierët me biçikleta, është diçka tjetër. Edhe pse në vend të postierit dhe të kioskave vijnë me postë elektronike, përsëri gazeta mbetet gazetë dhe revista, revistë. Ndryshon mënyra e qarkullimit. Libri, në të cilin hyjnë edhe gazetat e revistat si një trajtë e tij, që nga papiruset e lashtësisë e të mesjetës, te shtypshkronja e Gutenbergut, te rotativa moderne dhe kopjimi elektronik ka ndryshuar lëndën dhe mënyrën e shumëfishimit, por ka mbetur e quhet libër. Pamundësia e zhdukjes së shtypit është e ngjashme me atë të librit. A mund të mendohet bota, jeta, kultura, shkenca, shkolla pa libra, pavarësisht nga lënda në të cilën është shkruar, nga përparimi i teknologjisë së prodhimit dhe të qarkullimit? Tani librat janë edhe elektronikë. Edhe ato

që marrim nga *Interneti* i printojmë, pra, i kthejmë në libra. Edhe DVD-ja, USB-ja janë trajta të tij. Libri do të zhduket kur të zhduket autori dhe lexuesi, njeriu i dijes. Ndërsa, portalet ndihmojnë po të jenë të sakta, dhe pështjellojnë botën me pasaktësinë e tyre. Sidoqoftë, sot për sot, me pasaktësinë dhe mungesën e autoritetit të besueshmërisë, nuk janë referenciale.

A. D.: *Si është për ju gjendja e gazetave dhe revistave, veçanërisht atyre letrare, kulturore e studimore në Shqipëri?*

B. K.: Liri shtypi dhe pafundësi gazetash, siç është në Shqipëri, nuk do të thotë edhe kulturë e cilësi. Shumica e gazetave janë në dorë dhe nën prepotencën e disa gazetarëve amatorë, pa kulturë dhe përgjegjshmëri profesionale, dhe, pas tyre, pronarët botues, edhe më pa kulturë. Ndërsa, kur flitet veçanërisht për revista kulturore, letrare e shkencore në Shqipëri dhe në botën shqiptare të kap dëshpërimi. Zakonisht, revistat kulturore e shkencore, sidomos në vendet e vogla, pa treg të madh, financohen nga qeveritë, konkretizim i politikave të tyre detyruese ndaj publikut. Mirëpo, në Shqipëri ndodh ndryshe. Interesat klanore, politike dhe ekonomike, interesat e bizneseve, ato po i shfarosin. Politikat e qeverive programohen, thuajse, pa revista kulturore, letrare e shkencore. Më qartë mishërohet në fondet e papërfillshme, që caktohen, madje, dhe që u janë hequr prej vitesh. Edhe po të ishin të kënaqshme fondet për kulturën, do të ishin modeste, krahasuar me shpenzimet e jashtëzakonshme për fusha të tjera jo të domosdoshme dhe aq të rëndësishme. Kjo është rruga e analfabetizimit kulturor, ndërkohë, që, studimet letrare dhe albanologjike, në institucionet universitare e akademike janë në ngritje të një hopi cilësor me tregues bashkëkohorë. Mungesa e revistave përkatëse i detyron autorët t'i botojnë vetjakisht, e, për pasojë, pa ndonjë impakt, ose, t'i mbajnë në sirtar.

Për një dorë të vogël paresh nga ministria, që të dilte rregullisht, sipas kalendarit *Studime Filologjike* janë dashur "tendera" të ndërlikuar, të cilët u "ngatërruan" dhe u vonuan gjatë. Redaksia u detyrua të përmblidhte disa numra e vite bashkë. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, në Universitetin e Tiranës, nxori periodiken cilësore *Studime Albanologjike* me studime, që kanë hyrë ndër vlerat albanologjike. Nuk kaluan veç disa vjet dhe qeveritë hoqën financimin. Është krijuar *Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit*. Për të përcjellë politikën kulturore të librit, ajo do të duhej të kishte revistën, buletinet dhe katalogët e vet, pa u kthyer në "pjesë" përplotësuese e burokracisë qeveritare. Ministria e Kulturës do të duhej të financonte, të paktën, një revistë dhe një gazetë letrare e kulturore, të pavarura e të lira, në mbështetje të kulturës e të letërsisë. Gazeta *Drita*, revista *Nëntori*, ndoshta, edhe me emërtime të tjera, fare mirë mund të mbaheshin me projekte të saj. Në Prishtinë vazhdon revista 75 vjeçare *Jeta e Re*, duke ruajtur e përtërirë një traditë. *ExLibris*, me dashamirësinë e themeluesit dhe botuesit Bujar Hudhri, është e vetmja gazetë letrare e rregullt, që mban gjallë ndërkomunikimin letrar shqiptar në të gjitha trevat dhe në diasporë. Nëse do të kishin një dashuri të tillë për letërsinë, kulturën, edhe botues e biznesmenë të tjerë, nuk do të ishin kaq të rralla revistat e gazetat e këtij lloji.

A. D.: *Që nga 1986, jeni profesor i letërsisë në Universitetin e Tiranës. Si e shihni cilësinë e studentëve që zgjedhin letërsinë si fushën së cilës duan t'i përkushtohen? Ndonëse besoj se mund të jetë edhe një proces dinamik, sipas jush, është në rënie apo në rritje interesi i studentëve lidhur me fushat e kritikës apo studimit të letërsisë?*

B. K.: Studentët janë me formim dhe interesa të ndryshme. Ata që zgjedhin letërsinë, së cilës me bindje do t'i përkushtohen: mësues, studiues, apo, shkrimtarë, kanë formim të kënaqshëm, ose, të lartë. Në thelb, ata e bëjnë universitetin të jetë i tillë. Studiojnë me pasion, bëjnë dhe provat e para hulumtuese e studimore të lavdërueshme. Për disa vjet shkruajnë monografi studimore me tregues bashkëkohorë dhe fitojnë gradën shkencore *Doktor i Shkencave Filologjike*. Këto ish studente dhe ish studentë, që sot janë profesorë në universitete dhe institucione studimore, me monografitë doktoruese kanë risuar studimet letrare. Interesimi për kritikë dhe studime letrare ka qenë i madh edhe më parë, por mundësitë e përgatitjes qenë të kufizuara. Me sistemin e Bolonjës, 3+2, u krijua mundësia e përgatitjes dhe interesimi u rrit. Mendoj, se interesimi do të bjerë për pamundësi punësimi. Institucionet e larta arsimore dhe studimore, tanimë, janë të plotësuar, prandaj, pranimet e reja janë rralluar.

Ka dhe studentë, më të shumtë, që nuk kanë qëllim përkushtimin ndaj letërsisë. U intereson thjesht mësuesia për të fituar një vatër të sigurtë punësimi. Studentët e tjerë, këta janë shumica, me që nuk përballojnë degë të tjera gjejnë strehë te dega gjuhë dhe letërsi shqipe, sa për të kryer studimet universitare e për të zënë një qoshe. Mirëpo, ndodh që i hyjnë politikës. Atëherë, ka prej tyre që zënë poste qeveritare e ndenjëse deputeti. Këta kalojnë se duhen kaluar dhe janë e keqja e shkollës, ku do të japin mësim, natyrisht, të varfër, në mos të gabuar, për dhjetëra vjet. Për këta universiteti është vend bamirësie e jo diturie.

A. D.: *Meqë e përmendëm pak më lart, lidhur me kritikën letrare, ku kontributi juaj është vërtetë i çmuar, si e shihni gjendjen e saj sot? Filtri i saj është i atillë që vërtetë të diktojë e orientojë lexuesin drejt vlerave, apo ka mungesa që manifestohen në gjendjen e sotme të letërsisë shqipe?*

B. K.: Kritika letrare nuk është dukuri vetjake, subjektive, as thjesht çështje e pasionit të disa individëve, sikurse është trajtuar në botën shqiptare. Ajo është institucion, shkencor e shoqëror, që zhvillohet, përkrahet e mbështetet me investime intelektuale, infrastrukturore e financiare nga politikat kulturore të një vendi. Nga që nuk është kuptuar e zbatuar kështu, ka një histori jo të këndshme. Frytet e saj, sporadike e të shkëputura, pa formuar sistem, nuk kanë qenë ndonjëherë të kënaqshme. Në asnjë periudhë nuk ka arritur të mbulojë procesin letrar e të jetë faktor ndikues i ndjeshëm. Ka qenë dhe mbetet inferiore, në shpërpjestim të madh me letërsinë rrjedhëse. Ose ka heshtur, ose ka folur e nuk është dëgjuar, ose, ka folur gabim dhe ka qenë pengesë me mospërkrahjen e risive. Dikur, në vitet 1970-1980, në Prishtinë, kishte kritikë me formim modern bashkëkohor, që vunë në dukje kahet e reja risore të letërsisë shqipe atje dhe ndikuan në zhvillimin e tyre. Shkrimeve debate të asaj kohe u referohemi edhe sot. Në Shqipërinë shtetërore, në kuptimin e mirëfilltë, ishte penguese, sepse anatemonte dukuritë risore, që nuk pranoheshin për realizmin socialist.

Në periudhën e lirisë së mendimit, sidomos në ditët e sotme, kritika e medias, që të ndjekë në vijimësi ecurinë e procesit letrar, për nga niveli, thuajse, është e paqenë. Shkrimet, që botohen në suplementet letrare të të përditshmeve a periodikeve më shpesh janë studime dhe hulumtime të karakterit historiko-letrar. Kritikat profesionale, me qasje shkencore dhe kulturë bashkëkohore, me objektivitetin e mundshëm të kësaj fushe, janë aq të pakta, me shkëputje kohore, sa nuk ka se si të ndikojnë në ecurinë e saj. Megjithëse në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, në Universitetin e Tiranës, ka mbi pesëmbëdhjetë vjet, që është hapur dega për kritikë e studime letrare, vështirë të gjesh në këto gazeta e revista më tepër se dy-tre të specializuar. Pa hyrë në shpjegime shoqërore, kulturore, arsimore a shkencore, shkaku zanafillor i pranisë së saj të papërfillshme, në të shkuarën dhe në të sotmen, është larg në kohë, në një mendësi paternaliste, të trashëguar nëpërmjet familjes, të shpërndarë në rrjetën shoqërore e të sanksionuar në sistemet politike, që kanë kaluar. Mendësia shqiptare tradicionale, madje dhe bashkëkohore, në përgjithësi, nuk e pranon kritikën e asnjë lloji: as politike, as shoqërore, as shkencore, natyrisht, edhe letrare. Vetë redaksitë nuk tërheqin kritikë të përgatitur. Bashkëpunëtorët, që mund t'u afrohen, nuk shpërblehen, si kudo në botë. Në vende të tjera, gazetat e revistat, edhe kur nuk kanë kritikë me emër në redaksitë, kanë të atashuar. Përkundër tyre, në suplemente gazetash e revista të llojit politik e reklamues vijojnë të dalin shkrime amatorësh, gazetarësh me formim të dobët, apo, pa formim të përshtatshëm, pikënisja e pikëmbërritja e të cilëve është miqësia me autorin e veprës, interesi brenda një klani, interesa të tjera pragmatiste. Shkrime të tilla e shtyjnë lexuesin në drejtim të gabuar, duke e larguar nga letërsia art, nga ana tjetër, e lënë atë një ishull të shkëputur, ku mund të shkojnë vetëm robinsonët e pasionit letrar. Kjo gjendje, jo motivuese, më saktë, penguese, i ka detyruar kritikët specialistë të kalojnë në fushën e studimeve.

A. D.: *Pas një grushti dekadash, kur u lejua të shkruhej vetëm sipas modelit të realizmit socialist, rënia e sistemit dhe ardhja e demokracisë sollën një çlirim edhe të modeleve letrare, që mund të lëvroheshin. Kjo liri, u përdor ashtu sikurse duhej nga shkrimtarët shqiptarë?*

B. K.: Njëmendësisht ishte një çlirim i madh për shkrimtarët, që me mundime Sizifi mezi e kishin shtyrë për të identifikuar veten dhe jetësuar letërsinë. Dolën krijimet, që prej vitesh ishin në sirtar, emra disidentësh, të dëgjuar diku e nëpër të, dhe të panjohur më parë. Një pjesë e shkrimtarëve të afirmuar e përballuan sfidën e lirisë, që për ta, ishte kërkim dhe përftim risish. Kishin pasur në vetvete akumulime të pashprehura, tej skemës ideologjike. Pikërisht, atëherë gjetën barazpeshimin krijues në poetikat e ndaluara të modernizmit dhe pasmodernizmit. Të tjerë nuk patën aftësinë të dilnin nga ngurtësia, që la trysnia e censurës. Me disa kozmetika, krijimtaria e tyre e pasrealizmit socialist nuk u shndërrua në një tjetër lloj, nuk e përballoi dot "konkurrencën e lirisë", të poetikave e të gjedheve të ndryshme njëherësh. Ndërkohë, dolën shkrimtarë të rinj, që sot janë të afirmuar. Periudha tridhjetëvjeçare, e larmisë së poetikave e të gjedheve, e eksperimenteve të suksesshme dhe të dështuara, kryesisht, zotërohet prej prozës dhe poezisë së tyre.

Por, si çdo gjë në botën shqiptare, edhe liria e të shprehurit u përdor dhe u keqpërdor. Të gjithë ata, që kishin pasur dëshirë, apo, ëndërr të bëheshin shkrimtarë, edhe pse nuk kishin dhuntinë e kulturën (këtë nuk e ditën kurrë), menduan, se me lirinë e të shprehurit, të nesërmen në mëngjes ishin shkrimtarë. Vërshuan me qindra romane, vëllime me poezi e tregime, po ashtu, kritika, që përbëjnë një amalgamë *aletërsi*, në mos më keq, të shtrirë në përmasa më të mëdha se vetë letërsia. Për të kapur "peshkun e artë" kritika dhe lexuesi duhet të llapashiten në këtë "përmbytje"! Humbje kohe dhe energjish, të cilat, edhe pa të, na mungojnë. Barazpesha natyrale e letërsisë është e rrezikuar nga gërryerja e saj!

A. D. : *Keni përgatitur për botim apo redaktuar disa libra të shkrimtarëve të njohur shqiptarë si Ismail Kadare, Bilal Xhaferi, Ali Podrimja, Dritëro Agolli e të tjerë. Të punosh me librin e tjetrit... Si është për ju kjo eksperiencë?*

B. K. : Secila, duke të afruar, edhe më me veprën, nëpërmjet bisedave me autorin është përvojë më vete. Mbresa të bukura kam nga përzgjedhja dhe strukturimi i antologjisë së poezisë *Litari i ankthit* të Ali Podrimjes dhe *Lutjet e kambanës* të Dritëro Agollit. Është kënaqësi e madhe, që, shkrimtari të lejon ta rindërtosh veprën e tij, sipas vështrimit dhe ndjeshmërisë tënde, të jep të drejtën e një bashkautorësie, pa u shqetësuar se mund t'i shpërbësh imazhin, që ka krijuar me të te lexuesi. Mirëbesimi është vlerësim. Bëhej ndërmjetës mes tij dhe lexuesit me pëlqimin e autorit, përbërës i veçantë, që mungon në studimet e tjera të zakonshme. Në këtë përvojë ke mundësi të vëresh drejtpërsëdrejti nga shkrimtari, e jo përmes metaforave të letërsisë, pëlqime, koncepte, obsesione, manira të tij, me një fjalë, ta kuptosh edhe më mirë veprën.

A. D.: *Në vitin 2008 keni përgatitur për botim një antologji të poezisë shqipe bashkëkohore. Duke ju pyetur brenda kontekstit të studiuesit, mbi ç'kritere bëhet përzgjedhja e autorëve në një antologji, pasi sot, dalin shpesh antologji, ngritur mbi themele të paqarta e për fat të keq, më së shumti me shije subjektive?*

B. K.: Teorikisht ndërtimi i një antologjie letrare është i lehtë dhe krejt subjektiv. Ka aq antologji letrare sa mund të jenë autorët hartues. Dhe aq të tjera, sa ç'janë kriteret e ndërtimit, të cilat janë të lloj-llojshme, që nga tematike, deri te më e rëndësishmja, që ka qëllim të vetëm cilësinë artistike. Pasi vetcakton kriterin do t'i jesh besnik skrupuloz. Shkelja e tij rrezikon shpërbërjen dhe dështimin e antologjisë. Praktikisht, më e vështira është ajo e cilësisë së artit. Në rastin e saj, subjektivizmi shndërrohet në objektivizmin më të mundshëm. Po si? Çdo





antologjist është subjektiv. Përmbledhja me poezi, ose, tregime, që hartohet për disa muaj a një vit, kur nis punën konkrete, është fryt i një përvoje të gjatë studimore vetjake, dhe përimtim i studimeve të të tjerëve, i njohjes së formave të përhapjes së tyre, ribotime, recitime, citime, i popullarizimit, i përkalimit në arte të tjera, përkthimit e vlerësimit në gjuhë të huaja. Këto të ndihmojnë, në se ke durimin dhe aftësinë t'i kulmosh në atë të famshmin subjektivizëm i objektivizuar, me një fjalë, përzgjedhja juaj të jetë edhe pëlqimi, shija e lexuesve me ndjeshmërinë më të hollë.

Ideja dhe nisjativa e *Antologjisë së poezisë shqipe bashkëkohore* ka qenë e Ali Podrimjes, antologjisti i intuitës dhe përzgjedhjes më të përkorë, hartues i disave të tilla. Kishte biseduar me mikun e poetin akademik, Jevrem Brkoviq, për projektin e një antologjie të poezisë shqipe bashkëkohore në gjuhën malazeze, të cilën ai e kishte mirëpritur me entuziazëm. Brkoviqi shkroi dhe parathënien në *Ukradeni plamen/Flaka e vjedhur*, *Antologija savremene albanske poezije*, DANU/Dukljanska Akademija Nauka i Umjetnosti, Pogorica, 2009. Përveç këshillave dhe përzgjedhjes së poezive të dy-tre autorëve nga Kosova, librat e të cilëve nuk i kisha, Aliu përzgjodhi edhe poezitë e Azem Shkrelit, punë të cilën nuk ia besonte kujt, në emër të nderimit të kujtimit të mikut e kolegut të ngushtë. Pas kësaj, natyrshëm, mua dhe Aliut, na lindi ideja për ta nxjerrë edhe në shqip, duke e zgjeruar dhe ndryshuar në përshtatje për lexuesin shqiptar. *Onfuri* me dashmirësi e përkushtim e botoi me një dizajn të hollë «poetik».

A. D.: *Në një botë të stilizuar sipas formatit të fshatit global, ku gjithkush ka akses kurdo e në gjithçka, letërsia realiste a e ka "bastin e humbur" qysh në ngjizje?*

B. K. : Varet se çfarë kuptohet me "letërsi realiste". Realizmi, në forma e në mënyra të ndryshme, është i përjetshëm në letërsi, për të mos thënë i pashmangshëm. Edhe në romanin modern e modernist shqiptar, me disa përjashtime, madje, në disa raste, edhe në atë pasmodernist, ku më shumë e ku më pak, i dukshëm e i padukshëm, është i pranishëm. Çdo përngjasim, shëmbëllim me realitetin është realizëm. A ka prozë, që mos të niset e të mos shëmbëllejë në përmasa të ndryshme, sipas poetikave, me realitetin? Ai merr aq trajta dhe forma, sa trajta e forma marrin tregimi, novela dhe romani në evolucionin e tyre kohor, dhe, anasjelltas. Në letërsinë frënge, që prej shekullit XIII, është rishfaqur e përtërirë gjithnjë e më përfshirës. Në se me "letërsi realiste" kuptohet gjedhja e romanit të shekullit XIX të Balzakut, Floberit, Dikensit, Tolstoit, apo, të fillimit të shekullit XX të Gollsuorthit, është diçka tjetër. Ajo është gjedhe e papërsëritshme plotësisht, ndonëse, përbërës të saj ndërfuten në gjedhet e romanit modern e pasmodern. Realizmi disave, sidomos të vetquajturve modernistë dhe pasmodernistë, iu duket «gogol» nga që *à priori* e paragjykojnë vjetërsirë e pengesë, disave se nuk ia dinë pashmangshmërinë, ose, janë të paaftë për ta ushtruar. Mendoj, se do të ketë një rikthim, një përtëritje të tij në përshtatje me kulturën bashkëkohore të shkrimtarëve dhe të lexuesve. Me kohë vërej një lloj rikthimi te përbërës të poetikës së tij. Kam parasysh edhe ndonjë vepër (*Nënshtrimi*) të Huelbekut/Houellebecq. Edhe në letërsinë shqipe. Zejnullah Rrahmani kanë qenë në avangardë në vitet 1970-1980. *Romani për Kosovën* (2000) është një rikthim te mjaft përbërës të realizmit, brenda strukturës dhe përftesave moderne. Romanet e Fatos Kongolit (1992-2000) janë të një realizmi psikologjik në struktura moderne e moderniste. *Im atë donte Adolfin* (2005), *Hotel Arbëria* (2010), *Prishtina* (2018) të Mehmet Krajës zotërohen prej tij, ndërkohë, që, proza, në përgjithësi, e mëparshme dhe e mëpasme, zotërohet prej një ironie dhe paradokseve të modernizmit e të pasmodernizmit. Përbërës të tillë, apo, struktura të tërësishme realiste ka, gjithashtu, në proza të Bashkim Shehut, Visar Zhitit, Agron Tufës.

A. D.: *Lidhur me letërsinë postmoderne, asaj që përmbys çdo nocion logjik e logjistik për hir të eksperimentimit... Kur shkruhet a tregon rritjen apo tkurrjen e shkrimtarit?*

B. K.: Ushtrimi i trajtave të pasmodernizmit në vetvete nuk tregon as rritje, as tkurrje të shkrimtarit, pa një referencë konkrete, bie fjala, vlera të artit letrar. Poetikat nuk ka vlerë në abstraksion. Dhe asnjë nuk siguron paraprakisht suksesin, ose, dështimin. Ka shkrimtarë që, në kuptimin e dominantes, kanë kaluar nga realizmi në modernizëm e pasmodernizëm me sukses, pse jo, që kanë dalë edhe prej realizmit socialist. Të tjerë prej modernizmit në pasmodernizëm. Ka që e kanë filluar me trajta të pasmodernizmit dhe kanë qenë të suksesshëm, sikurse ka të tjerë, që dinë të ushtrojnë vetëm trajta të poetikave pasmoderne dhe nuk kanë përftuar vlera. Më e keqja, që nuk shpie në përftim vlerash letrare, është të mos kesh dhuntinë, apo, aftësinë e ushtrimit të poetikave të ndryshme. Shkrimtarët që dështojnë me pasmodernen janë, pikërisht, ata që nuk zotërojnë poetikat e tjera, sepse, pasmodernizmi është kolazh, ndërthurje e përzierje e tyre.





A. D.: *Letërsia shqipe, në gjendjen e sotme, rri me dinjitet përballë letërsive të tjera? Dhe, lidhur me këtë, a ndikon fakti se gjuha shqipe është relativisht e vogël, pra, ka pak lexues të mundshëm?*

B. K. : Letërsia shqipe sot, dhe prej gjysmë shekulli, kryesisht, me veprën e Ismail Kadaresë, si dhe, më vonë, të autorëve: Fatos Kongoli, Ali Podrimja, Bashkim Shehu, etj., është denjësisht pjesë e letërsisë europiane, sepse është në treguesit cilësorë të saj, e çmuar edhe prej kritikës. Këtë e argumenton vepra e Ismail Kadaresë, e botuar, në mbi dyzetë e pesë gjuhë të tjera dhe e përcjellë me disa mijëra shkrime. Disa romane të tij parashihen edhe në programe shkollore, parauniversitare e universitare, shoqëruar me studime metodike.

Në cilësinë dhe mirëpritjen në gjuhë të tjera nuk ndikon numri i folësve të asaj gjuhe prej nga vjen, as i lexuesve potencialë a të njëmendët/realë. Jo rrallë letërsitë e gjuhëve, që fliten nga disa milionë, kanë dhënë vepra, që janë bërë të përbotshme, nderuar edhe me Çmimin Nobel. Sikurse, letërsi të gjuhëve, që fliten nga dhjetëra e qindra milionë jo të gjitha kanë arritur këto maja.

A. D.: *Një pjesë e studimeve tuaja, përfshirë edhe "Enciklopedi kadareane", botuar në vitin 2020, në tri gjuhë: shqip, frëngjisht e anglisht, në të cilën jeni bashkautor me prof. Jorina Kryeziun, i janë kushtuar Ismail Kadaresë. Ajo çka ju tregoni, pra, përkthimi i tij në 45 gjuhë (kam parasysh "Kadare në gjuhët e botës", botimi III, sh. b. "Onufri", 2015) si e ka ndihmuar gjuhën apo letërsinë shqipe?*

B. K. : Vepra e Ismail Kadaresë ka hapur rrugën e letërsisë shqipe, që po integrohet përherë e më tepër në tërësinë e letërsive europiane, më ngadalshëm edhe në atë botërore. Krijoi besueshmërinë për botimin edhe të autorëve të tjerë, ndihmesë e jashtëzakonshme, po të kemi parasysh, se deri atëherë, letërsia shqipe, nuk njihej, veç nga disa albanologë. Me njohjen e saj është rritur interesimi për kulturën, historinë, traditat, gjeografinë, turizmin. Duke i përfshirë këto zëra në tekste të ndryshme, u zgjerua rrethi i lexuesve të saj.

Funksioni i saj ka ndikuar, sado pak, edhe në njohjen dhe përhapjen e gjuhës shqipe. U shtua numri i përkthyesve. Krahas atyre që ishin më parë, e mësuan edhe të rinj, ndonjë deri në Japoni për të pasur mundësi të përkthejnë nga gjuha mëmë.

A. D.: *Nëse kanonizimet e gjuhëve në botë ndodhin kryesisht për shkak të shkrimtarëve (italishtja me Danten, anglishtja me Shekspirin), gjuha shqipe a shpërfaqet në maksimumin e pastërtisë dhe qashtërsisë ashtu sikurse e përdor Kadare?*

B. K. : Pasuria më e madhe e shqipes është mishëruar, nëpërmjet gjuhës standarde, në dhjetë mijë faqet e veprës letrare të Ismail Kadaresë, pa përfshirë eseistikën dhe publicistikën e tij. Konsolidimi i qëndrueshëm i gjuhës standarde, rritja e madhe e shprehësisë letrare është bërë, në radhë të parë, nëpërmjet saj. Megjithëse, ai vazhdimisht ka ndërfutur fjalë e shprehje të gegërishtes, ka kalkuar fjalë e ka përdorur në shqip shumë fjalë, që në përditshmëri janë barbarizma nga gjuhë të tjera, nuk mund të thuhet, se shqipja shpërfaqet në maksimumin e shprehësisë së saj. Dhe, mendoj, se në veprën e asnjë shkrimtari, sado e madhe të jetë, nuk arrihet të shpërfaqet gjuha, në tërësinë e vet, maksimalisht. Vetëm mund ta përfaqësojë atë maksimalisht. Në vështrimin tonë, tabloja e pasurisë dhe e shprehësisë së shqipes plotësohet me poezinë dhe prozën e Martin Camajt në gegërisht, me prozën e Mehmet Krajës, që standardin letrar, të ushtruar mjeshtërisht, e ndërthur, pa thyer kanonet e tij, me pasuri nga gegërishtja, dialekti i prejardhjes së vet nga hapësira veriperëndimore shqiptare. Pjesë e plotësimit të kësaj tabloje janë edhe ndihmesat e disa autorëve të tjerë, që kanë filluar të përtërijnë traditën e gegërishtes letrare.

A. D.: *Profesor, shpesh kur studentët zgjedhin degët pas maturës, bëjnë dy pyetje, që po jua shtroj dhe juve, lidhur me letërsinë: a) Ç'më duhet mua letërsia? dhe b) Ç'i duhet botës letërsia?*

B. K. : Në kuptimin praktik e pragmatist, po, e pohoj edhe unë. Letërsia sot iu duhet vetëm shkrimtarëve, profesorëve, studiuesve, lexuesve të pasionuar. Masivisht, thuhet se, nuk i duhet askujt, sepse lexohet dhe investohet gjithnjë e më pak për të. Në se do të ndodhte njëmendësisht, që mos t'i duhet shoqërisë letërsia, do të ishte fatkeqësi e madhe. Njeriu dhe shoqëria do të prireshin nga aemocionalja, ashpirtërorja dhe aintelektualja.

Në kuptimin ideal, kulturor e shpirtëror emocional, në periudha krizash shoqërore, errësire diturore është edhe më e domosdoshme. Njeriu modern nuk mund të mendohet pa letërsi e arte, veçse të mbetet brenda i zbrazët shpirtërisht dhe emocionalisht. Shumësia e leximit, si dhe kënaqja lëndore dhe mirënjohja intelektuale, që mund të mungojnë, sidoqoftë, janë dytësore. Parësore janë vlerat që krijohen. Sa lexues ka pasur Dantja dhe Shekspiri në kohën e tyre? Sa lexues ka pasur De Rada, Naim Frashëri, Ernest Koliqi, Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli, Migjeni, madje dhe Gjergj Fishta? Ndërsa, në absolut, në vite e shekuj, lexuesit e tyre janë bërë e do të bëhen me miliona dhe shtohen pafundësisht. Thesaret e mëdha të bibliotekave janë si akullnajat e Arktikut, që, në shekuj, ushqejnë pa u ndjerë përtëritjen e jetës. Letërsia ushqen përtëritjen e njeriut dhe të shoqërisë. Gjenetikisht, ajo lindet përmes sakrificave përkushtimore dhe shpërblehet me përjetësi. Le të kujtohet më çfarë sakrificash e përkushtimi kanë shkruar Prusti- i shtrirë në shtrat nga sëmundja; Xhek London - mes varfërisë, i papranueshëm në rrethet letrare. De Rada- në varfëri dhe me fatkeqësi familjare; Naim Frashëri- i sëmurë dhe i mbyllur në shtëpi me roje mbikëqyrëse; Migjeni- i sëmurë; Petro Marko- i burgosur dhe pa të drejtë botimi; Kasëm Trebeshina, në burgje dhe internime; Zef Zorba- me poezitë në sirtar deri në vitet më të fundit të jetës; Martin Camaj- larg atdheut, ku nuk flitej shqip, zyrtarisht i përjashtuar nga letërsia shqipe, i ndaluar për lexuesin; Bilal Xhaferi- i papranueshëm politikisht, punëtor krahu, duke u endur kantiereve të hidrocentraleve. A mund të themi, ç'ju duhej këtyre letërsia!?

A. D.: *Folëm për kritikën dhe rolin e saj, por dua t'ju pyes, për një tjetër përbërës të ndërlidhjes shkrimtar – lexues: editorinë. Si e shihni gjendjen e saj në Shqipëri?*

B. K. : Editoria, në kuptimin e plotë profesional, thuajse, është shpërbërë. Janë vetëm disa shtëpi e ente botues, që i përgjigjen, ose, bëjnë përpjekje t'i përgjigjen standardit bashkëkohor të botimit. Shkaqet janë të ndryshme. Ndër të tjera dhe financiare. Me lexues të kufizuar të një vendi të vogël, dhe lexim, që pakësohet vazhdimisht me rënien e kërkesave arsimore e kulturore, është vështirë të mbash gjallë një editori të tillë. Që në fillim të pluralizmit, ajo u ngjiz me një keqkuptim. Në të vërshuan tipa me interesa thjesht tregtie, që nuk çanin dot në fusha të tjera. Ata që kishin formimin e përshtatshëm dhe pasionin për të zhvilluar kulturën e librit ishin të paktë. Prandaj, dhe sot mund të ketë vetëm katër- pesë shtëpi botuese me standardin bashkëkohor. Editoria, e keqpërdorur, e kthyer thjesht në shtypje e tregtim librash, pa treguesit e domosdoshëm cilësorë, është e para që e çorienton lexuesin. Pas botuesve, që edhe për tridhjetë vjet nuk kanë mësuar as vetë të shkruajnë me kulturë, por me amatorizmin e dikurshëm, mbytur me figura kakofonike, vijnë "kritikët" e të njëjtit nivel, lavdëruesit retorikë, që e drejtojnë lexuesin aty ku nuk duhet, në mediokritet.

TRI DITË KULTURORE NË BERAT ME GAZMEND TOSKËN

Nga Xhevair Lleshi

Ditë kulturore? Po, pse jo! Pa merak, aty fshihet edhe libri. Pastaj pa librin s'ka më politika kulturore dhe jo më ditë kulture. Mirëpo kur thua se këto ditë janë në Berat mendja të shkon se gjithçka do të ketë të bëjë me traditat historike, shtëpitë e jashtëzakonshme, lagjet që mbeten në sy dhe pastaj çdo gjë tjetër që kanë vetëm pikë loti e floriri. Por ne i filluam ditët me poezitë e Visar Zhitit, me Nënë Terezën dhe i mbyllëm me Simon Vrushon dhe Muzeun Solomon. Në to ishte dora dhe kujdesi i të gjithëve që nga Gazmend Toska, djali i Beratit që ndan Francën me Shqipërinë, që kur të sheh në sy ti fiton tjetër dritë. Ajo që të bën përshtypje është sjellja disi e shpërqendruar dhe elegante prej biznesmeni, buzëqeshja tipike, argumentet që t'i thotë në sy dhe i bindur krejt se vetëm ashtu mund të arrihet gjithçka...

Dita e parë.

E kisha lënë të takohesha me Visar Zhitin në një lokalet e Qendrës së Tiranës. Po flisnim pë ditët e tij në Amerikë (Çikago), po edhe për librat e tij, veçanërisht për librin «Kartelat e realizmit të dënuar», botuar nga «Uegen», duke menduar edhe si do ta promovonim në Berat. Në mes të bisedës me të, merr në telefon Gazmend Toska dhe më thotë se këto takime do të kulmonin me ditën e Muzeut 'Solomon' dhe Simon Vrushon, duke ruajtur kureshtjen e madhe të ditës së dytë me Nënë Terezën. Mori pohimin tim, natyrisht edhe angazhimin e plotë dhe vijuam me Visarin. Kështu dita e parë në Bibliotekën «Vexhi Buharaja», do të tërhiqte një vëmendje solemne në diskutimet e Namir Lapardhasë, Yzedin Himës, Balil Gjinit dhe vetë Visar Zhitit, i cili ditë më vonë do të promovonte librin më të ri «Dorëshkrimet e fshehta të burgut» me poezi siç i kishte shkruar në burg, botuar nga «Onufri» nën kujdesin e shkrimtarit të ri Andreas Dushi. Kurse me librin «Kartelat e realizmit të dënuar» u njohëm me një prurje të re të një letërsie që na bën përshtypje me arkitekturën e gdhendur me tjetër material, letërsi e skalitur krejt ndryshe, me nervin e zemërimit, të ironisë së fuqishme dhe të sarkazmës therëse... Dëgjimi ishte i plotë dhe kurimi nga aktorë beratas i dha ngjyrë krejt të veçantë, jo thjesht me kompetencën e fjalës, por sidomos me interpretimet ku dilnin poezitë përplot dhembje dhe forcë e qëndresë, ku sipër si aureolë fluturonin lulet. Visar Zhitit iu dha çmimi «Vexhi Buharaja» për përkthimin më të mirë, një çmim modest, por me domethënie të madhe.

Dhe do të vinte Dita e dytë.

Gazmend Toska, industrialist, që kudo nuk harronte të nënvizonte se ekonomia fillon të mëkëmbet dhe pastaj të ngrihet fuqishëm vetëm duke eksportuar. Është një forcë që të jep mundësi të jashtëzakonshme, e cila ndërton edhe prosperitetin, duke na çuar vetiu tek ëndrra. Industrialisti Gazmend Toska, inxhinier me përvojë, është i angazhuar edhe në kulturë. Mendimi i tij për të krijuar edhe Fondacionin kulturor buron nga fitimet e industrisë së tij tekstile në Shqipëri, për t'i dhënë mundësi jo vetëm investimit të mëtejshëm në prodhim, po pjesa më e rëndësishme në kulturë: në rrugicat e mahnitshme, në portat e mëdha, në muzetë e vjetër e të rinj, në Kala dhe në shtëpitë karakteristike, në trashëgiminë e veshjeve dhe në folklor, në një sofat madhështor, kopsht të madh, pemët në parqe e sidomos me zbulimin e tij: kam gjetur, thotë, kudo në botën e qytetëruar, në Berlin, në Londër, në Paris një gjë të veçantë dhe aq ngashënjyese, *Kosheret e Librave»* vitrina libri në rrugët dhe kryqëzimet e tyre, duke pasur pranë një institucion që e ka në kujdes dhe e shfrytëzon si shërbim. Kjo vitrinë që do ta çelë tiparin në Berat është vërtet e bukur. Kalimtari, operuesi me muzetë, apo me një aksh institucion social apo kulturor, e sheh librin dhe në bashkëveprim me punonjësit e tyre mund ta prekë e të shërbehet si bibliotekë, ose si shërbim tjetër. Në muzé, hotel, shoqatë, apo institucion tjetër, libri regjistrohet dhe qytetari e merr për ta lexuar. *Kosherja e librave* është një dritë tjetër zhvillim... Gazmendi të përthith mendimet me sjelljen, qëndrimin dhe gëzimin rinor që u dhuron të tjerëve.

Asaj dite të dytë Visar Zhiti kishte ruajtur një të papritur për Nënë Terezën. Eda, e shoqja, kishte skicat e çmuara të Maks Velos për Nënë Terezën, dhuruar asaj gjatë kohës kur shërbente në ambasadën tonë në Vatikan. Skicat e Maks Velos, dymbëdhjetë, (edhe numri është domethënës, ka të bëjë me apostujt!) të krijonin asaj dite me diell, si një dhuratë e çmuar, tjetër solemnitet, tjetër gumëzhimë, më tepër se hijerënda (nuk bën gabim edhe po të thoshe si në tragjeditë e Shekspirit), veç me një hir mistik kështjelle, pranë e pranë dhe një e tërë, duke u bërë publike dhe tërheqëse. Dom Lush Gjergji ishte aty si një autor i veprës për Nënë Terezën, po edhe promovues i kësaj pune të çmuar nga dora e një artisti të veçantë si Maks Velo. Po edhe koleksionistja Eda Zhiti-Agaj i dha ngjyrë tjetër.

Ishte një mbresë e mahnitshme, veçmas ajo ekspozitë e fisme, jo e heshtur, me njerëz përreth, me mërgimtarë të ardhur që e gjetën veten të befasuar, që një e dy dhe këndonin me mall - si t'i bënin serenatë qytetit, që e fshihnin enkas moshën, që merrnin fuqi se qenë të vjetra sa s'thuhet. Edhe skicat për Nënë Terezën morën moshën e pritjes antike. Diçka e shenjtëruar.

Zot, thashë me vete, kujt po ia them këto, këtyre që kanë ruajtur Kodikët e famshëm, Epitafin e Glavinicës, tavanet e mahnitshëm, apo ndonjë kërkuesi të çmendur të idealizmës, që e donin dhe vraponin pas ëndrrës së tyre, siç ishte fjala vjen Simon Vrushoja ynë, me «Princin e Gjurulldisë» së tij, si një novelë që do të jetë gjithmonë aty, pranë gjërave më të çmuara që ka Berati ynë.

Dhe natyrshëm iu drejtuam Ditës së tretë, në muzeun 'Solomon'.

Sa takova Angjelina Gërmau-Vrusho, zonjën e Simonit, shoqja ime, me të cilin dikur kemi punuar në një nga shkollat e fshatrave, po shihja veten dhe sallën e re të muzeut «Solomon», frymën me të cilën qe krijuar, e gjitha një dëshirë e vjetër, në ish lagjen hebreje të Beratit *Holeku i famshëm i Mesjetës.* Dhjetë metra më lart se vendi ku e themeloi Simoni. E di ti, më thoshte Simoni, po ta kisha shtëpinë këtu në *Holek*, po ja që s'desh fati ta kem, do ta kish kthyer shtëpinë në muze të Hebrenjve! Ç'thua mo! Eej! S'do të kishte gjë më të bukur! Ja këta burra e gra i kanë pritur dhe kanë ruajtur, me një kujdestari të çmuar nga Kadri Cakrani po edhe nga zemra flori, e varfër vërtet, po e bukur sa më s'ka, e shqiptarëve. Me ditë e ditë të tëra e kemi diskutuar. Dhe ai e bëri edhe librin «Hebrenjtë e Beratit», edhe muzeun «Solomon», si brenda një dite, një çasti, një fryme. «Ai, Simoni, po ta thoshte një gjë, e bënte! S'i ndahej!» thotë Angjelina. Kurse Visar Zhiti shton: I pata thënë që «Hebrenjtë e Beratit» bëhej një roman i famshëm! Simoni më dëgjonte dhe përtypte mendime. *Holeku* ishte tani edhe më i mahnitshëm. Dhe krejt muzeu 'Solomon', padyshim është një nga ato rekuizitat Shekspiriane, që të fusin thellë në mendime. Se një jetë hebreu të shpëtuar nga shqiptarët (dhe në krejt botën vetëm nga shqiptarët!) është një kryevepër botërore, po ama, të mos harrojmë se çdo jetë hebreu, siç thotë mjeku hebre-beratas Zino Matathia, që tashmë jeton në Izrael, është një tragjedi më tepër se Sheksipiriane...

Muzeu dhe Fondacioni «G. Toska» organizojnë kësaj dite të tretë, pa simbole pagane e as biblike, të njohin muzeun «Solomon» si i dalë nga dheu, pas ngritjes së një kohe dhe mikpritjeje, po edhe bese, për t'u n johur më pas me udhë përmes jetës dhe krijimtarisë së Simon Vrushos, diskutimeve përskaj fakteve, kujtimeve, ku rëndom hidhet dritë për artefakte edhe të mistershëm.

Ishte një mbresë e mahnitshme, veçmas në analizat e kumtesave të mbajtura, me një përshkrim fisnik, krejt të vërteta (si të vërtetat e Simonit!), me plot njerëz brenda, ose vetëm me ndonjë personazh që ai e donte dhe rrinte një kohë të gjatë me ta. Ata ishin shumë dhe pothuaj të gjithë kishin mërguar, edhe te Simoni mund të gjeje një të tillë, që, një e dy e këndonte, si në brinjë të Velçanit, duke i kthyer fjalët në këngë e këngët në fjalë, pa rrëfyer moshë, por që ishin aq të vjetra sa s'thuhet. Dhe duhet ta them: kishin moshën e pritjes antike...

Zot, kujt t'i thoshe, një ngacmim! Atij? Kurrë! Vetëm nëse doje ta bëje keq mund t'i shkaktoje shkëndija, po edhe atëherë bëhej më tepër skrupuloz, një kërkues i çmendur i idealizmit, që e gjente dhe e humbte kudo dhe kurdoherë dhe i vihej sërish ta gjente prapë, duke e hequr branë këmbën, i mbushur me entuziazëm dhe pasion të tillë që unë nuk e kam parë kurrë, në një ëndërrim të paparë e të famshëm. Varfëri e madhe dhe e pa mendueshme! Atje në mes varfërisë mund ta takoje, ashtu vetëm, të menduar, sikur përpiqej t'i ndreqte ditët, t'i bënte të barabarta, si mendimet, idealen dhe realitetin. Ai, ndonëse i pakënaqur, mund të rrëfente:

- Kushdo mund të gënjehet në këtë jetë. Më kupton? Ne gënjejmë veten kur themi se me këtë jetë që bëjmë do të mbetemi «shkëmb graniti», heronj! Por kjo ndodh në përralla! Dhe përrallat di t'i mbajë ngrohtë vetëm Tomori, mali i shenjtë!...»

Simon Vrusho kërkonte shumë, zgjidhte, i linte, i zinte, koha ikte, ai mbetej më tepër te një mbresë. Peng i asaj mbrese do të ishte për një kohë mjaft të gjatë! Kështu e mbushte veten me frymëzim dhe ushqente pasionin e skajshëm, se aty kishte zemrën që ia ushqente. Sepse e kishte kuptuar mirë! «Atdheu ndërtohet me material zemre!» Ose duhej të shpërthente: «Po. Njerëz! Binduni pak dhe kundërshtoni shumë, se bindja e verbër të çon në skllavëri të plotë! (Uollt Uitman- Fije bari)» Ndaj dhe mbeti Sizif, duke ngjitur shkëmbin në malin e drejtësisë njerëzore, i gatshëm për sakrificë! Nuk e tha kurrë që e arrita një gjë. E di ç'do të thotë kjo? Të pranosh atë që s'është e vërtetë për sytë që të duan. Po unë kam forca, prandaj nuk dua të iki, dua të luftoj këtu!... Nuk ndodhi kurrë që ai të shfytyrohet. Nuk shiti mend, nuk u fry, as u ligështua, nuk u shtrembërua nga dita e vështirë, as edhe nga dhimbjet... Nuk e duronte kurrë varfërinë e shëmtuar, duke luftuar sidomos varfërinë mendore, sepse varfëria ishte bërë varg poetik që vetëm këndohet me tekë në këtë

vendin tonë. Dhimbja për ekzistencën e saj ka qenë vazhdimisht tek ai! Aty duket se ishte ndryrë përgjithmonë. Bëhej keq dhe mezi mbushej me frymë. Kur zinte në gojë këtë dukuri bëhej thellësisht i trishtuar, më i trishtuari dhe më i ndërkryeri njeri që kam parë.

Aty në një cep pranë dritares është vepra e tij e vjetër dhe e re, që do të jetë tek ne e sidomos te brezi i ri, që duhet mësuar, ndonëse ai më thoshte gjithmonë: «Miku im, sa mirë do të ishte që ky qytet i rrallë, ky qytet si askush tjetër në botë, të jetë edhe QYTET I LIBRAVE, edhe pse ato sot nuk i ka qejf njeri e gati s'përdoren më, ndoshta se janë lodhur e mëritur me ne...» Kjo është e vërteta themelore e Simon Vrushos, dija, libri, jeta e bukur dhe dëshirat tronditëse. Dhe amaneti i tij që ky qytet të bëhet botërisht QYTET MUZE, QYTET I UNESKOS dhe QYTET I LIBRAVE... E veçanta e patjetërsueshme e Simonit tonë, dashuria e tij e pafundme, e cila fare thjesht e me një projekt të respektueshëm ai merr jetë thjesht, ashtu siç ndërtohet shoqëria jo me fjalë të fryra, por me material zemre. Një qytet librash do të thotë edhe qytet bibliotekash e librarish, do të thotë qytet që e ka të gdhendur në ballë fotografinë, duke u kujdesur edhe për jetën e dikurshme mesjetare në Kala (si në filma e programe televizive *live*, me skena të gatshme që do ta kishte zili arti botëror, aty, pra, ku ai (Simon Vrusho) punoi si mësues i thjeshtë për shumë e shumë vite me radhë dhe krijoi veprën e tij të madhe e të fuqishme!...

Po pse i librave, i thashë.

E di, më tha, sepse aty, në Kala, u ruajtën në breza Kodikët! I fundit rojë ishte Nasi Papapavli... Më pas vjen ikja e librave, bërë krejt fizike, por që mbetet peng dhe bëhet morale. Ma kupton ku dua të dal? Me librat e prek më bukur mjeshtërinë, të dalin përpara malet edhe më madhështorë dhe ditët marrin një bukuri të veçantë, elegancë. Tani qyteti i librave do të ketë punë me këto ditë që s'bëhen kurrë si i duam ne. Dhe kridhej në mendime me vetminë dhe atë trishtimin e tij që e tërhiqte përherë e më tepër në ditët që do të sillnin përmbysjen e madhe. Berati ynë i ngjan një katedraleje përplot me qirinj. Dhe kur ne largohemi qyteti ynë i famshëm ndez në çdo portë qiririn dhe ashtu i kërrusur bëhet gati të nisë si gjithmonë udhë të rejapër një histori tjetër, se tashmë e kishte aq pranë njeriun... Vetëm kësaj i gëzohej Simoni, duke iu gëzuar mendimeve të Solomonit, tanimë në stendat e muzeut të mbrojtjes dhe shpëtimit të hebrenjve.

Nesër enciklopedia e popujve do të shkruajë: Shqiptarët janë populli i vetëm që e duan dhe e nderojnë fenë tjetër një me të tyren! Dhe se ata qenë të vetmit në botë që shpëtuan hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore... Dhe, edhe sikur vetëm këto të qenë janë sa dy kryevepra botërore që do të lexohen me respekt gjatë shekujve që vijnë...

Me rastin e 110-vjetorit të Lindjes

Një homazh për Migjenin:

SHKRIMTARËT QË RRJEDHIN NGA PASARDHËSIT

Nga Rudolf Marku

1.

Jemi mësuar që në letërsi, dhe përgjithësisht, në krijimtarinë artistike, të mendojmë për paraardhësit që ndikuan më së tepërmi në krijimtarinë e autorëve. Te Asdreni duken qartë gjurmët dhe pëlqimet e Naim Frashërit. Te Lasgush Poradeci mund të ndjesh afërsitë e Asdrenit dhe të Emineskut. Proza e Mitrush Kutelit shfaq dukshëm pëlqimin e Nikola Gogolit, ashtu si dhe tregimet elegante dhe njëkohësisht dramatike të Ernest Koliqit të afrojnë me tregimet e Pirandelos. Në letërsinë botërore Walt Witman ka dhënë Pablo Neruden, Karl Sandberg dhe poetin beat generation Allan Ginsberg, po të përmendnim veç disa prej dishepujve të poetit të madh amerikan. Në letërsinë dhe në krijimtarinë artistike ky fenomen është ndër më të natyrshmit, sepse, siç na thonë plot mendimtarë dhe shkrimtarë të shquar, fundja e gjithë letërsia botërore është veç një libër i vetëm, dhe ne vetëm sa shkruajmë ca radhë në këtë libër të madh. Borhesi nga ana tjetër thoshte se është e pamundur që të mos imitosh. Puna është që të jesh i paimituar.

Por në këtë rregull të madh, ekzistojnë dhe ca krijues të një race tjetër: ata që nuk kanë paraardhës. Në letërsinë shqipe i tillë është Migjeni. Shkrimtarët si Migjeni, paradoksalisht rrjedhin jo nga paraardhësit e tyre, por nga pasardhësit e tyre. Janë krijues, vepra e te cilëve dominohet nga parandjenja e asaj që do të vijë në letërsi e në art. Janë krijues që përcaktohen nga një kohë që vjen pas vdekjes së tyre, dhe jo nga koha që ka ekzistuar më parë. Migjeni dhe shkrimtarët si Migjeni e presin rrjedhën e kohës. Për ta koha rrjedh nga e ardhmja tek e sotmja.

2.

Shekulli i XX do të mbetet në histori si shekulli i Proceseve, na thotë Milan Kundera. Ne do të përmendnim vetëm shkrimtarët, artistët dhe mendimtarët që u akuzuan gjatë shekullit të njëzet. Në vitet njëzet të shekulli të kaluar, viktimat e Gjykatës së Moralit të rreptë Revolucionar janë Andre Bunin, Andrejev, Shostakoviç, Bulgakov, Isak Babel, Ana Ahmetova, Mandelshtajm, Pasternak, Solxhenicin, Celine, Knut Hamsun. Jo më larg se në vitin 1999,



një kryetar Bashkie në Francë refuzoi që në shtëpinë e lindjes së F. Celin-it të vendosej një pllakë përkujtimore. Pas tyre presin radhën për t'u gjykuar nga Proceset naziste: Breht, Thomas Mann dhe Heinrick Mann, Lorca që vritet në mënyrën më absurde... Vijnë pastaj grupi që akuzohet si i përlyer me Musolinin, Sain Jon Perse dhe më i madhi prej tyre, Ezra Pound, i mbajtur në një kafaz hekuri në diellin përvëlues të qytetit Piza nga ushtria amerikane. Por kjo nuk do ta shpëtojë vepren e Ezra Pound që të gjykohet rreptas nga komunistët, si një vepër e errët dhe e pakuptueshme. Tek ne mjaftojmë të kujtojmë sulmet dhe denigrimet ndaj Fishtës, Konicës, Koliqit dhe Kutelit, të quajtur koloboracionistë - një term aq i pëlqyer prej ca mendjeve të klasit të katërt dhe sot e kësaj dite - bash prej atyre që kolaburuan me jugosllavinë titiste, rusinë staliniste dhe Kinën e revolucionit kriminal kultural... Një grup shkrimtarësh dhe krijuesish gjykohen njëherazi nga komunistët dhe fashistët: Pier Paolo Pasolini është një komunist që shpreh haptazi simpatinë e tij të thellë për Ezra Pound, duke u bërë njëherësh armik i së majtës dhe i së djathtës. Po këtë kish bërë në vitin 1954 Ernest Heminguej. Dhe kjo tregon fare qartë se, duke përdorur ambalazhin e sulmeve politike, në fakt këta Procese e kanë me veprën artistike.

3.

Në asnjë vend tjetër të botes së Qytetëruar Proceset nuk kanë qene më të suksesshme se sa në vendin tonë. Ngase vendi ynë ka patur dhe vazhdon të ketë një legjitimitet të konsoliduar të perandorisë Osmane, që predispozon një bezdisje të qitabxhive të administratës kundër mendimit intelektual dhe kundër krijimtarisë.

Pasi kemi dënuar Fishtën, Konicën, Koliqin, Mitrush Kutelin, Vincent Prenushin, Ndoc Nikajn, Lazër Shantojën, i jemi kthyer shkrimtarëve botërorë, duke dënuar me tonet me serioze Bodlerin, Verlenin, Rembon, Pikason, Kafkën, John Updike-n si shkrimtarë imoralë dhe dekadentë që duheshin mbajtur sa me larg nga lexuesi ynë i panjollë dhe i virtytshëm. Edhe Kadare shpesh herë i nënshtrohet një Procesi të dyfishtë: në kohen e Komunizmit ai konsiderohej nga gjykuesit puritan si tepër i dyshimtë dhe si rrënues i kështjellës së Komunizmit; në periudhën postkomuniste shpeshherë ai akuzohet nga të njëjtit gjyqtarë hipokritë si një njeri që ka bërë flirte me komunizmin.

4.

Nga shumë njerëz naivë mendohet se Migjeni akuzohet si një shkrimtar ateist dhe antiklerikal. Për këtë arsye, mendojnë ata, si mund të qëndrojë Migjeni në të njëjtin komunitet letrar me Fishtën a Lazër Shantojën? Si mund të qëndrojë Migjeni në të njëjtin komunitet me shkrimtarë , ta zemë, si Ernest Koliqi, Martin Camaj apo Arshi Pipa?

Ashtu si të gjithë shkrimtarët e talentuar, Migjeni shpesh herë, në mënyrë të heshtur, është vënë në bankën e të akuzuarve për shkak të krijimtarisë së tij. Njerëzit mediokër nuk e durojnë talentin dhe mendimin e lirë. Është historia e vjetër e Mozartit me Salierin. Jo domosdoshmërisht me Salierin krijues. Salierë të politikës, të mendimit estetik, Salierë të kritikës letrare dhe të mendimit letrar, Salierë të administratës. Mendimi se Migjeni nuk përkujtohet nga arsyeja se ai është antiklerikal, ateist dhe përkrahës i komunizmit është një mit i shpikur nga gjykatësit modern që duan ta fshehin arsyen e vërtetë brenda një ambalazhi imponues politik.

Mendimi (i shprehur a i pa shprehur) se Migjeni dhe Fishta, Koliqi, Prenushi, Anton Arapi, përjashtojnë njëri-tjetrin është një mendim spekulativ, po aq sa dhe mendimi tjetër, se Migjenin ndonjëherë përpiqen ta vendosin në rrethinat e letërsisë shqipe nga shkaku i klerit katolik. Imzot Zef Simoni, në librin me studime nga letërsia shqipe ("Letërsia e parë ndryshe"), i jep një vend të veçantë Migjenit, duke e çmuar së tepërmi talentin e tij dhe kontributin e tij në letërsinë tonë. Ernest Koliqi qe ndër njerëzit që e ndihmoi pa rezerva Migjenin, duke e çmuar ndër të parët talentin e tij. Por mendimi se shkrimtarë të ndryshëm përjashtojnë njëri-tjetrin, është një mendim që nuk ka të bëj me letërsinë dhe gjykimin estetik të saj. Mendimi i pranuar natyrshëm se një letërsi është më e pasur kur ka zëra nga më të ndryshëm, duket se nuk ngjet te ne. Uniformiteti i mendimit në jetën shqiptare ka përpunuar shije te dyshimta sidomos tek gjykuesit zyrtar të letërsisë. Shija e kritikes shqiptare, e përpunuar në ca punishte universitare, ka këmbëngulur dhe vazhdon të këmbëngul që orkestra simfonike duhet të përmbaje vetëm një a dy instrumente

frymore, dhe vetëm kaq. Por neglizhimi i Migjenit do të ishte po aq i mëkatshëm sa ç'ishte dje dënimi i Fishtës, Konicës dhe i Koliqit. Sepse Letërsia e vërtetë është pranuese, jo përjashtuese. Sidomos jo përjashtuese për ca arsye të politikës së ditës.

5.

E gjithë krijimtaria e Migjenit jo vetëm që nuk i kundërvihet Krishterimit, por në të kundërt, është në thelb e krishterë. Nuk them se është klerikaliste, them se është e krishterë. Nuk është faji i Migjenit se spekulantë të ndryshëm u përpoqën që rebelizmin niçeanian të tij ta keqpërkthejnë në simpati të komunizmit ("Të Lindet Njeriu" ka madje si nëntitull Dithiramb Niçean). Nuk është faji i Migjenit që spekulantë të proceseve shpikin si element determinues të krijimtarisë së Migjenit miqësitë e paprovuar me Vojo Kushin e panjohur a me furrtarin terrorist Vasil Shanto a me ca personazhe minore të grupeve komuniste të Shkodrës. Të gjitha këto një studiues i përkushtuar ndaj principeve estetike i injoron lehtësisht si të parëndësishme për analizën e veprës së Migjenit.

Migjeni shkrimtar i krishterë? - do të thonë në mënyrë jokomforte shumë lexues. Them se po, ngase Migjeni në të gjithë krijimtarinë e vet ka një ndjeshmëri të jashtëzakonshme kristiane për të ndjerë vuajtjet e të tjerëve. Ka një ndjeshmëri të pabarabartë me asnjë shkrimtar tjetër të letrave shqipe për t'iu afruar të vuajturve, të pangopurve, lypsave dhe prostitutave, zhelemelave dhe fëmijëve të leckosur, për t'u bërë njësh me to. Migjeni ka një dhembshuri kristiane në gjithë krijimtarinë e vet. Dhe nëse ai konfrontohet me klerikët, këtë e bën se ai mendonte se klerikët kanë filluar ta harrojnë varfërinë dhe mjerimin e të varfërve. Kanë filluar ta humbasin ndjeshmërinë për të ndjerë varfërinë... Kjo ndjeshmëri e bën Migjenin ndoshta shkrimtarin më të krishterë të letërsisë tone. Është e vërtetë se Migjeni jo rrallëherë paraqet lypsat nën hijen indiferente te kishave e te xhamive. Por kjo nuk e pengon Migjenin që të jetë një shkrimtar i krishterë. A nuk ishte dhe Shën Françesku ai që kritikonte në kohën e vet mosndjeshmërinë e priftërinjve ndaj të varfërve? Skepticizmi ndaj klerikalizmit nuk e përjashton mbrojtjen dhe simpatinë e thellë për Krishterimin. Dhe në kritikën e Migjenit nuk ka malicitet, nuk gjejmë atë cinizmin e mbrapsht të Niçes; ka vetëm një dhembje njerëzore për ata që sot, më tepër se kurrë, janë të përjashtuar nga letërsia shqipe si të padenjë për t'u marrë si objekt i saj.

Në mendjen time Migjenin gjithmonë e kam përqasur me poetin anglez Wilfrid Oëen. Wifrid Owen i vrarë në moshën 23 vjeçare. Migjeni vdekur në moshën 27-vjeçare. Një poemë te Owenit të titulluar "Pandjeshmëri" mund ta kishte shkruar në të njëjtat rrethana dhe Migjeni. Sepse asgjë nuk ka urryer më shumë poeti ynë se sa pandjeshmërinë. Atë pandjeshmëri që është normë morale e jetës së shoqërisë sonë në kohërat moderne të shekullit të XXI.

PROZËPOEZIA E MIGJENIT "NJË REFREN I QYTETIT TEM" – "FRAGMENT"

Prof. dr. Alfred Çapaliku

"Me Migjenin fryn nëpër letërsinë shqiptare një frymë e re, të thuesh e paprovueme deri më atëherë."
Qemal Draçini - (Malseni). Shkodër, 16 - 18 Fruer 1940.

PROZA DHE POEZIA NË BOTIMET PËR SË GJALLI

Millosh Gjergj Nikolla (Shkodër, Shqipëri 13 tetor 1911 – Torre di Peliçe, Torino) me emër arti Migjeni, e dha premierën letrare me 27 maj 1933 pëmes prozës "Sokrat i vuejtun - apo derr i kënaqun" tek revista "Illyria" në Tiranë, në pragun e 22 vjetorit, ndërsa ishte mësues i gjuhës shqipe në shkollën "Skanderbeg" të fshatit Vrakë, 7 kilometra larg Shkodrës.

Ai e mbylli siparin artistik në gusht 1938 përmes poezisë "Vuejtja" tek revista "Kombi" po në kryeqytetin shqiptar, pa i mbushur 27 vitet, ndërsa po shuhej në një sanatorium italian.

Brenda këtij harku kohor, kur talenti i tij frenohej nga fataliteti, frekuenca e prozës së Migjenit, publikuar në shtypin letrar të Tiranës dhe në atë të Korçës, lëviz dukshëm. Me 1934 boton pesë proza, me 1935 po aq, me 1936 nëntë, me 1937 vetëm një dhe me 1938 dy krijime në atë gjini.

Gjithsej ai paraqiti njëzet e dy skica të larmishme.

Pjesa më e madhe dhe mjaft e rëndësishme e prozës së tij i mbeti në dorëshkrim dhe e pashfaqur në publik, ndoshta nga dyshimi i përsëritjes së censurës së ushtruar ndaj vëllimit poetik, ndoshta nga mungesa e kohës, ndoshta nga gjendja e "opus incertum"- it që e shoqëron artistin serioz në plotësim e përsosje, ndoshta nga sulmi i bacilit vdekjeprurës të tuberkulozit.

Proza e botuar në gjallje të autorit është e shkurtër, e ngjeshur, e detajuar, figurative, emocionuese, simbolike, novatore, ritmike, gjenerative, përndryshe e shkruar në teknikat e poezisë moderne.

Kjo përshtypje krijohet realisht mbasi paralel me prozën, në pesë vitet e krijimtarisë së ethshme, poeti - uragan i ndërprerë boton në revistat e kohës, me 1934 dy poezi, me 1935 katër, me 1936 tre dhe po atë vit njëzet e gjashtë poezi të reja në librin **"Vargjet e lira"**, me 1938 vetëm një.

Janë gjithsej tridhjetë e gjashtë këngë (kështu i quante autori vjershat), që formojnë pothuajse krejt veprën e tij poetike.

Ndarja në cikle përmes nëntitujve të volumit me vjersha: **Kangët e ringjalljes, Kangët e mjerimit, Kangët e Perndimit, Kangë në vete, Kangët e rinisë, Kangët e fundit**, ka marrë diçka formale nga emërtimi i skicave në prozë: **Alternativë. Dilem. Fragmentet e jetës. Fragmentet e rrugës. Rrota e jetës. Novelzë.**

Thotë studiuesi Ali Xhiku:

*"Për t*ë poezia nuk kishte kurrfarë bu*rimi të fshehtë ose hyjnor, ndërsa akti krijues, para se të sendërtohej në letër, shfaqej si përjetim i gjithëfarshëm emocional, si meditim, tërësisht e vazhdimisht objektiv, mbi vëzhgimet e përditshme."* (1)

Poezia e botuar në gjallje të autorit është portretizuese, kaleidoskopike, e drejtpërdrejtë, befasuese, intriguese, dikotomike, origjinale, e çlirët. Shkurt, e shkruar në teknikat e prozës introspektive.

Ky stil kombinatorik, prozë - poezi dhe poezi - prozë, iu kthye Migjenit në bivalencë. Gjithnjë e më tepër ai kultivon prozën poetike me problematikë në përmbajtje dhe me finesë në formë. Përherë e më shumë në aktshkrimin poetik autori u largohet vargjeve të metruara, rimave të përpikta, strofave klasike, duke iu drejtuar shkulmit të vargjeve të lira në ndarje monokolone.

Poeti Fatos Arapi vëren se Migjeni:

*"... e këndon këngën e vet ashtu si i vjen drejtpërsëdrejti; pa e ndrydhur brenda kanoneve, por përkundrazi duke e lënë të derdhet ndërgjegja e tij artisike, fare lirshëm, të plazmohet, t*ë *marrë trajtën, formën e natyrshme të saj."* (2)

Trilli poetik dhe eleganca e prozës bashkëjetojnë natyrshëm në ligjërimin e tij para lexuesve.

"NJË REFREN I QYTETIT TEM"

Kjo skicë u botua në revistën "Illyria" viti I, numër 19, Tiranë, 15. 07. 1934, faqe 4. Është një nga prozat miscelanea më të veçanta të Migjenit ku luhet formnalisht gjer në ekstrem me kalimin nga proza steriotipe në prozë poetike dhe më pas, nga kjo e fundit, në poezi të mirëfilltë. Parapërgatitja nis që në titullin e saj, përmes asonancës: ***refren*** dhe ***tem***.

Në pjesën e pare të saj luhet me ritrnin përsëritës *"... ma fal ndoj send!"* gjer në kakofoni, mbasi këtë melodi mund ta këndojnë vetëm trotuaret e qytetit. Luhet me muzikën e Mozartit e të Bethovenit gjer në tallje, mbasi tingujt, s'mund t'i shijoinë njerëzit barkbosh. Luhet me koloritin romantik gjer në absurd, mbasi muzgu panoramik shuhet në refrenin *"... të lutem, zotni..."*. Migjeni luan në prozë njëlloj si në poezi.

Drejt një balance shkon mendimi i studiuesit Sabri Hamiti për skicat letrare të këtij autori:

*"... n*ë *të cilat rishfaqen në një trajtë tjetër temat e poezisë."* (3)

Në pjesën e dytë të saj nga i gjithë qyteti veçohet një lypës i vogël pas një zotnie të

(Vijon në faqen 9)



(Ramadan Rexhepi: Udhëkryqi, roman, Agoraprint, Shkup, 2021)

DRITËHIJA, KËNDI NGA VËZHGOHET BOTA

Nga Nehas Sopaj

Vepra e parë e shkrimtarit Ramadan Rexhepi, **Kumbonaret,** është libër me tregime dhe novela e botuar nga *NGB Rilindja* e Prishtinës në vitin e largët, 1963 që autorin e radhit në mesin e prozatorëve më të spikatur të kohës siç janë R. Kelmendi, A. Pashku dhe A. Shkreli. Po ndryshe nga këta autorë, miq të tij, të cilët krijuan dhe vepruan në atdhe, autori ynë u ndalua dhe lançua, dhe mu ashtu siç shkruan në titull faqja e tij elektronike, *Pulëbardha krahthyer*, atij i qenë "këputur flatrat e fluturimit". Me kalimin e kohës, ky libër nuk do të harrohet dhe duke qenë me peshë të veçantë artistike dhe kombëtare, ai do të shaptilografohet, ribotohet dhe lexohet dorë më dorë. Autori sot pas vetes ka një mori veprash tjera të botuara jashtë vendit, por edhe më shumë se 1100 faqe janë shkrime me shënime që presin të papublikohen një ditë. Romani **Udhëkryqi** i botuar sivjet, fillet e tij i ka shumë heret, në vitet '60 dhe autori atij i qe kthyer disa herë, herën e parë me titullin **Stina e emrave të bukur** botuar nga Sh. B. Valtoni nga Prishtina në vitin 2010 dhe në fund **Udhëkryqi**, që paraqet kryevepër, një nga veprat e rralla të letërsisë bashkëkohore shqipe me vlera estetike në nivel kombëtar.

Dritëhija, hija e zbehtë e ambientit ku shkrimtari i zhvillon ngjarjet që i përshkruan në veprat e tij letrare, pra, jo vetëm në romanin e fundit **Udhëkryqi** por edhe te **Kumbonaret**, paraqet grimasën intime të autorit, ose thënë ndryshe, sekretin e zanatit të tij, këndin intim prej nga autori e konfiguron sa veçantinë, po kaq edhe individulitetin letrar. Gjithçka lidhet me këtë konfigurim, e këtillë është figura e shkrimtarit dhe ky është mikrokozmosi intim që lexuesi e mëson nga shkrimet e tija. Rrëfimi në romanin **Udhëkryqi**, por edhe rrëfimi te **Kumbonaret**, më saktë novela *Natë mbi saraje*, në mënyrë të drejtpërdrejt flasin për hijen, këndin prej nga shkrimtari e observon dhe shkarkon totalitetin e realitetit objektiv, gjithçka që lind frymëzimin gjer në katarsën e autorit. Kjo është shtylla e grimasës intime ku ai i plason rrëfimet, i përshkruan ngjarjet, i skalit personazhet, krijon vendstrehimin ku lexuesi mëson për të vërtetat që s'i ka njohur, e zhyt kredon, shfaq dilemat, hamendet dhe në fund kënaqet i dehur nga ekzaltimet që ka lexuar, ngopet nga magjia e rrëfimit. Dritëhija është karremi i rrëfimit të tabllove impresive të ngjarjeve që i përshkruan autori, "hija me pak dritë", pra dritëhija me kuptimin i mimezisit (frymëzimit), po kaq edhe të katarsës (zbrazjes) me të cilën lë të kuptohet kah po lëvizin ngjarjet që i rrëfen shkrimtari, shtegu ku mund të lëviz kurreshtja e lexuesit, horizonti i pritjes së tij. Ajo mjeshtri që shpesh na duket e padukshme, në fakt është manir dhe kredo e rrëfimit, është intimitet i shkrimtarit që e bën atë autonom, origjinal, të papërsëritshëm. Kategoria e hijes dhe e dritës, ngjyresa emocionale e rrëfimit kur lexuesi ndjen se është pushtuar qindpërqind nga ajo që po lexon, është kënaqësia e leximit dhe ngopja estetike e veprës.

Në letërsinë e përbotshme, titulli **Udhëkryqi** nuk është i panjohur nga llojllojshmëria e zhanreve të ndryshme që i krijojnë artistët, por një vit pasi u botua ky roman i Ramadan Rexhepit, me po këtë titull e botoi Flora Brovina romanin e saj dhe kjo gjë vetëm sa e vërteton faktin se titulli në fjalë së rresht së përdoruri nga shkrimtarët, gjë që s'prish punë nëse veprat janë të ndryshme dhe gjithçka mbetet vetëm tek titulli. Në veprën e autorit tonë që nga faqet e para, lexuesi ndesh botën e brendshme të personazheve, ngjarjet dramatike që i ka në spikamë ai dhe mu në kapërcyell të këtyre ngjarjeve, në brendi të njerës nga kaptinat ku rrëfimi është më dramatik, në shprehje vijnë dilemat apo çështjet enigmatike që duhet zgjidhur, kurse te ndonjë nyje ku shkrimtari i kthehet rrëfimit nga fillimi, arrihet te "udhëkryqi" ku ai e ndjek, zhvillon dhe zgjidh qëllimin kryesor të romanit. Sipas konceptit të autorit, vendosja e protagonistit të romanit, Ilir Kelmendi që të sakrifikojë gjithçka për kauzë kombëtare, qoftë edhe me një flijim të ri pas daljes nga burgu, lexuesi sikur e gjen të gatshëm të gatuar atunë e romanit, edhe atë mu në këtë titull. Kjo, sepse në ndërgjegjen e pjekur të të burgosurit, "udhëkryqi" paraqitet si rrugë të patjetërsueshme, shteg apo ideal të vetëm të cilin duhet vazhduar, si para burgosjes ashtu edhe pas udhës së re dhe të cilën e trason vetëm njeriu i dinjitetshëm. Kjo është ndërgjegja e gatuar mirë nga autori dhe mirë e nënkuptuar nga lexuesi. Kështu, titulli **Udhëkryqi** është universal dhe nuk mund të ketë përkufizime logjike, atë lexuesi mund ta perceptojë si të dojë. Rrëfimet e gjera me personazhet e shumtë që përbëjnë orkestrumin e fateve nga më të ndryshmet, brenda dhjetë kapitujve të gjerë të romanit me rrëfimet nga më të ndryshmet, jo një herë lexuesit do t'i shfaqet *udhëkryqi si ide/dilemë* se çka e pret atë perspektiva romaneske. Gjatë përcjelljes së udhëkryqeve jetësore të protagonistëve kryesorë të romanit, Ilirit dhe Shegës, sidomos pas monologut të brendshëm të këtij të parit, madje edhe pas "humbjes" së tij nga skena, lexuesi hutohet nga ndryshimi i pozicioneve të narratorit duke kërkuar kuptimin e udhëkryqit që e ka pritur. Paqartësitë mund të lindin pra, nga ndryshimet e pozicioneve të cilat shëtisin mes kuptimit të titullit dhe domethënieve jo vetëm të një udhëkryqi, por të disa prej udhëkryqeve. Kjo, sepse pas këputjes së perspektivës së Ilirit dhe ardhjes në epiqendër të Shegës (më vonë edhe të Hatixhes), udhëkryqit, gjatë rrëfimeve tjera, i shtohet një udhëkryq tjetër, siç është shfaqja e Seksionit të B. (Sekretariati i Punëve të Brendshme në kohë të Jugosllavisë titiste) me çka rrëfimi dramatizohet edhe më shumë me kurdisen e një aktakuzë të rrejshme kundër Ilirit, gjoja se ai e ka vrarë Stanko Popin. Kështu, krahas dy personazheve me dy linjat kryesore që i ndjek rrëfimi i romanit dhe që i presupozojnë dy udhëkryqet pararendëse, i shtohet edhe udhëkryqi i tretë, të cilin mund ta emërtojmë "udhëkryq ideologjik", që paraqet një prerje vertikale të rrëfimit sipas ngjyresës së gjuhës romaneske.

Titulli në fakt është edhe tema e romanit. Ngjarjet zhvillohen në vitet '50 dhe '60 të shekullit të kaluar, kurse ambienti ku i lokalizon shkrimtari ngjarjet, janë Presheva, Kumanova, Gjilani dhe Shkupi, ambienti i Karadakut i cili qindpërqind paraqet kronotopin e temës: udhëkryqin veri – jug, lindje – perëndim me ngjarjet ndër më dramatiket historike shqiptare të kohës së shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi nga trojet e tyre etnike, nën thundrrën e egër çetnike. Në historinë e romanit shqiptar, një roman i cili përkon shumë me romanin **Udhëkryqi**, është romani shumë i njohur **Tradhëtia** me autorin problematik Kapllan Resuli që lexuesit e njohin si një shkrimtar që disa herë kish ndërruar identitetin kombëtar dhe që mu për këtë arsye s'do të duhej ta përmednim po të mos ishin artefaktet artistike që përkojnë shumë mes njeri tjetrit dhe që lexuesi kurioz s'mundet ta anashkalojë atë fakt brendaletrar që kanë këto dy vepra. Presheva, "Shqipëria e Vogël" siç jemi mësuar ta quajmë në fëmijëri, në këtë vepër na shfaqet me të gjitha elementet e atij frymëzimi kombëtar të shkrimtarit ku autori R. Rexhepi, edhepse ka lindur, është shkolluar dhe është profilizuar atje, atë si artist dhe intelektual, shumë heret pushteti komunist jugosllav e dëbon nga gjiri i saj duke ia pamundësuar kthimin deri në përmbysjen e këtij regjimi antishqiptar. Tema është shumë transparente dhe e hapur për ta sendërtuar një histori të letrarizuar siç e bën autori, në të përplaset gjithçka që është e mirë me të keqen, si dy skaje të kundërta mes njera tjetrës, të cilat autori me besnikëri e paraqet frymën e kohës, mentalitetin dhe botëkuptimet e saj, të shkrira me të tanishmen me qindra paradokset që ka sot ajo. Figura e Ilir Kelmendit pandan figurës antipode të Zhika Kërvopijës, janë dy këto pole të kundërta, të viktimës dhe të gjakpirësit, ku vetëm jehu i kohës bën të bashkëjetojnë si i ndjekuri me kasapin, në të njëjtin kronotop.

Në faqet e para të romanit, lexuesi mëson për Ilir Kelmendin, protagonistin kryesor që sapo ishte kthyer nga burgu i Pozharevcit në Prishtinë. Ai bredh rrugëve duke kërkuar punë, po fjalët "punë ka, por për miqtë dhe jo për armiqtë e popullit" me automatizëm sikur na flet për atmosferën nebuloze të Jugovinës (Jugosllavisë titiste) që i ha fëmijët e vet, kurse shqiptarët me ëndje të madhe duke i lançuar në trojet e tyre. Në këto faqe të para të romanit, lexuesi ballafaqohet me padrejtësitë e Jugovinës ndaj shqiptarëve; si Luli i Vocërr i Migjenit, një Lule e Vocërr ia zgjat dorën e mëshirës heroit që të na e bëjë me dije se "barazia" e vëllazërim-bashkimit, pos se ishte rrenë dhe farsë për botën, ajo ishte një dhembje që i djeg sidomos ata që i ka "përvluar" kjo rrenë, kurse ato dhembje ishin reale, të vërteta dhe të gjalla dhe shtriheshin në jetën e përditshme të popullit dhe nuk e kursenin askënd. Lexuesi kurioz që në fillim mëson se heroi i romanit pos se është intelektual, është edhe shumë i ndjeshëm, senzibil, kurse ndjeshmëritë e tij shprehen sidomos në karakterin kombëtar po kaq sa edhe karakterin social dhe shoqëror, kështu që detyra e shkrimtarit është shumëplanëshe: ai duhet t'i regjistrojë padrejtësitë kombëtare që u bëhen shqiptarëve, njëkohësisht duhet t'u bëjë ballë padrejtësive në jetën e përditshme sociale që me automatizëm presupozon një qasje shumë delikate për zgjidhje.

Kapitulli i parë i romanit bën hyrjen në formë selektimi nga amullia e të mirës nga e keqja: mes dy ish shokëve, njërit (Ilaz Topallaj që e përkrah pushtetin aktual, gjersa shndërrohet në sahanlëpirës të tij dhe vartës të pushtetit mazoik dhe qesharak të vëllazërim-bashkimit të rrejshëm) dhe tjetrit, Qaniut, që është vigjilent dhe nuk e përkrah ideologjinë komuniste, Ilir Kelmendi merr vendimin që të mos bie pre e të keqes që shitet si e mirë dhe vendos ta braktis atdheun në pamundësi të qëndrojë në vendlindjen e tij, në "tokën e askujt". Kapitulli i dytë, trajton temën e gjallë të çrrënjosjeve të shqiptarëve në plëngun e tyre për shkak të dhunës barbare; ngjarjet lokalizohen në një vagon të një treni i cili i bart njerëzit dhe hallet e tyre në mosqenie, në asgjësim, të cilët temë për dialog kanë si të mbijetohet nën dhunën e egër të metagjëllimit. Mes tjerash, në bisedë gjoja të rastit, përmendet se Shegën e Totonozëve, e ka lëshuar familja e madhe e Topallajve të Nerezit, me çka fillon qepja e ngjarjeve qendrore të romanit. Në të vërtetë, i gjithë romani për temë bosht ka fatin e këtyre dy familjeve të gjera shqiptare në kushte të viteve të para të pasluftës së dytë botërore, më saktë në vitet gjashtëdhjeta, në valën e madhe të dëbimit masiv të shqiptarëve nga vatrat e tyre shekullore në Turqi. Në mënyrë të imët dhe të detajuar, shkrimtari regjistron gjithçka nga përditshmëria e kohës, duke veçuar çdo detaj, hallet e tyre deri te bartësit e pushtetit lokal; gjithçka që është përditshmëri e jetës të shoqëruar me anë të gjuhës së folur të personazheve, tek e cila, le të përmendim sidomos frazeologjinë me bollëk tipike të romanit. Ngjarjet, veprimet dhe gjuha e folur popullore, janë të gjalla, ato jepen me kolorit, gjithçka bluhet nga realiteti i kohës, prej të përditshmes aktuale, deri te vetëdija kolektive e rezistencës popullore, bartës të të cilës janë heronjtë e gjallë të ditëve tona.

Kapitulli i tretë, i katërt dhe i pestë që shpie drejt kulminacionit, na fut në dramën e vërtetë të romanit, në vlugun e antagonizmave shoqërore dhe politike që trajton shkrimtari ku secila qenie është ngjyrosur me politikën e kohës dhe kjo politikë është shumë e ashpër dhe ka tensione konfliktuoze, është politikë e egër dhe është e nxitur nga aparati shtetëror që e diskriminon popullin, i cili mezi mbijeton, por edhe reziston në vatrat e veta. Shkrimtari futet në psikologjinë e personzheve, pozitive dhe negative, dhe flet me gjuhën e folur ashtu siç e përdor populli, me një gjuhë figurative, ku na bën t'i ndjejmë plagët e vërteta të popullit dhe përpjekjet e tij për mbijetesë nën thundrën e aparatit shtetëror. Fillojnë të rreshtohen ngjarjet, personazhet e shumta, dramat e brendshme, traumat psikologjike të disave prej tyre, Ilir Kelmendi, Shega, Zhika Kërvopija (Zhivorad Popoviq), Xha Hajroja, Xha Faretini (Farkoja), Mak Arturi, Nadire Abla, Asimi, Xhemilja, Stanko Popi, Izet Topalli, Xha Isai (Isa



Berberi), Mira (Miradija), Skënderi, Mulla Selimi, Gjergj Elezi, Mulla Zeqa, Zhika, Turguti, Shefit Nallbani, Idriz Velekinca, Gjon Serreqi, Cilka, Gafurr Garaveli, Branko Bujanovski, Shefkiu, hetuesi Dragi Bojaxhiev, Musovski, Jordani, Kallajxhiev, Gjykatësi Bulevski, Arif Kurbalia, Ali Aliu, Fehmi Kelmendi, Baba Cat, Sali Tontonozi, Atanasovski, Hatixhja, Nëna e Djalit, Zeqavet Hanmi, Nifa, Nailja, Gjyshi Simo, Vllajko, Dul Puzaqi, Bozhini, Shefki Topalli, Loro (Lorenci), Xhemali, Xifi etj. personazhe aktive, aktantë të ngjarjeve reale, personazhe të cilët në roman e "dekorojnë" dramën me ngjarje nga më të ndryshmet, personale dhe kolektive të zonës Preshevë, Kumanovë dhe Shkup, sidomos fshatrat e tyre.

Pas dialogut rrënqethës të Ilirit me Xha Hajron me të cilin shplohet halli i vërtetë i popullit se si të rezistohet dhe njerëzit të mos i braktisin trojet e tyre historike, rrëfimi na fut thellë në ngjarjet duke na e shpluar morfologjinë e ekzistencës të ngjyrosur me atë urrejtje të bartësve të asaj politike, duke mos e kursyer dhe duke e shtypur "tjetrin" deri në palcë, në pamundësi të mbijetesës. Zhika Kërvopija, një nga personazhet kryesore të romanit, mu ashtu siç edhe e shpreh vetë mbiemri, është personazh homo dupleks që në njerën anë i urren të gjithë ata me të cilët bashkëjeton – shqiptarët, bullgarët, maqedonasit, turqët, vllehët dhe romët, nga ana tjetër, duke qenë komandir i policisë lokale, si një kriminel ordiner serb, inskenon vrasjen e deputetit Stanko Popit dhe për vrasjen e tij, pa asnjë argument e akuzon Ilir Kelmendin, protagonistin e romanit; shfaq simpati ndaj Cerna Rukës, gjedhës kriminele çetnike, që sipas projekteve të njohura të Akademisë e Shkencave dhe Arteve të Serbisë të kohës së Jugosllavisë cariste, por në kohën e re, të Jugosllavisë titiste, vepron për dëbimin masiv të shqiptarëve nga trojet e tyre etnike. Ai jeton në mes të ambientit të cilët i urren gjenetikisht sidomos shqiptarët, sundon sipas parimit "përçaj e sundo" dhe nën ombrellën e ideologjisë së "vëllazërim-bashkimit" të rrejshëm, e shfrytëzon këtë parullë meskine karshi botës, por edhe duke e tallur të "të Madhin" (aludim në Titon), mendon, kurdis dhe vepron për pastrim etnik të Kosovës nga shqiptarët, dhe si një racist i fëlliqur, thotë se ata janë të padenjë për të jetuar ndaj duhet përzënë nga këto troje të tyre, se aty duhen kthyer serbët që i kish prurë krali si kolonistë, se ata "i ka bekuar Zoti" t'i sundojnë popujt e tjerë të Jugovinës (Jugosllavisë cariste dhe titiste).

Romani është një ndër veprat epope që merret me aspekte të ndryshme të jetës së përditshme dhe ndriçon fatkeqësitë e shqiptarëve ushtruar nga pushtuesi serb në një periudhë kohore kur ky dhunues historik i bën krimet duke i përmbuluar ato me vellon e Jugovinës, gjegjësisht duke mos i përmendur serbët. Duke qenë i këtillë, romani merret me jetën e përditshme dhe të gjithanshme të popullit, merret me çështje të ndryshme të asaj rezistence të shqiptarëve, përshkruan mentalitetin e Karadakut me veçoritë e ndryshme të tij socio-linguistike të këtij rajoni. Në kapitujt gjashtë, shtatë deri te i teti, romani duket sikur del nga objektivi paraprak rrëfimor, duke u marrë me marrëdhëniet e acaruara të dy familjeve të mëdha shqiptare, të Totonozëve dhe të Topallajve, ku krahas zënkave thjesht familjare, tej kësaj teme, spikat sidomos me temën e dy dashurive të katër të rinjve shqiptarë, prandaj edhe të dasmës shqiptare me të gjitha elementet etnografike. Ndodh martesa e dy të rinjve, të Skenderit me Liridonën, por në kuadër të kësaj dasme, përgjatë dhe krahas ritualit të dasmës së tyre, në prapaskenë ndodh një dashuri e dytë, shumë e fortë dhe e fshehtë paralele, e Ilirit me Shegën, që në fakt janë personazhjet kryesorë të romanit dhe ku spikat sidomos mjeshtria dhe talenti i shkrimtarit. Në fakt, gjatë dasmës dhe gjithë kësaj atmosfere të dy dashurive, gjithnjë nën hije të këtyre rrëfimeve, ndodh krimi shtetëror, vrasja e deputetit Stanko Popi dhe kurdisja nga ana e Seksionit të B. sikur gjoja këtë gjë e ka bërë Ilir Kelmendi. Pra, nën dritëhijen e tragjedive të tipit të Shekspirit, në mizanskenë luhet një dramë horror si nga fantazmat e Makbethit me çka autori me mjeshtri veprën e bën markante, me vlera të pakrahasueshme artistike, të papërsëritshme për letërsinë shqipe.

Marrë në përgjithësi, si edhe vepra tjera të autorëve shqiptarë të cilat mund konsiderohen romane epope, romani **Udhëkryqi** i Ramadan Rexhepit ka një strukturë narrative me një preokupim tematik shoqëror ku autori paralelisht i udhëheq dhe zhvillon dy temat e mëdha kryesore, temën e politikës së një kohe të errët të përplasjeve politike që shfaqet me turbulenca nga më të ndryshmet dhe vazhdon të performohet deri në ditët tona, dhe temën e dytë, fatin e zi të jetës së përditshme familjare shqiptare nën atë politikë, më saktë si gjenden dhe si e përballojnë atë katrahurë të kohës ata. Për ta bërë të gjallë atë zezonë kohore, shkrimtari në spikamë vë dy tipe dashurish të të dy çifteve, njëra uverte, e hapur dhe publike, dhe tjetra introverte, e fshehtë dhe me një varg peripetish dhe sfidash traumatike. Romani është voluminoz dhe në të rrëfehen një varg ngjarjesh nga më të ndryshmet, kurse nga galeria e personazheve të shumtë, disa sosh lexuesit e kultivuar mund t'u bëhen portrete karaktereve të veçanta (psh. Ilir Kelmendit, Zhika Kërvopijës, Xha Hajros, Shegës etj). Nga struktura romaneske të këtij megarrëfimi, duhen veçuar dy temat qendrore që lexuesi nuk do t'i harrojë për shumë kohë: kjo është dasma (në të cilën zhvillohen dy tipe dashurish) dhe procesi i gjykimit të Ilir Kelmendit, dy temat qendrore të romanit që e grishin lexuesin për lexim për çka autori ka dhënë një punë të gjatë dhe mund në mënyrë që katarsa e romanit të jetë e suksesshme. Këto dy tema, për nga ndërtimi krejt të ndryshme, e bëjnë rrëfimin e autorit të përkryer. Prej dy çifteve të të dashuruarëve, ajo që e tërheq lexuesin më shumë, është dashuria e Ilirit me Shegën (ky është itirinari që e ndjek subjektiviteti e lexuesit). Jo vetëm pse ajo zhvillohet prapa syve të publikut dhe ndodh e papritura me gjithë ato emocione dhe pasione, e pastërt dhe e sinqertë, erotike dhe sentimetale, por edhe sepse kjo dashuri i përmbys paragjykimet (mbani mend qëndrimin agresiv të të ëmës Hatixhe, e cila të bijën, Shegën e quan arushë, duke e konsideruar dashurinë e saj legjitime si të pamoralshme, natyrisht shkaku i këtij mentaliteti provincial). Kjo dashuri, mjerisht do të ngel e parealizuar për shkak të burgosjes së protagonistit, Ilirit. Nga tema e dashurisë, rrëfimi do të interkalohet në temën e qëndresës, që në fakt është tema e parë dhe kryesore e romanit që në sy të lexuesit do të mbahet mend sidomos qëndrimi dinjitoz i Ilir Kelmendit para trupës gjykuese me mesazhin e lartë njerëzor dhe human që ka fjala e tij mbrojtëse, përkundër atmosferës së zymtë të gjyqit monstër, i cili e gjykon me dhjetë vjet burg njeriun e pafajshëm. Ngadhënjen heroi, kryeprotagonisti Ilir Kelmendi, ngadhënjen ndërgjegja e tij njerëzore, ngadhënjen sakrifikica e tij për liri sado që kjo nuk duket, sepse këtu përfundon rrëfimi me ngjarjet aktive. Ngadhënjen sidomos ideja e shkrimtarit që vepra e tij të vlerësohet pozitivisht.

Kapitulli i fundit i romanit, paraqet temë më vete madje edhe për vetë teorinë e romanit. Në të vërtetë, sado roman epope që më vete ngërthen ngjarje dhe drama nga më të ndryshmet, me personazhe të dorës së parë, të dytë dhe të tretë, episodikë, mbyllja e ngjarjeve me zbritje të rrëfimit jo në zhanër të romanit por të novelës, për nga vlerat artistike me asgjë nuk ia ul vlerën veprës. Pyesim, si është e mundur kjo? Heshtja e ngjarjeve të mëtejme lë për të nënkuptuar jo një "presedan gjyqësor" të nënkuptueshëm për atë kohë të zezë, por një sagë dhembjesh të pafund të të vërtetave që mbeten të nënkuptohen si fund të dramave tragjike të zhvilluara ndër shqiptarët, jo me vite e dekada por edhe me shekuj, si kjo të cilën autori e lë qëllimisht kështu, të papërfunduar. Kjo don të thotë, se me anë të këputjes së rrëfimit, pas shqiptimit të dënimit me dhjetë vjet burg të Ilir Kelmendit, pra mbylljes së rrëfimit me zbritje të rrëfimit jo si roman por si novelë, autori nga pushtetet e më se gjysëm shekulli sikur kërkon përgjigje pyetjes se ku shkuan fatet e këputura të shumë e shumë ilirëve të tjerë, si ky i Ilir Kelmendit. Me anë të mjeshtrisë së rrëfimit, në psikologjinë e lexuesit, autori prek në fundamentin e tragjedisë njerëzore në tërësi, ku dikush është përherë ushtrues dhune, kurse dikush tjetër gjithmonë duhet të vuajë për shkak të absurdeve të gjyqeve satrape, pushteteve antishqiptare dhe të padrejta që ua bëjnë njerëzve dinjitozë dhe të papërkulshëm që thjesht, luftojnë për liri.

Secili lexues, pas kapitullit të fundit, do të kërkojë spjegime se si u bë ky fund i papritur i romanit një fund i pa fund, fund absurd do të thoshim, jo fund hepiend siç jemi mësuar ta kënaqim sedrën tonë lexuese prej qytetari, por fund i këputur, fund të cilit nuk i dihet fundi i vërtetë. Me një lexim të kujdesshëm të këtij kapitulli përmbyllës të romanit, lexuesi do ta kuptojë se ngjarjet të cilat na i kish rrëfyer autori ishin të viteve '60 të shekullit të kaluar, kurse këtu në kapitullin e dhjetë (të fundit), ngjarjet tani kanë të bëjnë me bashkëkohësinë, me kohën tonë aktuale. Kjo don të thotë se në këtë kapitull, gjatë leximit duhet mbajtur mend secilën fjalë që thuhet, qoftë ky rrëfim apo dialog të personazheve, në mënyrë që ngjarjet e këputura qëllimshëm, t'i kuptojmë se ato ngjasin si një lloj sinopsisi të kronologjisë së ngjarjeve që mund të kenë ndodhur pas një gjysëm shekulli dhe se ne, vetëm mund të supozojmë se si mund të kishin ndodhur, por jo edhe ta dimë të vërtetën. Kërshëria jonë qytetare prej lexuesish që nuk mendojmë më thellë për "sinkopën" e errët historike, humbellën e fatit të mynxyrshëm të të dy dashuruarëve, të Ilirit dhe të Shegës, a u ribashkuan ata, a doli nga burgu Iliri, ç'u bë me të dhe të tjerët, çdo pyetje të këtij romani, autori do t'ia komunikojë lexuesit me shumë pak fjalë në kapitullin e fundit, me dialogë me grimca fjalësh të zgjedhura, siç edhe qe kujdesur me mjeshtrinë e rrëfimit të ngjarjeve pararendëse, gjuhës së folur të personazheve, të rrëfejë dhe të komunikojë me anë të mesazheve të drejtpërdrejta, por edhe të tërthorrta. Lexuesi menjëherë do të hetojë se në gjuhën ose shprehjet, le ta themi, vullgare të ndonjërit nga personazheve (le ta marrim për shembull, të Zhika Kërvopijës ose të Izet Topallit, pse jo edhe të Hatixhes, nënës së Shegës), autori ka lënë të nënkuptohet distanca e nevojshme e gjuhës narrative të rrëfimtarit neutral, i cili kujdestaron mbi etikën e akëcilit personazh si bërthamë apo adresë e të gjitha replikave ku qëndron vetëdija e shkrimtarit.

Romani **Udhëkryqi** i shkruar para mëse gjysëm shekulli, e ruan aktualitetin sikur të ishte shkruar dje. I shkruar jo për t'u botuar në kohën kur edhe ndodhin ngjarjet, siç deklaroi autori para lexuesëve të tij me një rast, ka elementin e autenticitetit, gjuhën e begatë burimore që edhe sot e ruan freskinë e mbrujtur të tragjikës historike shqiptare. Nëntë kapitujt të shkruar para gjysëm shekulli dhe kapitulli i fundit, i dhjeti i shkruar në ditët tona, sikur duan të flasin se në formë palimpsesti asgjë s'ka ndryshuar në ambientin që përshkruan edhe në ditët tona, sepse çështja kombëtare shqiptare vazhdon të jetë e pazgjidhur; e keqja s'ka rreshtur së përsërituri në formë ciklike me vite e dekada, varësisht ngjarjeve që kanë kaluar vetëm mbeten të nënkuptohehen se janë tragjike fund e krye, e keqja sado që të na nuk duket se është shlyer, ajo vazhdon të jetojë tmerrshëm në Karadakun e lavdishëm dhe heroik, herë-herë madje edhe të trashet. E drejta kombëtare vazhdon të mbetet e parealizuar edhe sot në epokën tonë, fati i personazheve kanë mbetur nën hijen e kësaj zezone të përditshmërisë, romani mbyllet jo si e kish dëshiruar autori dhe e kishin pritur lexuesit, por me një një zymti dhe pa hepiend.

(Vijon nga faqja 7)

madh. Zotëri që në vend të lëmoshës jep goditje:

"E lypsit të vogël gjaku prej zemrës në ftyrë i rodhi / dhe si një zog bishe i ndjekun fuqin fëminore mblodhi..." (Cezura është imja: A.Ç.)

Migjeni jep krisjen e varfërisë nga përplasja me pasurinë, përmes një shkrimi gati të vetvetishëm, thuajse automatik, ku fjalët vërtet rimojnë si në poezi, por mendimet modelohen si në prozë. Ai arrin shkrirjen e tyre në një prozë poetike, ku muzikaliteti është efektiv:

"Ngitte, pa pra ngitte, / pa mshirë frika e nxitte / e se djersa shpinën e ftyrën ia late / ai nuk u ndalte;" (Cezurat janë të miat: A.Ç.)

Migjeni luan në poezi njëlloj si në prozë. Kësisoj del mrekullisht brenda prozës në vargun e lirë të poezisë:

"Në ball të tij dielli shkëlqente në nji pikë të kuqe: ishte gjaku."

Kësisoj rreshti i prozës sintetike ngarkohet me shprehësi arti, duke marrë vlerën e vargut të poezisë esenciale.

Pjesa e tretë është më interesantja mbasi Migjeni ndërron mënyrën e të shprehurit miksazh. Gjithnjë brenda skicës, ai braktis edhe prozën poetike, për të kaluar krejtësisht në poezi:

"Nga mshira së pamshirve
Lypsi vogël gjallonte.
Jetën e rrokullonte
Nëpër udha të ndyta,"

Migjeni aplikon shkrimin altemativ si tipar të letërsisë moderne, duke e transforrnuar prozën në poezi jo më në katër vargje, por në mbarë krijimin poetik harmonik, nga fillimi gjer në fund:

"Rrotat e autve
shpejt mbi te kaluen
dhe ... e qetsuen!"

Dy vite më vonë, me 1936, në korpusin poetik "Vargje të lira" të sapodalë nga shtypi, pjesa e tretë e skicës **"Nji refren qytetit tem"** figuron si vjershë më vete, me titullin **"Fragment"**. Poezia nis me tri retiçensa rresht, si të paralajmërojë se po vjen drejtpërdrejtë nga proza.

Asaj i shtohet vargu i pestë, i cili nuk figuronte më parë në tekstin e skicës "Një refren i qytetit tem":

"nëpër skaje t'errta".

Me një prekje shkopi magjik Migjeni e pagëzon tashmë poezinë origjinale, pavarësisht nga kolazhi i mëparshëm me prozën. Kështu ai paraqet një risi në letërsinë shqiptare, përmes rikapjes së të njëjtit subjektit, por në ndryshim konceptimi artistik.

Çka lë mangut në prozë ai e plotëson në poezi dhe anasjelltas.

Kritiku Mark Gurakuqi e ka vënë re me kohë këtë mjeshtëri formale të Migjenit, i cili:

*"... qe jo vetëm autori ma i talentuem në radhët e shkrimtar*ëve të rij të viteve ‹30, por *edhe ma i pjekuni në planin e kërkesave artistike."* (4)

PAS VITEVE '50

Pas viteve '50, (1954, 1957), me botimin e plotë të veprës së tij letrare, kritikët kanë vënë re mjaft pika takimi mes prozës dhe poezisë migjeniane; si rimarrje temash, si qarkullime motivesh, si zhvillime karakteresh, si zhbirilime personazhesh, si zhdrivillime situatash, etj.

Në mes tyre, studiuesi i huaj Robert Elsie skicën ***"Një refren i qytetit tem"*** e quan nga më bindëset e prozës së shkurtër të Migjenit. (5)

Ne u ndalëm në këtë krijim pretencioz jo thjesht për alkiminë e shndërrimit të prozës në poezi, por posaçërisht për abrakadabrën e Migjenit, me të cilën ai hyri në fondin e artë të letërsisë sonë. Proza ***"Një refren i qytetit tem",*** me gjenin e poezisë ***"Fragment",*** është mostra plot shije e tekstit konspektiv - eliptik të Migjenit, me shumësinë e domethënieve në pakicën e shenjave gjuhësore.

P. S.

Edhe ky shkrim kritik për artefaktin e imët migjenian, shfaqur në shtratin e prozës për t'u shtrirë në të poezisë, po e pëson fatin e tij devijues.

Në vend të një konkluzioni teorik po reflektohen disa vargje të shkruara prej meje, kushtuar Millosh Gjergj Nikollës në 110 - vjetorin e lindjes së tij në Shkodër, me 13 tetor të vitit 1911. **Ars longa, vita brevis:**

Lëvizte malit - qytetit, fragment me këngë a vaj,
S'e zinte kurrë vetvetja, ndaj shpiku dublin e saj.
E kapte sfondin si mjeshtër finok me një penelatë,
Me bukurinë që vret fantazoi art avangardë.
Surprizë ishte si terri me flakë zjarri kontrast,
E shpikura e vetvetes magji i bëri çdo çast.

REFERENCA:

1. Ali Xhiku: Letërsia shqipe si polifoni. Tiranë, 2004, f. 247.
2. Fatos Arapi: Fjalë për poezinë. Tiranë, 1987, f. 142.
3. Sabri Hamiti: Letërsia moderne 8. Prishtinë, 2002, f. 668.
4. Mark Gurakuqi: Autorë dhe probleme të viteve `30. Tiranë, 1966, f. 316.
5. Shih: Robert Elsie. Histori e letërsisë shqiptare. Tiranë - Pejë, 1997, f. 307.

Shkodër, më 05. 10. 2021.

Novelat "Cipa e dëborës" dhe "Heretiku i Mirditës" të Fatos Arapit

DY UDHËTIME NË PYJET E TREGIMTARISË

Nga Alisa VELAJ

Në të vërtetë, për prozën e Fatos Arapit është shkruar fare pak, ndonëse ai ka nisur ta lëvrojë novelën dhe romanin prej viteve '70 dhe vëllimin e fundit me tregime e botoi më 2007. Përgjatë katër dekadave në krijimtarinë e tij renditen këta tituj: "Patat e egra", novelë (1970); "Dhjetori i shqetësuar", roman" (1970); "Dikush më buzëqeshte", novelë" (1972); "Shokët: roman" (1977); "Deti në mes", roman (1986); "Cipa e dëborës", novela (2000); "Nuk shitet shpirti në tetor", novela" (2002); "Në Tiranë kur s'ke ç'të bësh...", tregime" (2003) dhe "Horrat e ndershëm", tregime" (2007). Kulmin e vet shkrimtari do ta arrinte me përmbledhjen "Cipa e dëborës", ku dy prej novelave të përfshira në këtë botim, "Cipa e dëborës" dhe "Heretiku i Mirditës", janë jo vetëm dy gurë shumë të çmuar të prozës së Arapit, por të krejt prozës moderne shqipe në tërësi. I cilësuar si poeti më modern i gjuhës shqipe dhe i studiuar në këtë lëmi nga shumë lëvrues të saj, për Arapin prozator dhe veçmas për këto novela nuk është shkruar thuajse asnjë rresht, për arsye që mbeten ende shumë të paqarta. E gjithë pjesa tjetër e krijimtarisë në prozë, edhe pse sjell një përmasë interesante për lexuesin, mbetet disi larg nivelit të lirikës së tij dinjitoze, por novelat e lartpërmendura janë dy diamante që e nderojnë autorin, në të njëjtën masë me lirikën e tij antologjike. Për nivelin mrekullor të lëvrimit të gjuhës, analizat psikologjike të personazheve dhe situatave, tensionet dramatike në atmosferën e krejt rrëfimit dhe abstragimet e natyrës filozofike, këto novela e vendosin Arapin në panteonin e artë të prozës shqipe.

Vrojtues dhe ndriçues i skutave më të thella të qenies, Arapi ngulmon në këto novela, sikurse edhe në poetikën e tij, në gjetjen e atyre udhëve që do të na çonin në kthimin tonë drejt njeriut. Nëse te *Cipa e dëborës* ky rravgim kryhet duke zbuluar hap pas hapi para syve të lexuesit shkëmbinjtë e krenarisë në koshiencën dhe subkoshiencën e protagonistes Ajkunë, te *Heretiku i Mirditës*, personazhi e di prej fillimit kuptimin e rravgimit. Gjon Keqi vuan plot fisnikëri për papërmbushjen e tij, pa fajësuar askënd dhe pa mpakur qiejt e askujt për të krijuar të vetët, sepse ai ka shumë qiell brenda tij, edhe atëherë kur loja e dritës dhe e errësirës përleshen në psikikën e tij në një betejë për jetë a vdekje.

"Ajkuna po zbulonte shkëmbinjtë e krenarisë së saj, Ajkuna fliste sikur ajo tjetra, Varfa, të mos ishte fare aty. E pra, Delushin e kishte pjellë Varfa. Dhe "nëna" ishte Ajkuna."

"Dhe sytë iu hapën gjer në synoret më të skajshme që mund të hapen sytë njerëzorë; thua se po e shihte për herë të parë atë përleshje të tmerrshme të errësirës e të dritës në kullën e vet. Ndjeu të ftohtë dhe një frikë të pakuptimtë që e akulloi: në atë gjysmerrësirë dhe gjysmëdritë njeriu ishte bërë fare i vogël; kurse hija e tij herë zmadhohej, herë rritej në sajesa nga më të çuditëshmet që lëviznin nëpër muret. Ngado që kthente kryet hija e tij e gjallë i kanosej".

Të dy personazhet e të dy novelave janë qenie të papërmbushura dhe vuajnë pikërisht prej kësaj. Ajkuna nuk mundet të sjellë dot në jetë një fëmijë, ndërsa që ka në krah një dashuri të thellë dhe të vërtetë. Ndërkohë që për Gjon Keqin zbrazëtia shpirtërore është e dyfishtë; ai as nuk mundet të ketë dot trashëgimtarë dhe as nuk mundet ta ketë dot ndër krahë për bashkëshorte gruan e sëmurë Dranen. Ajkuna e kërkon mbushjen e zbrazëtisë përmes marrjes së qiellit të të tjerëve, ndërsa Gjon Keqi i lutet me përdëllim qiellit që ka mbi krye. Ajkuna është një krijesë

që nuk del për asnjë çast jashtë kohës dhe egos së saj. Gjon Keqi prej fillimit është jashtë kohës së tij mesjetare dhe ka krijuar a ndoshta është krijuar ai vetë prej një kohe ku i falet dashurisë dhe besimit, sipas mënyrës së tij. Ajkuna, duke mpakur qiejt e të tjerëve për të zgjeruar të sajtë mbetet një dhimbje e pakohë, një klithmë epike pa cak e zanafillë e maleve të saj. Gjon Keqi duke qenë që në fillim jashtë kohës së tij reale, mbetet akohor deri në fund, si e vetmja udhë për ta shndërruar hijen e tij të gjallë në njeri plot jetë e dashuri përbrenda. Në të kundërt, Ajkuna, prej të qenit njeri e kthen veten dhe të tjerët në hije të gjalla që e kryejnë odisenë e tyre jetësore me të njëjtin varr mbi shpinë: kujtimin e Delushit të vdekur.

Në këto novela faktet e shenjuara **kuptohen**: për këtë mjafton të dish gjuhën e shkruar të tekstit. Faktet e simbolizuara **interpretohen:** dhe interpretimet ndryshojnë nga njëri subjekt te tjetri.[1] Po të përpiqemi të kuptojmë universin imagjinar të ndërtuar nga Arapi përmes rrëfimit të tij, do të arrijmë të interpretojmë dhe simbolikën e universit imagjinar të krijuar nga lexuesi. Faktet e shenjuara në këto novela nuk janë shkakësia kryesore e asaj çka ndodh në psikikën e personazheve. Domethënia që vjen prej tyre në rrëfimin e Ajkunës, përcakton një simbolikë të përkundërt për lexuesin, nga ajo çka pretendon protagonistja, ndërsa në tekstin e novelës "Heretiku i Mirditës" faktet e shenjuara për Gjon Keqin nga rrëfimtari i gjithëdijshëm, përcaktojnë të njëjtën simbolikë, si për atë që rrëfen, si për atë që lexon. Rrëfimi i Ajkunës për veten apo universi imagjinar që ajo ndërton për historinë sipas versionit të saj, nuk përputhet absolutisht me universin imagjinar të lexuesit. Për Gjon Keqin, universi imagjinar i lexuesit përputhet plotësisht me universin imagjinar të atij që rrëfen[2]. Arsyeja e mospërputhjes për protagonisten është se ajo kërkon njeriun që nuk është paracaktuar të jetë, kurse protagonisti lutet për njeriun që është. Filozofia si të pranojë njeriu atë që është paracaktuar të jetë, e ndjek Gjonin në çdo hap. Ai jep dritë edhe kur nuk merr. Në fund të rrëfimit ai shpërblehet shumë më përtej masës që ka dhënë dhe është lutur të ketë. Litania e tij "Mo-zo' ma keq" e shndërron çdo grimcë të errësirës në dritë shpirti dhe përtëritjeje. Në të kundërt Ajkuna nuk mëson kurrë të bëhet ajo që është. "Gruaja që nuk lind është dënim për gjithë jetën. E unë nuk lindja. Më vinte plasja që ky dënim më kishte rënë mua për hise", shprehet ajo. Dënimi i saj bëhet dënim për të tjerët dhe kështu duke mos dashur të bëhet ajo që është, shndërrohet në atë që nuk është. Pikërisht këtu ajo dënohet dyfish, duke u ndjerë e përmbushur vetëm për pak vjet me rolin e nënës. Vdekja e Delushit është një lloj shpagimi për të dhënë mbrapsht atë çka ajo ka marrë prej Varfës. Ajo mpaku qiellin e saj dhe ky veprim i marrë krenarie, iu kthye mbrapsht me humbjen e asaj çka kishte përvetësuar pa i takuar.

Në novelën "Cipa e dëborës" kemi katër rrëfimtarë: rrëfimtarin që rrëfen ngjarjen e tërë, duke na sjellë përmes tij dhe tri rrëfime të tjera, me anë të të cilave ai ndërton vetveten, rrëfimi i Ajkunës për ngjarjen, rrëfimi i Buqarit si rrëfim shtesë qoftë për rrëfimtarin, qoftë për rrëfimin e Ajkunës dhe rrëfimi i munguar/heshtur i Varfës. Rrëfimtari që rrëfen ngjarjen, njëherazi edhe personazh është larg rrëfimtarit të gjithëdijshëm në rastin e novelës "Heretiku i Mirditës". Rrëfimtari te "Cipa e dëborës" është një personazh që gjatë shtjellimit të subjektit shprehet se *gjithçka ishte e pakuptueshme,* ndërsa në fund të rrëfimeve arsyeton me habi: "*Unë po kuptoja se asaj nate kishte ndodhur diçka tjetër, asaj nate jo unë, ata njerëz më kishin krijuar mua*". Njerëzit-rrëfime ndërtojnë rrëfimtarin që i sjell lexuesit ngjarjen, duke u habitur shpesh me të njëjtën logjikë që do të habitej dhe lexuesi. Rrëfimtari kalon pra, në të njëjtat faza ndërtimi që kalon edhe lexuesi, duke dëgjuar tri rrëfimet e tjera. Të dy zemërohen njëlloj për fatin e trishtë të Varfës, të dy rebelohen ndaj arsyetimeve të pabaza të Ajkunës, sa herë që kjo e fundit e justifikon dëshirën e saj për fëmijë me papërmbushjen e Buqarit. (*Që të vrisja dashurinë time, po... por, që të të mohoja Delushin ty...nuk e bëja dot...murmuriste Ajkuna*). Ndjenja e thellë e xhelozisë për Varfën tregon se Ajkuna ka vrarë në fakt dashurinë e Buqarit për të dhe dashurinë e Varfës për Buqarin, ndërkohë që mohimi i fëmijës është e pathëna gërryese e papërmbushjes së saj si grua. Universi imagjinar i lexuesit ndërton kështu një rrëfim përtej fjalëve të protagonistes. Rrëfimi i mungesave të tjetrit është në fakt rrëfimi i mungesës së asaj që rrëfen.

Rrëfimi i zbrazët nga fjalët i Varfës shton së tepërmi tensionin dramatik në atmosferën e tri rrëfimeve të tjera. Rrëfimtari-personazh shkruan se *Varfa ishte njeriu që bisedonte në heshtje.* Heshtja e saj e vazhdueshme më tepër se heshtje është zbrazje e detyrueshme nga fjalët. Për lexuesin një heshtje simbolike, sepse Varfa nuk flet dot për ndjenjat e saj si grua në prani të Ajkunës, nuk flet dot si nëna e Delushit në prani të saj dhe më e tmerrshmja nuk e vuan dot me fjalë pikëllimin e humbjes së të birit, për sa kohë *de juro* nuk gëzon dot statusin e nënës. Varfa është varfëruar nga të gjitha këto dhe prandaj i kanë shterur fjalët. Në optikën e rrëfimtarit-personazh, ashtu e varfëruar nga mëmësia dhe dashuria për veten, Varfa pas humbjes për herë të dytë të djalit dhe pasi *Buqari për të ishte vetvetja,* nuk është më një qenie e plotë, por pjellë e egos së sëmurë të Ajkunës, vazhdim i ëndrrës së saj të mëmësisë dhe objekt i thellë i xhelozisë për të shoqin. *Varfa ishte pjesë e asaj gruaje*, pjesë e atij burri, që ndjente për të keqardhje të thellë dhe në anë tjetër ishte skllav i dashurisë të parë në shpirt, ndërsa fizikisht kryente ndaj saj detyrën e mashkullit. Për sa kohë nuk është qenie e plotë, Varfa nuk ka se si të shprehet me fjalë, por vetëm me dritën e dhimbjes dhe të tragjedisë për gjithë humbjet e saj të njëpasnjëshme. Shpresa e Varfës ka sy tragjedie, ndërsa heshtja e saj e padurueshme mban në shpinë peshën e elegjisë për gjithë çka nuk pati dhe gjithë çka nuk arriti të ish.

Konteksti shoqëror, në të cilën zhvillohen rrjedhat e ngjarjeve në fabulat e të dy novelave, përcakton dhe veprimet dhe vendimet e personazheve. Te "Cipa e dëborës" mendësia sociale ka ngjizur mendësinë e personazheve në atë shkallë, sa tragjedia e Varfës dhe Buqarit kanë pjellë dy fajtorë të pafaj. *Si ai lumi midis shkëmbinjve, Buqari kishte hapur udhë vetëm midis atyre mendimeve , dhe atje rridhte.* Po aty rrjedh Varfa me nënshtrimin e saj në formën e një altruizmi në kufijtë e absurdit, po aty rrjedh dhe egoizmi i Ajkunës. Ky i fundit arrin ta justifikojë protagonisten e vërtetë të rrëfimit, vetëm në njëfarë mënyre, si në universin imagjinar të sjellë nga autori, si në universin imagjinar të ndërtuar nga lexuesi. Te "Heretiku i Mirditës" mendësia mesjetare jo vetëm se nuk arrin as ta prekë protagonistin, po ngjiz të tillë rebelim në shpirtin e tij, që nga çasti kur ka kuptuar se *Mirdita, lum miku, shkon pas sulltanit dhe i falet Jezu Krishtit,* sa ky personazh simbolizon antitezën e plotë të kohës së tij. I qëndron deri në fund besnik figurës së gruas dhe dashurisë, pranon vendimet e Zotit në jetën e tij dhe lutet e vuan në heshtje për gjithë dramën që i ka rënë mbi krye. Një heretik që kurrsesi s'mund të jetë heretik, në një kohë si Mesjeta, që ngatërron çfarë është dritë

(Vijon në faqen 13)

1 Todorov, Tzvetan. (2000). *Poetika e Prozës,* Përkthyer nga Gj.Kola dhe N.Papleka. Tiranë: Panteon, fq. 169-170.

2 Te "Leximi si ndërtim" Todorovi dallon këto lloje rrëfimesh: "1. rrëfimin e autorit, 2. universin imagjinar të sjellë nga autori, 3. universin imagjinar të ndërtuar nga lexuesi dhe 4. rrëfimin e lexuesit. Lidhje domethënieje krijohen ndërmjet rrëfimeve 1 me 2 dhe 2 me 3, ndërsa lidhje simbolike midis rrëfimeve 2 me 3".

QEMAL DRAÇINI, PAVDEKSIA E KRIJUESIT

Nga Enver Kushi

KOHËT E QEMAL DRAÇINIT

Qemal Draçini është prologu i krijuesit shqiptar në vitet e diktaturës komuniste dhe shpirti i lirë i vrarë pabesisht, ose thënë ndryshe zhgënjimi i atyre që besuan në një botë të re. Ai lindi në qytetin e Shkodrës në vitin 1922. Në këtë qytet të kulturës dhe artit kreu studimet e para në shkollë dhe në vitet 1941–1943, ndoqi studimet universitare për drejtësi në Firence. Më 1945 punoi si mësues i letërsisë në Tiranë e Shkodër dhe më vonë në Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës, për tekstet e reja shkollore. Që i ri, pra në fillim të viteve '40 u shqua në fushën e krijimtarisë dhe të mendimit letrar. Ai shquhet për studimet mbi Naim Frashërin, Gjergj Fishtën, Ndre Mjedën, Migjenin, Gaspër Palin, Kol Mirditën, Veli Stafën, Sterjio Spassen. Qemal Draçini edhe në shkrimet për disa autorë të huaj bien ë sy për origjinalitetin, erudicionin, mprehtësinë e gjykimit dhe të analizës.

Ai u arrestua në vitin 1946, dhe vdiq në qeli nga torturat e tmerrshme më 1947.

Kam patur fatin të marr pjesë në promovimin e përmbledhjes së veprës së tij 'Era", që është botuar në Shkodër , në vitin 1995. Mbaj mend, që në këtë promovim kam shkuar bashkë me professor Ramadan Sokolin, që ka qënë nga miqtë e rinisë së Draçinit.

Zëri i kohës në këtë libër vjen pak i ngjirur dhe herë -herë i qartë dhe kumbues... Ndjehet kjo kur shfleton edhe revistën "Fryma", e përmuajshe letrare dhe kulturore, numri i parë i të cilës ka dalë në Shkodër në janar të vitit 1944. Drejtues i revistës ishte Myzafer Pipa dhe kryeredaktor dhe redaktor Qemal Draçini.

"Fryma" është ndoshta revista e fundit e shtypit të lirë shqiptar në prag të vendosjes së diktaturës komuniste. Në një atmosferë të rëndë pushtimi nazist, llogoresh dhe gjaku që kishte përfshirë jo vetëm Shkodrën dhe Shqipërinë, por tërë Evropën dhe botën. Qemal Draçini me botimin e revistës sfidonte pushtimin, duke u përpjekur të sillte frymën e ngrohtë të kulturës dhe artit. Dhe Draçini 22 vjeçar, në kryeartikullin e numrit të parë, do të shkruante: "Ishte nevoja e një tribune si kjo jona, për me çelë sytë kah horizonte të reja. U pa e dobishme kjo lidhje mendimesh e gjykimesh për shprehjen e ndjesive në botën e letrave".

Nuk është aspak e rastit që Qemali, po në të njëjtën numër, në artikullin "Një grishje", do të ftonte shoqet tona intelektuale, që të bashkëpunojnë me ne pa dallim për me rrahë së bashku mendje të reja -problemet e ndryshme kulturore në dritën e nën prizmin e pamjes së qytetnisë moderne perëndimore" Në tetë numrat e revistës "Fryma", Draçini shpalos kulturë të gjerë, thellësi gjykimi, përgjithësime të sakta për probleme të ndryshme të procesit letrar apo krijues: Vlen të përmendim shkrimin e botuar në numrin dy "Për një system të përkthimeve", ku ai parashtron disa kërkesa dhe kritere në përkthimin e veprave të letërsisë dhe kulturës botërore, studimin "Vepra poetike e Migjenit" (në numurin 3 dhe 4), që do ta kishte zili edhe sot çdo studiues serioz për poetin tonë të madh, apo shkrimi "Romani i një mësueseje", për "Afërditën" e Sterjo Spasses.

Me botimin e revistës "Fryma", Draçini shpalos kredon e tij artistike, thënë në një letër, që i dërgon shokut të fëminisë të shkollës Ramadan Sokoli, në dhjetor të vitit 1940: "Ti e din ma mirë se unë se një artist i vërtetë duhet të krijojë, të krijojë o të shkallmojë. Amull nuk rrihet".

KUJTIMI I MUZGJEVE TË KALUEME...

Nuk kam jetuar në Shkodër, por jam i bindur se në atë qytet muzgjet, veçanërisht ato të vjeshtës, duhet të jenë një mrekulli.. Atje edhe shiu, edhe erërat, edhe aroma e pranverës apo vetëtimat dhe bubullimat, duhet të jenë të veçanta. Sepse ky qytet, ndoshta si askush tjetër në Shqipëri e më gjerë, ka pranë edhe malet, edhe kodrat e buta, edhe fushën, edhe lumenjtë, edhe liqenin, edhe detin... Në prozën e shkurtër të Draçinit, Shkodra me natyrën e saj të çuditshme, zë vend kryesor. Natyra shihet nga shkrimtari nga e njëjta pamje: nga dritarja. Dritarja e shtëpisë e lidh atë me botën përreth, me "kopshtijet e jeshilta të Shkodrës sime rrahin në mallime stinësh të dekuna". Qemal Draçini është mjeshtër i përshkrimit të natyrës dhe detajit. Vëzhgues i mprehtë, me një ndjeshmëri të hollë, stil të rrjedhshëm, frazë elegante, ai fikson tablo të ndryshme të natyrës, shiun dhe erën, fillimin e pranverës, gjëmimet e bubullimave. I paisur me dhuntitë e artistit, i ndjeshëm dhe herë-herë melankolik. Draçini parapëlqen veçanërisht vjeshtën. "Muget vjeshte", "Lotvjeshte", "Kopshtije të Shkodrës s'ime" etj., të shkruara në shtator – tetor 1939, pra në moshën 17 -vjeçare, fiksojnë me mjeshtëri tablo të veçanta të natyrës shkodrane. Ato të rrëmbejnë me vërtetësinë e tyre, të bëjnë të ndjesh të rrahurat e zemrës djaloshare të Draçinit, shpirtin melankolik të tij. Në këtë funksion është edhe leksiku i zgjedhur, fjalët me ngarkesë të veçantë emocionale si mugeti, mugëti ugur-zeza, mugëti të zeza, mugëti orë-zezë, mugëti vjeshte, zhvarrime, gjamët e bubullimave, rropama e bubullimave, parafolje ugur-zezë, stinët e dekuna prandvera të vyshkuna, kohë të mbarueme, silueta të çmenduna, gjamë e ulërima të shkyeme...

... Rilexoj prozën e shkurtër të Qemalit dhe ngadalë, fare ngadalë zhytem përmes gërmadhave të kohës dhe një dorë e padukshme më hap një dritare nga ku veshtroj "muzgjet e kalueme" të Shkodrës dhe ndjej "gjamën e bubullimave që vjen tue u langue"...

VARRET E VETMUAR

Në krijimtarinë e Draçinit mbizotëron grija e kohës, grija e mbyllur dhe hapësirat e gjëra të jetës shqiptare, tragjizmi karakteristik shqiptar dhe ai ballkanik. Le të ndalemi vetëm në njërin prej tregimeve, shkruar në gusht të vitit 1939. Titullohet "Ligjet e malit" dhe nuk është më shumë se një faqe. Mund të ishte edhe më i gjatë. Sepse tregimi ka shtratin e një novele apo drama...

Që në fillim, me një frazë ku ndjehet ftohtësia, vetmia e një peisazhi të gurtë, shfaqet varri. Është një vend ku fryjnë erëra dhe netëve me siguri edhe gurët nisin e tregojnë historinë e varrit të vetmuar... Draçini 17 vjeçar na fut në një atmosferë të rëndë. Personazhet lëvizin në peisazhin e thatë e të gurtë, që shtrihet mes dy katundeve pa emër. Edhe ata janë pa emër: një vajzë e re, e bukur si dielli, e hijshme si nata e pranverës, me dy sy të thellë si vetë thellësia e dritës, së parë të agimit e dy vetulla të holla si vijat e gjurmës së gjarpnit dhe një djalë i pashëm. Ata e duan njëri-tjetrin dhe takohen netëve në kufirin midis dy fshatrave, ndoshta në vendin me gurë e të zhveshur. Janë të vetmet krijesa të gjalla, gjatë gjithë tregimit, që mbushin me dritë dhe ngrohin natyrën e egër dhe të gurtë... Por atë, vajzën e bukur si dielli, e vrasin. Ndoshta e mbysin vëllezërit natën ose ia shtypin kokën me gurët e kodrës së zhveshur. Sepse nuk dëgjohej asnjë krisme arme. Vrasësit, shkruan autori i dhanë me kuptue së ndër malet tona, nuk ka vend butësia fisnike e dashunisë, pse, vetë të ashpra, ato male, nuk durojnë me rritë në gjiun e tyne bustin e paraqitun në rrahje zemrat e kreatyrave të reja. Pastaj vjen varrimi. Edhe ai i fshehtë, ndoshta natën dhe larg varrezave të katundit, sa më larg, duke mbyllur turpin. Dhe ... vetëm kaq. Fundi i tregimit është tronditës: varret e vetmuar shtohen. Ata shfaqen mbi kodra të zhveshura e të thata. Përfytyroni një peisazh të thatë me varre të vetmuara që shtohen e shtohen vazhdimisht. Djaloshi 17 vjeçar që quhet Qemal Draçini, në gusht të vitit 1939, kur ka shkruar frazën e fundit të tregimit: "Pushofshi në paq viktima të pafajë të ligjeve të shkrepave!.. Pushofshi në paqë, heroina fat-zeza të dashurisë bujare...", me siguri ka rënë përmbys në dhomën e tij, duke qarë në heshtje, në vetminë e një adoleshenti.

PËRTEJ REVE...

"Përtej reve" është poezia e Lame Kodrës (Sejfulla Malëshovës), shkruar në vitin 1942. Nuk e di ku është botuar poezia dhe si është njohur me të Qemal Draçini. Gjithashtu nuk kam lexuar ndonjë fakt për njohje personale të tij me Lame Kodrën. E them këtë, sepse në shkrimin kritik ose më saktë në analizën që Draçini bën për poezinë "Përtej reve" të Lame Kodrës, nuk jepet asnjë fakt për takim ose njohje me të. Në këtë analizë Draçini duket se ka lexuar krijimtarinë poetike të Lame Kodrës të botuar në mërgim, në organe të ndryshme të kolonive shqiptare nëpër botë si në "Dielli", "Bashkimi", "Shqipëria e lirë", etj. Kjo del që në fillim të analizës për poezinë "Përtej reve" ku ai shkruan: "Përgjithësisht poezitë e Lame Kodrës janë vargje të vrullta, në të cilat pasqyrohet vullneti heroik i turmes shqiptare për liri" Pra Draçini është njohës i mirë i krijimtarisë së Lame Kodrës. Mendoj se nuk është rastësi analiza që autori i bën poezisë së Lame Kodrës. Jemi në vitet e luftës botërore, në vitet e përgjakjes së madhe të botës, të mijëra e mijëra varreve, të kampeve të përqëndrimit, të egërsisë shtazarake nazi-fashiste. Edhe Shqipëria ishte përfshirë në këtë lufte. Draçini nuk është jashtë këtij realiteti. Përkundrazi, Ramadan Sokoli, në kujtimet e tij shkruan se në verën e vitit 1944. Qemalin dhe mua me disa bashkëmoshatarë, na patën lajmëruar se ishim përfshirë në listën e kampit nazist të Prishtinës, prandaj përkohësisht u fshehëm diku sa për t'i shpëtuar atij rreziku.

Analiza e thellë, depërtimi në nënshtresat kuptimore të poezisë, përqasjet në kohë duke shaplosur dramën e madhe njerëzore, e bejnë këtë studim nga më seriozet të Draçinit. Konkluzioni në mbyllje të analizës se e bamë në një natë të qetë pushimi të 1942-ës, ndërsa mbi Atdheun tonë vinte tue u ndezë përherë ma e fuqishme e tue marrë gjithmonë përpjestime ma të gjana lufta çlirimtare e popullit shqiptar kundër hordhive zaptuese të fashizimit Italian, "Përtej reve" asht pa dyshim poezia ma sugjestive e letërsisë sonë të re, tregon simpatinë e Draçinit për luftën çlirimtare dhe respektin për Lame Kodrën, që vite më vonë do të pësonte nga diktatura komuniste burgun dhe internimin...

...Qemal Draçini vështronte përtej reve. I rritur në idealet e humanizmit, me një formim kulturor perëndimor, idealist i kulluar, shpejt parandjeu se bota e re e premtuar dhe nuk u thye, duke u bërë symbol i antikonformizmit. Në qelitë e errëta, atë e rrahën, e masakruan barbarisht për 12 muaj me radhë...

Ditët e fundit, duke lexuar kujtimet e prof. Sami Repishtit, më kanë rënqethur përshkrimet e çasteve të fundit të Qemal Draçinit: "Nga dhoma e studentit vinin tashti të qarta gjamët e dhimbjes e zhurma që bante shtrati nga lëvizjet e tij pa pushim. Thirrte nanën i mjeri, dukej se i kërkonte të falun... Më vonë nisi të përpiqej në shtrat, të kolleje randë e të villte me aq fuqi që u lëkundte shtrati..."

Kriminelët, në një natë të errët, do të nxirrnin nga qelia trupin pa jetë të Qemalit. Dhe po atë natë ata do ta zhduknin atë duke menduar se në këtë mënyrë mund të zhduknin emrin dhe veprën e tij. Por harruan se kishte një qytet legjendë që quhej Shkodër dhe një kujtesë që nuk vdiste e që quhej popull, harruan se kishte një nënë, që me mallin e pashuar të saj sa jetoi, linte hapur derën dhe dritaren e shtëpisë për të hyrë shpirti i Qemalit. Dhe shpirti i Qemalit vërtetë vinte. i lirë, pa pranga. Sepse shpirti nuk mund ta bëjë këtë. Qemal Draçini vjen në ditët tona me shpirtin e tij të madh. Krijimtaria, ku ai derdhi botën e tij të trazuar, është tregues i pavdekësisë.



Pyetësori "Librat e jetës sime"

AGRON TUFA

Libri që më ndryshoi mendjen? Proza e Kafkës, poezitë dhe esetë e Brodskijt

Libri që po lexoj ndërkohë

Po përfundoj (rilexim) faqet e fundit të romanit "Uliksi" të James Joyce në shqip, të cilin e kanë konsideruar si një "enciklopedi të modernizmit". E kam rilexuar kryesisht për të shijuar virtuozitetin e ndërtimit dhe thurjes së romanit dhe sidomos, për parimin e "përroit të ndërgjegjes", që e identifikon Xhojsin me risinë më të rëndësishme të prozës moderne në shek. XX.

Sigurisht, nuk është një roman që të "argëton" me rreth 1000 faqet e tij. Është një roman-mit (miti rrjedh nën lëkurë), që shtjellon odisenë dublineze të protagonistit Leopold Blumi (dhe të riut Stiven Dedalus) gjatë një dite të vetme (16 qershor 1904), që i bie të jetë dhe dita më e gjatë në letërsinë botërore. Kuptohet, protagonisti është shkaku i ekzekutimit të qindra fijeve të rrëfimit paralel e shumështresor, i cili ngërthen një tablo universale të botës së njeriut modern.

Në "Uliksi" një vëmendje jashtëzakonisht të madhe u jepet zhvillimit të mendimeve, degëzimit të tyre fraktal, përthyerjeve të tij, kryqëzimeve asociative; as tek Proust-i, as tek Virginia Woolf përroi i ndërgjegjes nuk shndërrohet në një rrethrrotullim të pandërprerë, pa patur as fillim, as fund; ky narracion ngjan më shumë me një thurjeje virtuoze duke shfrytëzuar një shumëllojshmëri fijesh, të një lëmshi të kokolepsur mendimesh të hallakatura, çka ndodh shpesh me vetëdijen e heronjve në prozën psikologjike të kohëve më të vona. Këtë hap vendimtar për saktësinë optimale të mekanizmit të ndërlikuar të lëvizjes së mendimit e hodhi Xhejms Xhojsi. Madje të mendimit të individit bashkëkohor, të çoroditur, që nuk kupton as të tjerët, as vetveten, as logjikën e rrjedhëse së ngjarjeve. Këtu përroi i ndërgjegjes jepet si një karakteristikë e tipit të mendimit dhe vetë përroi psikik, duke dalë si formë artistike e ndërgjegjes, gjen një ekuivalencë të plotë.

Stilin i monologut xhojsian është mimetik, d.m.th., ai kopjon me një afërsi maksimale degëzimin e çuditshëm real të mendimit monologjik, po aq dhe ndërprerjen, mospërmbylljen e tij. Më së shpeshti ky mendim (sikundër dhe mendimi dialogjik) përparon me shtytje – të shkurtra, anipse gramatikisht herë me fraza të përfunduara, herë të papërfunduara.

Episodi me i vështirë I "Uliksit", në ritmin klasik të përroit të ndërgjegjes, është ai i fundit – "Penelopa". Ligjërimi rrjedh i papërmbajtshëm, duke shkrirë në një fill unik kujtimet plot kolorit, vlerësimet e hidhura, vetëlëvdatat e kënaqura. Sipas dëshmive të biografëve, Xhojsi ka shfrytëzuar në këtë monolog femëror letrat e së shoqes, që i kanë shërbyer si prototip të Moli Blumit. Xhojsi këtu jep një model të zgjeruar pikërisht të ligjërimit femëror – me ndërkalimet e saj alogjike, me llomotitjen rraskapitëse, me një qorrollepsje të plotë të shkaqeve dhe pasojave. Por femërore këtu (siç e kupton Xhojsi këtë fenomen) na shfaqet megjithatë jo ritmi, por shprehja e botëndjesisë së saj. Nuk kemi këtu asnjë përpjekje për të cekur materien e lartë, duke medituar mbi kuptimin e jetës, problemet e përditshme – të tilla, siç janë nginjur cit monologjet e Blumit dhe Stiven Dedalusit. Të gjitha gjykimet mbi shoqet, veshjet, kujtimet e burrave të huaj, - janë ekstremisht të rëndomta, të vrazhda, të kthyer së prapthi. Femra na del në këtë episod një përllogaritëse cinike, epshore, një çiftëzuese e vetëkënaqur, e djegur për t'u palluar, që e imagjinon veten të papërsëritshme. Xhojsi ka demonstruar mjeshtërinë, me të cilën ai di të individualizojë përroin e ndërgjegjes, këtë "makinë narrative", që s'rresht së monologuari në psikikën e karaktereve..

Përkthimi në shqip nga Ildlir Azizi, mendoj se është një heroizëm i veçantë kulturor, me leksikun jashtëzakonisht të begatë, elastik, atipik, here-herë gjithë kolorit, me ekuivaleca kulturore situatash, kalamburesh, dialektesh e rebusesh të shumta egzegtike, sikurse është vetë ligjërimi avanguardist i Xhojsit. Përkthimi i "Uliksit", mendoj se ka mbetur padrejtësisht, i pa vlerësuar sa duhet, duke llogaritur shkallën më të epërme të vështirësisë së këtij përkthimi.

Libri që më ka ndryshuar jetën

Nuk besoj se është vetëm një libër, por ndër to, do veçoja ndikimin e jashtëzakonshëm që ka pasur romani i Servantesit "Don Kishoti i Mançës". E kam nisur ta lexoj qëkurse e bleva (nga klasa e gjashtë) dhe nuk di sa herë e kam rilexuar. Hera e fundit qe gjatë kësaj vere. Pse ka ndikuar? Sepse "Don Kishoti..." mendoj se është një libër mbi magjepsjen, mbi magjepsjen e pavend në një botë të pamagjepsur dhe për absurditetin e magjepsjes në tërësi. Sepse çmenduria e tij është një "çmenduri e urtë". Sepse në cilësinë e njeriut të privuar nga çdo ndjenjë realiteti, i fandaksuri i Mançës u bë nën penën e Servantesit mishëruesi tipik i "donkishotizmit", thelbi i të cilit përfaqëson një përmbajtje jetësore tepër reale. Don Kishotët u shfaqën në shekuj të ndryshëm tek popuj të ndryshëm. Donkishotizmi është i mundshëm si në jetën personale, aq dhe në atë kolektive. Me të mund të ndeshesh edhe në politikë, edhe në art, edhe në shkencë.

Kam qenë kategorikisht kundër shpjegimit dhe orientimit që i ka bërë F.S Noli simbolikës së Don Kishotit në introduktën e tij, kur shkruan: "*Servantesi zgjodhi si heronj të veprës së tij dy nga tipat më reaksionarë dhe mesjetarë: bejlurçinën , sojliun e fandaksur të katundit, Don Kishotin e Mançës, dhe laron, sejmenin, fshatarin e varfër e të paditur, Sanço Pançën, që marrin përsipër ta kthejnë prapa botën*".

Unë mendoj se duke i dhënë Don Kishotit tipare aq simpatike, duke e paraqitur atë si përparimtar, luftëtar i drejtësisë, Servantesi në të njëjtën kohë e vendos heroin e tij vazhdimisht në situata qesharake dhe absurde. Kjo shpjegohet jo vetëm me tendencën parodike që përshkon romanin. Sepse shpirti i bukur i Don Kishotit është i pafuqishëm të ndryshojë ndonjë gjë në këtë botë ku mbretëron egoizmi dhe hipokrizia. Nëpërmjet një rrëfimi ironik dhe alegorik, autori na ofron personazhe të tëhuajësuar, të cilët nuk përkojnë me realitetin dhe kontekstin e përditshmërisë.

Duke e transformuar motivin e "paranojës" së heroit në çmenduri sakrale, Servantesi e paraqet "çmendurinë meditative" të Don Kishotit si një gjendje të vetëdijes së njeriut, i cili gjendet në konditat e lexuesit të krijuar prej tij në procesin e leximit të tekstit. Por Don Kishoti është jo vetëm poet, ai, me gjithë çmendurinë e tij, është dhe një mendimtar fisnik, një njeri i mendimeve të mëdha. Sipas vërejtjeve të priftit, "ky hidalgo i mirë këput broçkulla, vetëm atëherë kur bëhet fjalë për temat e kokëkrisjes së tij, por, kur biseda është për diçka tjetër, ai arsyeton me mendje jashtëzakonisht të shëndoshë, duke dhënë gjykime të kthjellta e mendjemprehta në të gjitha pikëpamjet..." (I, 30).

Më pëlqen një shprehje e Bajronit për Don Kishotin: *"Nga të gjitha rrëfimet, ky është rrëfimi më i pikëlluar dhe megjithëse i pikëlluar, na shtrëngon të qeshim".*

Libri që do të doja të kisha lexuar

Janë disa libra, përgjithësisht joletrarë, por filozofikë, duke filluar që nga Platoni e deri te Hajdegeri. Janë libra filozofësh, me të cilët kultura jonë përkthimore amtare ka një vakuum të tmerrshëm. Sigurisht dhe libra të historikë, albanologjikë dhe sidomos memuaristikë.

Libri që pati ndikimin më të madh në shkrimet e mia

Kanë qenë disa, sepse nuk bën vaki që të ndodhë menjëhershëm ndikimi i vetëm një libri, ndonëse në një romanin "Jeta e re" të Orhan Pamuk personazhi pikërisht këtë pohon, që në frazën e parë: "Sesi njëherë, me qëlloi të lexoj një libër, që e ndryshoi krejt jetën time". Mua s'më ka ndodhur kjo, ose edhe në pastë ndodhur, unë nuk e kam marrë vesh.

Në fillim të rishtarisë sime, kur gjymtyra e shkrimit ishte e brishtë, ndikim të madh kanë pasur disa prej poezive dhe romaneve të Kadaresë, sidomos "Kronikë në gur" dhe "Pallati i ëndrrave" (qysh në versionin "Nëpunësi i pallatit të ëndrrave"). Gjatë viteve nëntëdhjetë përfytyrimet e mia për letërsinë njohën dhe qiej të tjerë me leximin e Camajt, Dostojevskit, Eliotit, Rilkes, Prustit dhe sidomos Franc Kafkës.

Libri që më ndryshoi mendjen

Duhet kërkuar në ethet e leximit të viteve tetëdhjetë, kur lexoja mbarë klasikët e romanit të shek. XIX: Gogoli, Tolstoi, Çehovi, Floberi, Balzaku, Hygoi dhe Dikensi. Mendoj se nuk ka një libër të vetëm, vetëm nese me një libër të vetëm kemi parasysh "romanin realist të shekullit XIX". Ndryshimin më të ndjeshëm të idesë sime mbi letërsinë, e shënoi njohja me prozën e Franc Kafkës dhe, pak më vonë, me poezinë dhe esetë e Josif Brodskijt.

Libri i fundit që më bëri të qaj

Janë përherë të njëjtët libra: letërsia memuaristike shqiptare, sidomos dëshmitë e të mbijetuarve të kampeve dhe burgjeve të diktaturës komuniste, por dhe dëshmitë në trajta të tjera si ditaret. Tash së fundmi, një i tillë, ditari i shkrimtarit kosovar Xhemail Mustafa (i vrarë në vitin 2001) me titull "Lutje për Prishtinën", më ka bërë të qaj disa herë, me dramacitetin dhe ankthin e ditëve të tmerrit, kur Kosova zbrazej prej shqiptarëve që dëboheshin, të tjerëve që masakroheshin dhe askush nuk ishte e sigurt se e mbërrin të nesërmen. Ditari "Një lutje për Prishtinën" padrejtësisht i harruar, përshkruan mbijetesën e një familje, që nuk e braktis qytetin, gjatë bombardimeve të NATO-s.

Libri i fundit që më bëri të qesh

"Katundi midis malesh", një vëllim i ri me tregime i shkrimtarit Ramiz Gjini, që do të botohet ndoshta këtij viti. Grotesku konstant e mjeshtëror dhe situatat plot kolorit absurd, ashtu si dhe në tregimet e vëllimeve të mëparshme të këtij autori, më bëjnë të qesh edhe tani, pas dy muajsh nga leximi.

Libri që më vjen turp që s'e kam lexuar ende

"*Gargantua dhe Pantagryeli*", romani i Fransua Rabëlesë (François Rabelais «*Gargantua et Pantagruel*»), që është dhe stërgjyshi i romanit europian.

Librat që kam dhuruar

Kam dhuruar libra që i vogël, në fillim për të shpërndarë në shkollë virusin epidemik të leximit; më vonë u kam dhuruar personave të veçantë autorët e mi më të dashur.

Një herë, me 1986, një gjimnaziste në Peshkopi ma ktheu librin e dhuruar (ishin poezitë e zgjedhura, të sapobotuara, të Robert Bërnsit me përkthimin e Agollit), pasi familja e saj me pozita të larta në KP të qytetit, siç mora vesh më vonë, ishte shqetësuar shumë, mos përmes kësaj dhurate (greke, me gjasë) synoja të krijoj një lidhje serioze dashurie me të bijën; familja e detyroi vajzën të mos takohej me mua, duke i caktuar, madje, si gardian shoqërues vëllain e saj të madh.

Kam dhuruar vazhdimisht libra, me qindra, si akte bamirësie publike, nëpër bibliotekat e djegura të qyteteve në vitin 1997, në universitete, në burgje e deri në Preshevë.

Libri me të cilin dua të mbahem mend

Për deri tani, zgjedh romanin tim të parë "Dueli". Mendoj se metafora dhe thelbi filozofik i këtij romani përfaqëson dhe poetikën e romaneve të mia të mëvonshme. Por mund të ndryshoj mendim me botimet e tjera.

Leximi që me jep rehati

Varet nga natyra e librit që lexoj. Më pëlqen të lexoj mbështetur me shpinë pas jastëkëve, në krevat, por edhe shtrirë, përmbys. Kur kam të bëj me tipin e leximeve me shënime, atëherë lexoj në tavolinë.

Libri që mendoj se është më i nënvlerësuar

"***Libri i zi i Komunizmit***" (fr. "*Le Livre Noir Du Communisme: Crimes, Terreur et Repression*), me autorë: Stéphane Courtois, Nicola Verth, Jean-Louis Pané, Andrzej Paezkowski, Karel Bartosek, Jean-Louis Margolin. Libri me gjashtë autorët, studiues të jashtëzakonshëm, sjellin një peizazh të krimit e horrorit masiv të regjimeve komuniste, kryesisht pas luftës së dytë botërore, me vdekjen e mbi 100 milion njerëzve. Libri, ka pasur dhe një botim fantazmë në shqip dhe kurrë nuk pati një ndërmarrje për ta botuar si duhet te ne këtë libër, themelor për ndërgjegjen qytetare të njerëzimit. Në këtë libër mungon përvoja e tmerrshme e krimeve të komunizmit shqiptar: autorët, që e kanë shkruar librin, nuk kishin asnjë mundësi të informoheshin mbi krimet e komunizmit shqiptar, ndonëse ky libër është botuar, së pari në Paris me 1997; përkthimi në anglisht është botim i Universitetit të Harvardit me 1999.

(Vijon nga faqe 10)



dhe çfarë është errësirë. Gjon Keqi është pra heretiku që nuk pranon të kryejë asnjë herezi, duke vënë dashuri në gjithçka, si dhe i gatshëm të sakrifikojë veten për gruan e sëmurë, edhe pse thellë vetes (asaj vetes që dëshiron përtej dashurisë shpirtërore) ai ëndërron pasionet egërshane të mashkullit dhe sedrën e burrit për t'u ndjerë atë i një trashëgimtari. E megjithatë ai zgjedh dashurinë shpirtërore për Dranen. (*Gjon Keqi ndjente një barrë të rëndë në shpirt, po shkonte tek Drania dhe nuk ishte i gëzuar*). Në mohimin e vetes për sakrificën ndaj tjetrit, Gjon Keqi është një gjysmëvëlla i Varfës dhe një antitezë e plotë e Ajkunës. Kjo e fundit është një heretike e vërtetë në gjuhën simbolike të universit imagjinar të ndërtuar nga lexuesi. Sepse Ajkuna me pasionet e saj të shfrenuara të xhelozisë nuk e le Varfën të përjetojë një dashuri si e saja me Buqarin (*Unë i dërgova këta të dy në mal. Nuk i duroja dot në shtëpi. Le të ishin vetëm atje.*); madje xhelozia arrin kufijtë e çmendurisë për femra që nuk janë veçse sajesa të mendjes së saj e të ëndrrave që sheh (*E shihja atë grua pranë burrit tim dhe doja ta mbysja me duart e mia.*); i mohon mëmësinë Varfës dhe mbi të gjitha nuk e pranon kurrsesi vdekjen si vullnet të Zotit. Ajkuna është dashuria dhe vdekja. Era shkumë qumështi për burrin e saj dhe cipë dëbore e ftohtë për shkëmbinjtë e saj të krenarisë, që shterin diellin e jetës së Varfës. Arapi është një psikolog i jashtëzakonshëm në përshkrimin e pasioneve, bëmave dhe zbulimin e atyre skutave të ndërgjegjes njerëzore, ku jo çdo rrëfimtar arrin të hyjë. Në një lexim të lexuesit model, pa asnjë mëdyshje themi se gjithë simbolika e këtyre novelave shtrihet përtej fabulës, apo ndodhisë së ngjarjeve në nivel social dhe shoqëror. Ajo çka është thelbësore në këto rrëfime janë qeniet dhe e pathëna e shpirtrave. (*Unë nuk kam qenë shumë i mençëm: kam qenë burrë dhe këto të dyja nuk kanë kafshuar aq njëra-tjetrën, sa më kanë ngrënë mua*).

Simbolika e emrave në këto rrëfime vjen pikërisht ne funksion të të pathënave të shpirtit, që duhen zbuluar nën dritën e interpretimit të faktet të shenjuara në rrëfim. Ajkuna është simbol i dhimbjes dhe i kujës së pambarimtë epike për mungesat e saj, me të cilat nuk pajtohet kurrë. Dranja (shkurtim i emrit *Drandofile*) simbolizon vyshkjen nga jeta, brishtësinë dhe shpirtin e bukur, më anë të të cilit i tregon bashkëshortit *se Drania s'është më e kurrkujt dhe nuk vij dot me ty, Gjon vllai.* Gjon Keqi simbolizon me anë të mbiemrit tragjedinë e tij njerëzore, kurse me anë të emrit bekimin hyjnor. Ai bekohet me ringjalljen e dashurisë, që është gruaja me emrin Pashkë. Gjoni si emër me një simbolikë të dyfishtë, është gjoni si emër zogu vetmitar, që këndon netëve me një zë të përvajshëm dhe Gjoni pagëzori në Testamentin e Ri. Pashka e Uc Dedës pagëzohet prej Gjonit të saj me emrin Diella e Gjon Keqit. Ujërat e dashurisë së thellë të Pashkës përtërijnë dhe e bëjnë një njeri të ri burrin e saj dhe atë vetë. Emri i Delushit si kryefjalë e tërë rrëfimit te novela "Cipa e borës" simbolizon delen e humbur nga grigja e jetës. Trajta përkedhelëse e emrit, bymen përmasën tragjike të mallit të tmerrshëm prej mungesës njerëzore. Delushi është personazhi për të cilin flitet sikur të jetë gjallë, ndërsa mospranimi i realitetit të vdekjes shton heshtjen te nëna Varfë, e bën më fisnik shpirtin e atit (ai ngrihet mbi dhimbjen për të mos u prishur gëzimin të tjerëve) dhe e kthen gjumin e Ajkunës në gjumë vdekjeje. Në vend të prehet netëve në shtrat, ajo gdhihet mbi varrin e birit të shpirtit.

Novelat "Cipa e dëborës" dhe "Heretiku i Mirditës" janë proza të një poeti. Disa romancierë kërkojnë ta arrijnë poetikën; të tjerët e kundërshtojnë. Nëse vetë një roman është poetik, poezia ia zgjeron tematikën veprës dhe ia rrit ndjeshmërinë.[3] Në rrëfimin e Arapit ndjeshmëria rritet përmes përshkrimeve të jashtëzakonshme të natyrës në paralelizëm me gjendjet shpirtërore të personazheve. Ja si e përshkruan rrëfimtari ndjenjën e mëmësisë personazhi i Ajkunës: *"Tek Ajkuna gjithçka kërkon fëmijën, gjinjtë e fryrë, barku i ngrohtë, sytë e shqetësuar e të ndezur. Diçka e ëmbël, e dhimbshme dhe e trishtuar donte të merrte tek ajo formën e një foshnje të vogël"*. Një nga dallimet thelbësore mes prozës dhe poezisë ka të bëjë me synimin e kësaj të fundit për të rrokur të parrokshmen, për të thënë të pathënshmen, për të shprehur të pashprehshmen.[4] Përshkrimet shpesh rrokin honet e pambërritshme të shpirtit dhe mund të kthehen në një lloj të ardhmeje profetike të ngjarjeve që do të ndodhin më pas në shtjellimin e subjektit të novelës. Në fillim të rrëfimit kemi këtë përshkrim të Ajkunës: "*Ç'ishte ai zë? Gjer atëherë unë nuk kisha dëgjuar një zë të atillë njerëzor. Ai zë murmurues dhe i lehtë sikur vinte thellë prej kohëve. Dhe ishte vetëm femra ajo që fliste*". Ky përshkrim poetik do të shenjojë tërë simbolikën e mëvonshme të figurës së Ajkunës dhe rrëfimit të saj. Ai rrok prej fillimit të parrokshmen që do të shpërthejë hap pas hapi para syve të lexuesit.

Atmosfera e vdekjes faktike që rri pezull gjithë kohën në tri rrëfimet e mikpritësve në novelën "Cipa e Dëborës" (*Ja, ti erdhe sonte dhe na e mbushe shtratin e Delushit*), apo atmosfera e vdekjes heroike në novelën "Heretiku i Mirditës", shtojnë tensionin dramatik në shpirtrat e personazheve, dhe nëse në rastin e parë e bën të padurueshme jetën, në rastin e dytë e shtyn personazhin më fort drejt tingujve të saj. Në novelën e parë, rrëfimtari bëhet edhe vetë jehonë e mungesave të personazheve të tjera dhe e mbyll bujtjen e tij me një vizitë në varrin e Delushit, apo deles së flijuar të dashurisë së madhe të tri prindërve të tij. Nëse te "Cipa e dëborës" vdekja i ka mundur personazhet, duke i përmbytur jetët e tyre me kobin e saj, te "Heretiku i Mirditës" personazhet e mundin vdekjen faktike dhe atë alegorike. Kuptimi i thellë i vuajtjes njerëzore të Gjonit, një vuajtje që ai e sheh me dritë trishtimi në sy dhe e prek me duar të dridhura, misioni i rravgimit të shpirtit të qenies së përkohshme nëpër netët e ekzistencës së përhershme (udhëtimet e personazhit ndodhin nën një qiell pa yje, kurrë ditën) i kthejnë Gjonit lumturinë absolute. Personazhi kërkon dhe i jepet. Lutet dhe merr përgjigje. Refreni i tij i pikëllimit "*Zot që jemi xixëllonja nëpër këtë terr…*", i çel Gjon Keqit dyert e përndritjes, përtëritjes së shpirtit dhe dashurisë absolute, për të cilat ai ndiente tërë kohën një etje të pashuar dhe nostalgji të pangushëllueshme.

Vlorë, gusht-tetor 2021

3 *The Princeton Encyclopedia of Poetry and Poetics.* Princeton and Oxford: Princeton University Press, fq. 43.
4 Lëngu, Ilia. (2007). *Vështrimi i Orfeut.* Tiranë: Argeta-LMG, fq.15

NUK MUND TË FLE

Poezi nga Sadik Bejko

nga libri në proces

Brigje dhe brezni

Gjyshit tim

Për mua fëmijën
pleqtë ishin të përjetshëm si brigjet
(s'dija ç'ishte vdekja:
djemtë do të mbeteshin djem dhe burra –
burrat).
Që atëherë më pëlqyen brigjet dhe pleqtë,

që kur dorën ua shkoja sipër mbi rrudhat;
nga të parët historitë e fisit dëgjoja
që njësoj të lashta më dukeshin
me rapsoditë që rridhnin me ujërat;

e qëndroja shumë pranë tyre,
pranë brigjeve dhe pleqve unë fëmija,
siç kanë qëndruar e do të qëndrojnë
bashkë
fëmijët, ujërat dhe përjetësia.

Dhe s'dija që pleqtë në rrëfime
shtonin dhe kohërat e tyre –
brigjet thinjnin të njëjtat shushurima, të
lashta –
s'e dija që më vonë unë fëmija
rrëfimet e plakut do t'i bëja më të begata.

Kënga e fundit për zjarrin

Zjarri digjet si një godinë e rubintë.
Si re ngrihet tymi,
mjegull shkundet hiri,
rrënohet e rrëzohet e brofëtin i guximtë –
hije-dritë, natë-ditë, muzgu-agimi.

Vërshëllen e shkrofëtin,
buçet e ulërin
dhe platitet tufani dimëror në oxhak –
por përndritur nga zjarri,
të strehuar te zjarri, kuvendohej përqark.

Ja, pllakoste heshtja:
(si heshtin të gjithë ndonjëherë kështu,
vallë?)
Heshtnin, po ti së thelli një këngë agimesh
të kuqe brambullije
për ne të gjithë që na kish përpirë tufani,
të ftohtët na kish përpirë si në një përrallë
ku luftonin diva, shtriga me hije.

Dhe s'dëgjohej më lëngata e trojeve prej
tufanit,
lëngatë njeriu nga syri i keq, magjira a
xhinde –
roniteshin tok me hirin nën brambullimën
e zjarrit,
ku vezullonin në miniaturë agime
fantastike.

E zbruhej kjo heshtje nën tendën-
murmurimë,
rifillonin prapë kuvendimet e mbrëmjeve.
Ç'ishte kjo e ngrohtë, e pashuar
brambullimë,
buruar si nga dheu në vatrat e këtyre
vendeve?

Mos vallë qe zëri i ndonjë gjyshi të urtë
që digjej bashkë me zjarrin
dhe nën thinjat e platitura, nën hirin,
me rubinët e prushit fshihte nën themele
këtë rapsodi të mbrëmjes që i ngrohte
gjirin?

Ç'ishte ai që në atë tufan-rropamë
frikën dhe errësirën i tërhiqte në shpellat
e mitit,
sa herë u dogj që ta dëgjonim vallë
dhe tërhiqej vatrës thellë, mbuluar prej
hirit?

Dhe koha kishte të tjera drita,
të tjera këngë mbrëmjet i përtërinin.
Ne u strehuam te zjarri
...zjarri që në njërën dorë mban muzgun,
në tjetrën agimin.

Lumi

Mbrëmjeve në trurin tim feksin...
as vetë s'e di çfarë, por ka diçka që feks.

Krah me rrugën rrjedh një lumë.
Kërruset mbi të e bie mahnitshëm
nëpër reflekse një qytet,
reflekse që e joshin,
sa nuk e verbojnë nëpër net.

Mbrëmje, gjysmerrësirë, eci unë
dhe lumi me drita mbi shpinë;

lumi duhet t'i dojë shumë këto drita,
ndërsa rrëshqet e ikën vjedhurazi nën to,
si prindi që s'do t'i zemërohet fëmija.

Ato e përkëdhelin nëpër trup,
ato ia dinë dhe gurët e ftohtë të shtratit në
fund.

Po atë s'e mban vendi, gurët,
as qyteti,
në imazhin e tij,
në mishin e tij,
në vrapimin e tij është deti.

Kur përpara i dalin fushat,
këput e u jep masa ujërash nga trupi i vet,
tej, mes të dy brigjeve brenda shtratit të tij
rrëshqet.

Po mua, kur eci pranë tij mbrëmjeve,
nëpër tru diçka më feks.
Ndoshta brenda meje derdhet ky lumë
me tërë dritat, gjerësinë dhe shqetësimin
e vet;
në qetësinë a në gëzimin,
në lodhjen a në mërzinë time
dhe fare pa dashjen time
dritat e tij më feksin, më feksin,

ndërsa si ujërat shtratin,
hapat e mi rrugën ndjekin.

Dhe diçka ikën

Dhe diçka ikën, ikën, më vidhet,
nga gjumi im vidhen dëshirat,
si zogjtë që u vidhen çerdheve të tyre
në heshtjen e mëngjesit,
siç vidhen vajzat e dashuruara nga shoqet,
siç vidhen kuajt e bardhë nëpër kullota...

E ndodh që mbetem bosh
pa kurrfarë pasurie në vete;
po ja, lindin ditët mbi mugun,
si bari mbi fytyrën e ftohtë të dimrit,
si vajzëria mbi gjymtyrët e miturakes,
si fyejt nga shtogjet e lëngëzuara
dhe nga kërcejtë e tërshërave plot me
tinguj,
që flenë në vlagën e dheut të palosur
arave...

E nga unë, që nuk kam kurrfarë pasurie,
diçka vidhet, përjetësisht ikën diçka;
i shtrëngoj gjer në gjak gishtërinjtë e mi,
po prapë më vidhen, më vidhen...
edhe prej fyellit tim fluturojnë larg tinguj,
që flenë në vlagën e dheut të palosur arave.

Është deti

Ajo më thosh: atje në jug e në perëndim
është deti
dhe të fejuarit atje kanë një shtrat te
hoteli;
i bardhë, krejt i bardhë është,
pa njolla fare,
thua se e kanë prerë nga qielli,
thua se e ka larë me shi të artë dielli,
thua se është një refleks nga deti,
shtrati i bardhë atje te hoteli.

Ajo më thosh se pas rrugëve të gurta,
pas shkëmbinjve me fije bari të tharë,
pas qyteteve,
pas fshatrave
është deti
me një faqe të larë me dritë;
atje venë e lahen të gjithë,
nga qielli e nga toka
atje yjet dhe njerëzit përqafojnë ujërat e
ngrohta.

Atje ka shkëmbinj të çuditshëm,
shkëmbinj që kanë hije të buta si bari,
që kanë hije të holla si ajri.
Me ato unë do të mbështillem ndonjë ditë
e do vish të më kërkosh nëpër shkëmbinjtë
e unë nën hijen cipëhollë do jem e fshehur,
e fshehur
e do të dashurohemi shumë
e shumë kemi për të qeshur.

Ajo më thosh se, pas rrugëve të ngushta,
pas shkëmbinjve me fije bari të tharë,
pas qyteteve,
pas fshatrave
është deti.

Hamleti

Kur në histori fryjnë erërat
dhe shemben muret e kalbura të botëve,
kur kombet, shtetet shkunden si fletët
në vorbullën e madhe të shqotave,

ti vret naivitetin e shkollarit,
vështron shekujt nga kështjellat bosh,
braktis skenat, del prej ekranit,
nuk pyet më: "Të rrosh a të mos rrosh?"

Pa i hedh përsipër dashurisë,
shtjella monologësh si savanë:
kënga e fundit e mjellmës Ofeli,
fashitet brigjeve, ujërave në valë.

Dhe ecën mespërmes tragjedisë
nën monologët e ankthët si nën barrë,
shkel e harron ëndrrat e rinisë
në erë e mjegulla kurthesh vërdallë.

Kur në histori fryjnë erërat e janarit,
kur shemben skenat, ekranet mbesin bosh,
ti me shpatën në emër të birit e të atit,
nuk pyet më: të rrosh a të mos rrosh?

Nuk mund të fle

Nuk mund të fle në shtëpi sonte,
një re, e vogël sa një sandale vajze, zuri
diellin
e mbeti perëndimi si trëndafil
petalengrohtë.

E në rrugë diçka mbeti bosh,
mbeti një gur i pavënë në kalldrëm,
një gur i vogël sa pupa e motakes.

Mbrëmja shkoi në shtëpi
dhe dikë e la jashtë rrugëve të natës
e udhëtari ra e fjeti pa e mbaruar rrugën.

Dhe një urë sot nuk u var
në supin e bregut tjetër
e nuk e shkoi si në unazë rrjedhën e lumit.

Ka mbetur në sqepin e zogthit të vogël
një kokërr rëre
e në rrugë milingonës i ka dalë një kokërr
rëre.

Mbeti një kopsë e pazbërthyer në gushën e
së dashurës.

E një fjalë sonte mbeti në honin e gojës,
e rrëzuar nga kreshta e dhëmbëve të
shtrënguar,
një fjalë e vetme pajtimi midis prindit dhe
birit.

Nuk mund të fle në shtëpi sonte, nuk
mund.

Në stacionin e fundit

S'kish gjë që të ndihej e të kuptohej më
lehtë:
ne po përcilleshim përgjithnjë, kjo ishte
ndarja.
Kështu një ditë largohet nga ne ajo që e
deshëm
dhe një copë udhë e përtypëm bashkë.

Ndërroi stina. Sa vjen,
do të fryjë me batërdi një erë:
ia ndiej zallahinë nga stoli i stacionit,
ku prehem pas ndarjes.

Ndërsa hapat largohen e sheshi mbetet
bosh,
ndiej lemerinë e fjalëve,
kërcënimeve: "I pacipë, na le vajzën",
"I poshtri, e la të shkretën; ajo e kish
sinqerisht", po atë, ndarjen,
më mirë se ne as e ndien njeri dhe as do ta
ndiejë ndonjë ditë.

Dhe mbas stacionit, ku u ndërruan stinët,
pas rrapëllimës së fjalëve,
ajo largohet përgjithnjë;
mbetet vetëm e dashura tek unë,
e dashura e atyre ditëve kur ne, unë dhe
ajo,
kujtonim se ndarje nuk do të kishte kurrë.

Nuk e di përse

Nuk e di pse na takon t'i prishim dikujt
ëndrrat.

Nuk e di pse nuk i pranojmë
fjalët e bukura që përgatiti për ne,

dhuratat që bleu,
pse ia mohuam vendet e bukura,
ku mendoi të dashurohet me ne.

Nuk e di?
Ato sende që na bleu,
ato rrugë që na ndoqi
ato net që s'fjeti,
ato vende që ëndërroi,
mbeten, i rëndojnë të ftohtë si gurët...

Nuk e di pse padashur në jetën tonë
shtrojmë kalldrëm të ftohtë në jetën e
dikujt të pafaj
me po ato sende dhe mendime,
me të cilat krijonte një rrugëz me bar e
diell të ngrohtë.

Nuk e di pse padashur dikujt i prishim
ëndrrat.

Dashuri

I

Mbrëmja bëhet si hija e një peme të
madhe;
e lehtë, e hollë, ajo mbulon
ata dy metra katrorë vend që i duhen
dashurisë në natyrë;
vjeshta se nga i nxjerr,
si fruta të ndritura e të pjekura në pemë,
yjet
që i flladit me frymën e saj të butë.
Dritat e parqeve
janë si ca balona drite të varura nëpër
plepat,
që mbështjellin siluetat shëtitëse të
dashurisë.
Bari i tharë nga vera,
gjethet e mëdha (që ranë nga yjet, nga
mbrëmja, nga vjeshta)
janë shtresat ku fundosen trupat tanë
mbuluar nga hija depërtuese e pemës
madhështore të mbrëmjes.

II

Kjo dashuri më dha kaq shumë ajër,
kaq shumë rrugë, qytete e njerëz;
kaq shumë bimë, plepa, vreshta, fusha
m'u bënë të shtrenjta e të dashura,
se i preku lumturia ime, dashuria ime,
dashuri që treti në një
verën dhe vjeshtën, natën dhe ditën,
mërzinë dhe gëzimin, vetminë dhe
gjallërinë,
qytetin e bukur dhe kodrën e zhveshur,
...dashuri
që hapi gjerësinë e bardhë e të thellë në
zemër.

Jeta ime ka dalë nga toka

Për prindërit e mi

Kur kthehen nga fushat mbrëmjeve vonë,
i shoh me krahët varur,
me supet e mprehta varur nën rroba
sikur diçka m'i tërheq poshtë:
me siguri – toka, toka!

Edhe ata e tërheqin çdo ditë,
ma sjellin në tryezë
në feta të buta e të ngrohta.

Kështu... jeta ime ka dalë
nga toka.

Ka ardhur pranvera

Ka ardhur pranvera në këtë fshat.
Zgjohem gjumit me një mbresë erë lulesh,
me një mbresë erë mjaltë.
Ditët kanë në mes lulen e qeshur të diellit.
Lëngu i athët i fushave rrit grurë të blertë...
Po ç'kam kështu një si tronditje të fshehur,
që po m'i lumturon mëngjeset,
më bën nga pak si të dehur?
Ndofta se pranvera vetë është e ëmbël,
ndofta se e ndiej që do të shihem me ty,
me ty që sapo u ndava në ëndërr.

Tek unë janë kërraba dhe mushka

Po të kthehesha atje në malësitë e mia të
djeshme,
ashtu si fëmija
që bie kokëposhtë nga shkallët,
do ta gjeja prapë atje fatin tim,
mbështetur në kërrabën e bariut
dhe në vithet e mushkës së fshatarit.

Po të mos ishte shkolla, librat,
unë do të isha atje, në fatin tim,
në malësitë e mia të djeshme.
Atje rrugët e botës janë thikë e spicë, të
gurta;
që të ngjitesh te bari i hollë, i hollë,
të ngjitesh te delja, te buka,
të duhen patjetër kërraba dhe mushka.

Kur ulem në biblioteka,
në sallat e ngrohta pranë tryezave me
libra,
kur eci mbi parketet e verdha me qilima,
më duket se rrëzohem nga këto rrugë të
buta.
E do rrëzohesha vërtet njëzet herë ditën si
fëmija,
po të mos ishin ende tek unë kërraba dhe
mushka.

Mbrëmje

Ata janë larg... prindër e të malluar,
e unë këtu në këto rrugë qyteti.
Kur flora e mbrëmjes kërruset e kërruset e
mugët,
për ata larg, atje malli më merr.

Pleqëria i preku trupat e tyre eshtakë
e në dy shelgje të buta m'i ktheu,
e kjo vjeshtë e vyshkët ra në flokët
e në rrudhat e fytyrave të dashura,
e kjo mbrëmje i rrëqeth me erë.

E, sa kohë jam larg, mua malli më merr.
Në gjymtyrët e tyre të kërrusura
janë ende dashuria dhe ëndrra,
sado që tek unë u volën krejt.
E, sa herë mbrëmja do të lëkundë shelgjet
e këtij qyteti,
mendja do të më shkojë tek ata.

Gurët

Plot me gurë është vendi im,
majëmalet me pak borë,
ullinjtë e hershëm në breg të detit,
në mishin e njomë
toka ime rrënjon gurët.

Atje në fëmijërinë time gratë rrobazeza
nën shami ruanin kujtimet e burrave që ua
mori lufta,
rritnin jetimët e tyre
që nesër një luftë mund t'i donte prapë.

Cigare e alkool nuk piu hidhërimi në
dheun tim.
Hidhërimi në gurët e ftohtë hapi guvat e
dhembjes
dhe u mpreh në thepat kthyer erës.

Vendi im në mishin e butë të tokës,
në rrënjë i mban gurët.
Dashuria atje nuk piu kurrë cigare e alkool.
Në mishin e saj janë ngulur gurët, plumba
e sëpatat.

E verbër ndaj tyre,
siç verbohet fyelli para se të nisë kënga,
si i verbohen vajzat thirrjes për t'u bërë
nëna,
si gurët verbuar ngulen kokëposhtë në
tokë,
gruaja atje u lidh vetëm me burrin...

Me burrin që, kur plaket, merr fytyrën e
rrafshnaltës
së gurëzuar me pak bimësi të rrudhosur
nga erërat që fryjnë nga deti.

Kohërat gdhendën gurë në fytyrat e
atjeshme.
Gurët ka nata e nata e dimri u përqafuan
në ngurtësim,
peshë që rëndoi deri në gjak,
deri në mishin tim të tokës së bukur...

Gurët që kyçnin rrezen e diellit,
krahun e pëllumbit
dhe një vetull qielli midis dy shpateve...

Gurët që sot, si kuajt nga vatha,
ikin, zbrazin hambarët e maleve,
në trup të autostradave shtrirë,
shtegtuar tej deteve, tej zalleve.

Mugullimi i barit të ri

Fërfëri, o bar, fërfëri!

Është po ajo tokë e thinjur, mësuar me
jetën, me mizoritë,
po ai bar gjithmonë i thjeshtë e
mospërfillës,
mbirë si perde mbi fytyrë stine e si kufi
stinësh.

Stina e re na gjen futur thellë në brazdat e
tokës,
me baltën e saj ngarkuar deri në fyt,
e kemi dalë andej, si nga llogoret,
me të vdekurit tanë mbi shpinë,
mbi shpinë e brenda vetes,
kemi dalë andej sikur të ishim secili vet' i
dytë.

Nga veshët dilnin zërat e brendshëm të
tokës,
troku i gjerë i thellësirës,
sipër takonin zërin e barit,
zërin e gjelbër, të hollë e dridhës.

Fërfëri, o bar, fërfëri!

* * *

Atdheu im barin e rrit në pranverë e në
vjeshtë,
vera për barin ka qenë pamëshirë e nxehtë,
dimrat – të shpeshtë,
mugullimin e hollë të barit e paguanim me
jetë.

Në tokë të ushqehej bari,
përmbys te rrënjët kemi vdekur;
përsipër prisnim të na mbinte bari
si mirënjohje e blertë, e heshtur.

Mbinte. Kështu e pushtuam tokën,
gur më gur, shkorret mbi shkorret.
Mbi eshtrat,
mbi mermerët e dimrave,
mbi vdekjet tona mbimë të blertë.

* * *

Kur vjen maji me ditët e gjata,
njerëzit e tokës lodhur flenë ku t'i zërë
gjumi:
përdhe, mbi plisa, ndër ara.

Bari gjithë ditën lot me erën, por, sa vjen
nata,
përthyhet mbi trupa. Murmurima e tij bie
në veshët e atyre në brazda;
tani pa frikë mund të themi: bari ka
mbirë mbi shputa, mbi thembra, mbi
shpatulla.

Rrëke-rrëke murmurin në veshët e
njerëzve,
mbush honet, mbulon brigjet
me melhemin e mirë, me përrallën e artë,
thërrmon gurët, mëritë, ndarjet,
bashkon, barazon njerëz (kjo nuk është
ëndërr),
ura e barit përhidhet nga zemra në zemër.

Kështu, kështu bari i ri rri zgjuar
gjithmonë,
harkohet tej mbi brigje të tjera njerëzore.



"SUGJERIM..."

nga Susan Hill

Shumë nga kujtimet e mia të hershme kanë gjetur strehë në mëngjeset e lumtura të së dielave. Ndihesha - dhe akoma ndihem – gëzimplotë, e çlodhur, e kënaqur, e qetë në biblioteka; era e librave dhe dylli i dyshemesë, belbëzimi i mbytur i zërave në banak, fëshfërima e faqeve që shfletohen, të gjitha këto të kombinuara me njëra tjetrën.

Tek rritesha, bibliotekat bëheshin për mua, gjithnjë e më shumë vende ku punoja, në shkollë dhe në Universitet. Herëve të tjera, pasditeve të ftohta të dimrit e ditëve të verës me shi, e vetme në qytete të huaja, kam hulumtuar bibliotekën lokale dhe atje kam gjetur rehatinë. Kështu kam mënjanuar kapitjen, të ftohtit, vetminë e gjëra të tjera jo fort të këndshme, kam thithur risi, jam zhytur në botë të ndryshme, kam kullotur, jam zbavitur, befasuar dhe interesuar.

Bibliotekat janë oaze qetësie dhe përqendrimi, vende ku punohet me nge, thesarmbajtëse të diturisë, stacione elektrike të informacionit, tempuj adhurimi të fjalës së shtypur. Ndaj nevojitet që fëmijët tanë, qysh në vogëli, të mësohen ta ndiejnë veten në biblioteka si në shtëpinë e tyre, dhe në të njëjtën kohë, t'i shikojnë ato si vende të veçanta, për të cilat, kur të rriten, do të kenë ashtu si edhe unë, kujtimet më të dashura.

Përktheu nga anglishtja:
Aristidh Shqevi

TAKIMI I FUNDIT ME PETRO MARKON

Nga Enver Cakaj

Im vëlla e ka patur mësues në shkollën pedagogjike në Tiranë dhe nëpërmjet tij u lidhëm bashkë. Erdhi në Skrapar të shkruante një roman për Riza Cerovën,por nuk arriti ta shkruante se i hoqën të drejtën e shkrimit.Vajtëm bashkë në Veleshnje, ku na priste Tomorr Cerova. Për nder të tij bënë një drekë,ku morën pjesë nja 12 veta.Petrua piu e hëngri sa i hahej dhe u ngrit e doli përjashta. Pas tij dola dhe unë ta pyesja çfarë pati,po ai ishte krejt normal. Unë i thashë të ktheshim sërish brenda, se ata për nder të tij kishin ardhur,po ai më tha: "Nuk e duroj mbylljen pa shkak,unë hëngra e piva, po hajde të soditim këtë natyrë të bukur." Kur u ngjitëm pak më lart ai i hodhi sytë nga Çuka e Frëngut dhe më tha: "A do të jetë bërë ndonjë kurreshtar e të ketë vajtur të shikonte çfarë ka prapa atij mali?" Po unë i tregova,se atë rrugë e kanë bërë me qindra herë,se vinin në Korçë e merrnin drith.



Kur u kthyem në Çorovodë takoi një nga Komiteti i Partisë, që e kishte shok dhe i kërkoi t'i shpinin një radio në dhomën e hotelit,se nuk shkruante dot pa muzikë. Dhe radion ja shpunë,por pas derës së tij i dërguan dhe një polic,që përgjonte se çfarë dëgjonte nga radiua. Ditën e dytë e gjeta të mërzitur,se ja kishin hequr radion. Ai e kishte kuptuar dhe më tha: "Nuk e kuptoj, kush është më i madh këtu, Komiteti Partisë apo Dega e Brendshme?" Atëherë mora radion time dhe ia shpura, po në fshehuri. Revista "Hosteni" në atë kohë dilte në 12 dhe 28 të çdo muaji. Ai e mbante mend dhe më tha të vinim në librari,ku kërkoi revistën. Sa çfletoi dy fletët e para e flaku revistën duke folur: "Të dhjefsha imperializmin!" Kur ishim larguar nga libraria ai më tha të ktheheshim t'i kërkonim ndjesë për fjalët që tha, po unë e qetësova se librari ishte miku im. Unë kujtova se mos nuk i kishin botuar ndonjë shkrim, po ai më tha: "Shikoje,vetëm dy fletë ka,dhe ato janë me humor pozitiv dhe e kanë mbushur me imperializëm!" I thashë të mos nervozohej dhe e ftova në atë dhomën e vogël që kisha. Gruaja e kishte përgatitur mirë drekën. Për ta nderuar mikun i vumë përpara krahoren e pulës, po ai na tha: "Francezët preferojnë më shumë krahët e pulës". U ngrit gruaja dhe ja solli krahët e pulës. I pëlqeu ajo drekë,po më shumë rakia. Unë nuk kam pirë kurrë raki,po mbaja raki për merak.

Që nga ajo kohë mbajta shoqëri të rregullt me Petron. Sa herë vija në Tiranë i shpija dhe ndonjë faqore raki.Unë fillova betejën me sëmundjen dhe spitalin e bëra pronën time. Petrua kishte marrë vesh dhe më erdhi në spital. Sa hyri në dhomë më tha: "do të më falësh,se mbajta radhën për potokalle,po nuk arrita të merrja se u mbaruan." Ne ishim katër veta në dhomë.Të katër ishim bërë si të trullosur,se kishim bërë ciklin atë ditë. Petrua kishte aftësi t'i përshtatej bisedës sipas vendit e njerëzve dhe na tha: "Jeta është në anën e majtë,vdekja në krahun tjetër dhe ecin paralel kush ta mundij, po mundeni ju!" Tre shokët sikur u zgjuan nga gjumi kur dëgjuan bisedat e tij dhe nuk ia hiqnin sytë. U ngrit e iku kur ne prisnim të na thoshte ndonjë gjë të këndshme. Shokët më thanë t'i thosha Petros të vinte sërish se na kënaqi me muhabet. Ditën e dytë në orën 11 të natës më kërkoi në telefon e më pyeti si isha e çfarë doja. Ja kisha qejf të flija,i thashë,po më zgjove. Një ditë përkujtohej përvjetori i revistës "Hosteni" ku nga Skrapari ishim ftuar, Iljaz Kapxhiu,Xhemal Molla dhe unë.Atje gjetëm dhe Petron,po,çuditërisht,kur nisi takimi dhe doli të fliste një vajzë,Petrua u ngrit e i tha: "Të lutem,prit sa të ikij unë pastaj fol ti!" Ne na bëri përshtypje kjo dhe kur mbaruam vajtëm e takuam te klubi i gazetarëve dhe e pyetëm se çfarë pati që iku.Dhe ai na tregoi: "Kur isha kryeredaktor i gazetës "Bashkimi" përgatita një fletë humoristike dhe vajta ja tregova Pandi Kristos, që atëherë ishte në Komitetin Qndror dhe ndiqte problemet e kulturës. Ai e lexoi dhe më tha: "Shumë mirë, po ti do ta bësh nuk e bëj unë." Ky ishte fillimi i revistës, që na eci shumë mirë. Tani na ngrihet një çupulinë dhe më tregon mua se si e themelova unë revistën!"

Të dëgjoje rrëfimet e Petro Markos, të vinte keq të ndaheshe prej tij. Një ditë më tregonte se kur shkonte me urban tok me Aleks Çaçin, ai e kishte bërë zakon e i thoshte: "Më jep dy lekë se një e kam." "Atë ditë Aleksi kishte marrë dhe një palë këpucë për t'i riparuar,

po kur vajtëm te këpucari më kërkoi borxh, se nuk kishte aq lekë, të cilat do të m'i sillte pas një ore. Kur kaloi ora dhe nuk m'i solli, vajta te këpucari e i mora lekët këpucarit. Pastaj mora në telefon Aleksin të vinte t'i shpinte lekët këpucarit." Kur kishte filluar krijimi i kooperativave bujqësore Petron dhe Aleksin i kishin futur në ekip, se do të vinin në Pilur. Petrua më tregonte: "Në darkë u mblodhën të gjithë piloriotët e flisnin sipas humorit të tyre. U thamë se ditën e dytë do të bëhej mbledhja për t'u regjistruar në kooperativë. Aleksi kishte vënë një kasketë në kokë. Mirëpo ata kishin ikur tërë natën nëpër pyje dhe nuk erdhi asnjë. Bëmë si bëmë,i gjetëm dhe u mblodhën. Sa filloi të fliste kryetari i ekipit, u ngrit njëri prej tyre e tha: "Ju lutemi dje një nga shokët e ekipit ishte me kasketë në kokë, tani nuk e ka, pa vënë kasketën ai ne nuk hyjmë në kooperativë!" Dhe u ngritën e dolën përjashta. E ngritëm Aleksin e vajti gjeti kasketën." Një ditë e gjeta te klubi i gazetarëve me Luan Qafzezin. I thashë se të kam sjellë një shishe rehani."Ore a ke ndonjë shishe raki, pa rehani nuk dua unë" më tha. I thashë se do të dërgojë vëllai, po ai më tha: "I thuaj vëllait të ma sjellë te koka e varrit!" Atëherë nxora dhe shishen e rakisë dhe ia dhashë. Ky ishte takimi i fundit me të,po mua nuk më besohet ende se ai nuk jeton më. Mos u harrofsh në jetë të jetëve,o romancieri i Labërisë!

Romancieri nga Zanzibari bëhet shkrimtari i parë afrikan me ngjyrë në 35 vjet që fiton këtë çmim prestigjioz

ABDULRAZAK GURNAH FITUESI I ÇMIMIT NOBEL NË LETËRSI 2021

Çmimi *Nobel* në letërsi i është dhënë romancierit Abdulrazak Gurnah, për "depërtimin e tij të pakompromis dhe përdëllyes në efektet e kolonializmit dhe fatin e refugjatëve në hendekun midis kulturave dhe kontinenteve".

Gurnah u rrit në një nga ishujt e Zanzibarit, para se t'i arratisej persekutimit dhe të arrinte në Angli si student në vitet '60. Ai ka botuar 10 romane, si dhe disa tregime të shkurtra. Anders Olsson, kryetar i komitetit të *Nobelit*, tha se romanet e Gurnah-it – nga debutimi *Memory of Departchure*, për një kryengritje të dështuar, te më e fundit, *Afterlives* – tërhiqen nga përshkrimet stereotipike dhe na hapin vështrimin për te një Afrikë Lindore me kultura të shumëllojshme dhe të panjohur nga shumë anë të botës.

Asnjë shkrimtar afrikan me ngjyrë nuk e ka fituar këtë çmim që nga Wole Soyinka në vitin 1986. Gurnah është shkrimtari i parë me ngjyrë që ka fituar, që nga Toni Morrison në vitin 1993.

Romani i katërt i Gurnah-it, *Paradise*, ishte finalist te Booker Prize në vitin 1994, dhe i gjashti, *By the Sea*, ishte në listën e gjatë në vitin 2001. Olsson tha se *Paradise* "kishte referencë të dukshme nga Joseph Conrad në portretizimin e udhëtimit për në zemrën e errësirës të heroit të ri e të pafajshëm Yusuf".

"[Gurnah] ka penetruar vazhdimisht dhe me dhembshuri të madhe efektet e kolonizimit në Afrikën Lindore dhe efektet e tij në jetët e individëve të çrrënjosur dhe në migrim", - u tha Olsson gazetarëve në Stokholm.

Gurnah, i cili ishte në kuzhinë kur u informua për fitoren e tij, nuk besonte se kjo ishte e vërtetë.

"Mendova se ishte një rreng", - tha ai. - "Këto gjëra zakonisht dalin javë përpara, ndonjëherë edhe muaj të tërë përpara, mbi finalistët, kështu që nuk ishte diçka që ishte në mendjen time. Thjesht po mendoja: kush do ta marrë?"

"Jam i nderuar që po e marr këtë çmim dhe që u bashkohem shkrimtarëve që më kanë paraprirë në këtë listë. Është trallisëse dhe jam shumë krenar".

Botuesja e tij prej kohësh te Bloomsbury, Alexandra Pringle, tha që fitorja e Gurnah-it ishte "shumë e merituar" për një shkrimtar që nuk ka marrë vlerësimin që duhej.

"Ai është një nga shkrimtarët afrikanë më të mëdhenj bashkëkohorë dhe askush nuk e ka vënë re, dhe kjo më mundonte shumë. Kam bërë një *podcast* për të javën e kaluar dhe në të thosha se ai ishte një nga njerëzit që thjesht është injoruar. Dhe tani ndodhi kjo", - tha ajo.

Pringle tha që Gurnah gjithmonë ka shkruar për zhvendosjen, "por në mënyrat më të bukura e më përhumbëse mbi atë që i çrrënjos njerëzit dhe i fryn nëpër kontinente të tjera".

"Nuk është gjithmonë kërkim azili, mund të jenë shumë arsye, mund të jetë tregti, edukim, dashuri", - tha ajo. - "Një nga romanet e para që mora prej tij te Bloomsbury quhet *By the Sea* dhe ka një imazh përhumbës të një burri tek aeroporti *Heathrow* me një kuti temjani të gdhendur, dhe vetëm kaq ka. Ai arrin dhe thotë një fjalë, që është 'azil'".

Pringle thotë që Gurnah është një shkrimtar po aq i rëndësishëm sa Chinua Achebe. "Shkrimi i tij është veçanërisht i bukur dhe serioz dhe gjithashtu humoristik dhe i butë e i ndjeshëm. Është një shkrimtar i jashtëzakonshëm që shkruan për gjëra shumë të rëndësishme".

Afterlives, botuar vitin e kaluar, tregon historinë e Ilyas, i cili ishte rrëmbyer nga prindërit e tij prej trupave koloniale gjermane kur ishte djalë dhe kthehet te fshati i tij vite më vonë për të luftuar kundër popullit të tij. U përshkrua nga *The Guardian* si "një roman bindës, që mbledh të gjithë ata që duhet të ishin të harruar, dhe refuzon fshirjen e tyre".

"Në universin letrar të Gurnah-it çdo gjë ndryshon – kujtimet, emrat, identitetet. Kjo ndoshta sepse projekti i tij nuk e arrin plotësimin në një sens përfundimtar", - tha Olsson. - "Një eksplorim i pambarimtë i udhëhequr nga pasioni intelektual është i pranishëm në të gjithë librat e tij dhe njëlloj i shquar tani tek *Afterlives*, sa ishte kur filloi të shkruante si një refugjat 21-vjeçar".

Maya Jaggi, kritike dhe gjykuese e Costa Prize 2021, tha: "Gurnah, të cilin e intervistova fillimisht për *The Guardian* në vitin 1994, është një shkrimtar i fuqishëm dhe detajist, lirizmi eliptik i të cilit kundërshton heshtjet dhe mashtrimet e historisë imperiale të imponuara që kur ishte fëmijë në Afrikën Lindore. Vepra e tij e brishtë është po aq e fuqishme për të metat brutale të kulturës tregtare që la, sa dhe mizoritë e kolonizimit britanik dhe gjerman, së paku jo gjatë Luftës së Parë Botërore, dhe "aktet e zakonshme të terrorit" që përjetoi si një njeri me ngjyrë në Britani – duke i shndërruar këto në një triumf komik në romanin e vitit 1988, *Pilgrims Way.*

Gurnah u lind në vitin 1948, u rrit në Zanzibar. Kur Zanzibari kaloi një revolucion në vitin 1964, qytetarët me origjinë arabe u persekutuan dhe Gurnah u detyra të largohej nga vendi kur ishte 18 vjeç. Ai filloi të shkruante kur ishte refugjat 21-vjeçar në Angli, duke zgjedhur të shkruante në anglisht, edhe pse suahilishtja ishte gjuha e tij e parë. Romani i tij i parë, *Memory of Departure*, u botua në vitin 1987. Deri vonë ai ka qenë profesor i anglishtes dhe letërsisë postkoloniale në Universitetin e Kent-it, derisa doli në pension.

Me vlerë 10 milionë krona suedeze, çmimi *Nobel* për letërsinë i shkon shkrimtarit që konsiderohet të jetë, sipas fjalëve të testamentit të Alfred Nobel, "personi që do të ketë prodhuar në fushën e letërsisë veprën më të shquar në një drejtim ideal". Fituesit kanë variuar nga Bob Dylan, cituar për "krijimin e shprehive poetike të reja në traditat e këngëve të mëdha amerikane", te Kazuo Ishiguro "i cili, në romane me forcë të madhe emocionale, ka zbuluar humnerën poshtë ndjesive iluzore të lidhjes me botën". Sipas Ellen Mattson, e cila bën pjesë në Akademinë Suedeze dhe komitetin e *Nobelit*: "Meritë letrarë. Kjo është e vetmja gjë që ka rëndësi."

Fituesi i *Nobelit* zgjidhet nga 18 anëtarët e Akademisë Suedezë – organizatë madhështore dhe misterioze që ka bërë përpjekje që të bëhet më transparente pasi u sulmua për një abuzim seksual dhe skandal keqpërdorimi financiar në vitin 2017. Çmimi i vitit të kaluar iu dha poetes amerikane Louise Glück – një zgjedhje jokontroversiale pas zhurmës të provokuar nga fitorja e shkrimtarit austriak Peter Handke në vitin 2019. Handke ka mohuar gjenocidin e Srebrenicës dhe që ka marrë pjesë te funerali i kriminelit të luftës Slobodan Milosevic.

Çmimi *Nobel* për letërsinë është dhënë 118 herë. Vetëm 16 çmime u janë dhënë grave, shtatë prej tyre në shekullin XXI. Në vitin 2019, Akademia Suedeze premtoi se çmimi do të ishte më pak "i orientuar drejt meshkujve" dhe "eurocentrik", por vazhdoi t'ua japë dy çmimet e radhës dy europianëve, Handke dhe shkrimtares polake Olga Tokarczuk.

The Guardian

INTERVISTË ME ABDULRAZAK GURNAH

Çfarë mendoni për kategoritë ose etiketat si letërsi botërore, letërsi postkoloniale dhe letërsi nga Globi Jugor? A mendoni se janë të nevojshme dhe/ose të rëndësishme ose të dobishme për të karakterizuar letërsinë në përgjithësi ose shkrimin tuaj? A do ta konsideronit veten si një autor të përshkruar nga këto etiketime?

Sigurisht, janë të dobishme. Si fillim janë të dobishme për arsye institucionale. Mund t'i përdorësh për krahasim në programe akademike, për qëllime marketingu dhe për botime, sepse mund t'i sinjalizosh njerëzit që kjo mund të jetë diçka te e cila mund të kenë interes. Sidoqoftë, nuk jam i sigurt nëse janë të dobishme në vetvete përpos qëllimit të tyre organizues. Nuk do t'i përdorja këto etiketime për të përshkruar veten pasi nuk janë aspekt i cilësisë ose procesit të prodhimit të kulturës. Janë të nevojshme për të përshkruar letërsinë që të jesh në gjendje ta organizosh, t'i japësh mundësinë kritikëve postkolonialë, që të thonë diçka për të ose të identifikojnë modele të caktuara të saj. Nga ana tjetër ato e kufizojnë disi interpretimin e kësaj letërsie, sepse përmban shumë më shumë se ky përshkrim.

Pra a do ta quaje veten një autor postkolonial dhe/ose të letërsisë botërore?

Nuk do të përdor asnjë nga këto fjalë. Nuk do ta quaja veten shkrimtar të asnjë lloji. Në fakt, nuk jam i sigurt se do ta quaja ndonjë gjë veten time përveçse me emrin tim. Besoj, nëse dikush më sfidon, do të ishte një mënyrë tjetër për të thënë "A je... ndonjë nga këta...?" me shumë mundësi do të thoja "jo". Pikërisht, nuk dua që një pjesë e imja të ketë një emër zvogëlues. Nga ana tjetër varet se si kjo pyetje bëhet, për shembull, nëse një gazetar pyet në një intervistë "A je një shkrimtar i letërsisë botërore", çfarë do të shkruajë kur të largohet nga këtu? Por unë nuk jam kjo. Jam diçka e komplikuar e saj.

A është thelbësor ky përshkrim?

Nuk është thelbësor në mënyrën si mendoj për veten time, por për gazetarët mund të jetë, ai mund të më gozhdojë dhe të thotë, ky është një shkrimtar i letërsisë botërore. Unë kështu e quaj. Ka shenja natyrale që t'i rezistosh këtyre grupeve dhe t'u japësh një përgjigje të komplikuar si kjo që po ju jap unë.

Pyetja jonë e radhës lidhet ngushtë me të kaluarën: kultura botërore shpesh ndahet në kulturë nga hemisfera Veriore dhe Jugore. Si i shihni këto etiketime, sidomos duke pasur parasysh letërsitë?

Bota nuk ndahet vërtet në Veri dhe Jug, por duket e modës të përshkruhet ashtu. Ka pasur përpjekje të hershme për të përdorur fjalë të ndryshme si "Bota e tretë" ose "Bota në zhvillim", dhe Veriu e Jugu duken pak më të buta se disa të tjera. Sidoqoftë, përpiqet të shpjegojë realitetin, ndryshimet historike dhe më në fund e heq një fjalë tjetër të shëmtuar, "kolonializëm", kështu që është më mirë të përdorësh Veri-Jug për të folur mbi këto tema. Imperializmi historik në fakt konsolidoi këto ndryshime midis të ashtuquajturit Veri dhe Jug dhe vazhdoi të bënte kështu për shkak të trashëgimisë, besoj, të këtyre ndryshimeve koloniale, të gjitha ndryshimet e vendosura dhe konsoliduara nga kolonializmi. Kështu do të doja të thoja që ka ndryshime, dhe ndërkohë që Veriu dhe Jugu nuk janë komplet të sakta, duken si mënyra më e fundit dhe neutrale e shpjegimit të këtyre ndryshimeve. Nuk duhet t'i shikosh këto terma si hapësira: ka të bëjë me qëndrimet, kuptimet, pritshmëritë, etj. Kështu shumë mirë mund të ketë pjesë të Kinës që janë po aq të pasura sa Perëndimi dhe pjesë që nuk janë. Nuk është dhe aq çështje hapësire. Kur përpiqesh të qëndrosh në mes, sërish mendon në terma hapësire, por kur mesi nuk është tamam "mes" Veriut dhe Jugut por një pozicion i ndërmjetëm ose i papërcaktuar mes këtyre dy etiketimeve. Këtu, supozoj, e vendosni veten si njerëz liberal, duke u përpjekur ta shihni veten si njerëz të botës dhe kështu, njeri. Sidoqoftë, ka ndryshime të vërteta, le të themi në terma të llojit të jetës që keni, kushdoqë të jeni, nga do që të jeni nga Veriu apo Jugu, jetën tona do të jenë të ndryshme, doni apo jo. Në këtë kulturë shteti, shoqëria dhe kultura sigurojnë gjëra për ju pa qenë nevoja të bëni gjë, spitale, shkolla, pagesa mirëqenie e kështu gjërash. Në shtete të tjera nuk kanë gjëra të tilla, kështu ka një ndryshim themelor mes këtyre vendeve, që rezulton prej shumë gjërash, nga të gjitha ndodhitë historike që kanë prodhuar këto shoqëri të ndryshme.

Në terma të çështjeve të tanishme – do të thonit se "kriza e refugjatëve" ndryshon shumë? Nëse njerëzit nga të ashtuquajturat vende Jugore vijnë në Gjermani, për shembull, ato gjithashtu ndryshojnë Gjermaninë, ashtu si shumë vende të tjera janë në procesin e ndryshimit.

Epo, nuk po them se gjërat do të mbesin kështu përgjithmonë, kështu që sigurisht, gjërat po ndryshojnë. Nga ana tjetër, çfarë ose kush mendoni se do të ndryshojë më shumë, nëse, le të themi, një milionë refugjatë vijnë në Gjermani, kush ka më shumë gjasa të ndryshojë, Gjermania apo refugjatët? Pra kjo është përgjigjja ime për këtë pyetje: në një farë pike sigurisht që do të bëjë ndryshim. Për shembull Kryeministri Britanik tha që një nga kushtet e hyrjes për cilindo refugjat ishte që të mësojë anglisht menjëherë. Ndërkohë që nuk ka ndonjë problem me këtë, që ta bësh kusht do të thotë që ata duhet të bëhen si ne kur të vijnë këtu.

Çfarë mendoni se e bën të rëndësishme letërsinë botërore për shoqërinë bashkëkohëse? A mendoni se autorët e letërsisë botërore duhet të kryejnë ndonjë detyrë të posaçme? Nëse po, si do ta përcaktonit këtë detyrë?

Nuk besoj se kjo është një kategori bindëse. Së pari do të doja të argumentoja, çfarë doni të thoni me këtë? A doni të thoni letërsi angleze, franceze dhe gjermane, ndoshta duke përfshirë letërsinë e vjetër perse e kineze, ose ndonjë letërsi tjetër të vjetër, apo do të thotë çdo letërsi në të gjithë botën? Sa e rëndësishme është letërsia në të gjithë botën? Sigurisht, në këtë rast, letërsia botërore është e rëndësishme për këdo, ndërkohë që e prodhojnë, e konsumojnë e mësojnë prej saj.

Unë njoh vetëm copa të vogla të letërsisë në botë, kështu që nuk dua të bëj një deklaratë të përgjithshme për të. Prej kësaj nuk mendoj se fraza letërsi botërore është aq e nevojshme sa për shembull "para", sepse ne përdorim para çdo ditë, është pjesë e jetës, ndërkohë që letërsia botërore nuk është. Sigurisht mund të marrësh një libër nga rafti dhe të pyesësh "çfarë mendon për këtë?" por letërsia botërore nuk mund të jetë aq krahasuese sa duket.

Cila është detyra e letërsisë botërore? Sërish varet nga çfarë doni të thoni me frazën, pyetja gjithashtu ka një dimension moral. Roli i letërsisë në botë është të ndikojë në progresin e komunitetit, por mund të varet nga komunitete specifike. Mund të thuhet se shkrimtarët duhet të sfidojnë idetë përmes komunitetit. Kjo sfidë mund të jetë kundrejt ideve të shikueshmërisë, ideve të familjes apo përshtatshmërisë, moralitetit seksual etj.. Nga ana tjetër, njerëzit mund ta shohin si mosdisiplinë, të panevojshme dhe shkatërruese. Roli i shkrimtarëve mund të gjykohet vetëm nga lexuesit e tyre. Është e vështirë. Duhet t'ia lësh shkrimtarit para se të bësh llogaritjet e tua.

Cili është qëllimi juaj personal kur shkruani dhe botoni romanet e juaja? A keni një qëllim të caktuar apo thjesht keni historitë tuaja në kokë dhe duhet t'i thoni patjetër?

Nëse thuhet qëllim, tingëllon pompoze. Dua vetëm të shkruaj aq me besim sa mundem, pa u përpjekur të them "diçka fisnike". Sidoqoftë, ka gjëra të caktuara për të cilat jam i shqetësuar dhe dua t'i eksploroj dhe të shkruaj për to. Por nuk mund të them se dua të shkruaj, për shembull, për vendin e grave në botë, pavarësisht se kjo mund të jetë një prej gjërave që më shqetëson. Një shembull teorik mund të jetë për shembull nëse do të shkruaja për martesën e motrës time, por jo t'ju



them vërtet diçka për motrën time. Një shembull tjetër ndoshta më i mirë mbi se si shkruaj për diçka është romani im "By the Sea". Filloi me impulse të ndryshme. Kur lufta në Afganistan arriti kulmin e saj në fund të viteve '90, një aeroplan arriti në Londër i cili ishte rrëmbyer nga një prej pasagjerëve. Ishte një fluturim i brendshëm, ndoshta nga Kabuli në Herat, por rrëmbyesi e bëri të fluturonte deri në Londër, ndoshta bëri një ndalesë për ta mbushur me karburant. Në lajme mund të shihje pasagjerët, të veshur sikur nuk ishin përgatitur të udhëtonin për në Europë por ndoshta të shihnin familjen brenda vendit, fëmijët, persona të ndryshëm, dhe rrëmbyesi u tha autoriteteve se ata donin azil, edhe pse nuk ishte ajo që donte shumica. Një ditë më vonë, të gjithë ata kërkuan azil, dhe unë pyeta veten se çfarë donte vërtet ai burrë i moshuar. A e kuptonte çfarë po kërkonte? Azili për mua ishte diçka për njerëz të rinj, ose dhe familje, por jo për njerëz të moshuar. Unë fillova të mendoj për arsyet e tij, për arsyet e përgjithshme për ta lënë vendin mëmë dhe të kërkosh azil, pavarësisht se e kisha menduar këtë në përgjithësi edhe më parë. Por në këtë kontekst, një burrë i moshuar duke kërkuar azil, doja të dija ç'lloj dëshpërimi do të ishte i nevojshëm që ta bënte këtë gjë. Disa ditë më vonë pash një program në televizor, një dokumentar mbi punën e një oficeri emigrimi, i cili ndiqej nga kamerat në punë. Mund të shihje këtë oficer emigrimi që merrte në pyetje një aplikant, dikush që arriti për azil, dhe u interesova se çfarë bënte ai. Mund të të bëjë të mendosh më shumë për këtë temë, pastaj merr një libër nëse nuk je interesuar më parë në këtë temë, dhe pastaj mendja jote fokusohet dhe gradualisht ndërton një çështje dhe më në fund fillon të shkruash. Epo, po them në thelb kjo lloj gjëje ndodhi te "By the Sea". Dhe pastaj më shumë detaje mblidhen në mendjen tënde. Dhe ndoshta të merr dhe një vit. Ndërkohë bën gjëra të tjera, këto gjëra përmbysen dhe bën një shënim aty këtu dhe fillon të shkruash dhe më pas vijnë më shumë detaje dhe pastaj gjërat thjesht vijnë spontanisht. Pra po shkruan ndërkohë që punon. "Ah, mund të shoh një lidhje këtu mes kësaj dhe asaj, le ta afrojmë...", dhe gjërat fillojnë të zhvillohen në këtë mënyrë. Pra kjo është një përgjigje e gjatë për pyetjen tënde.

Sa punuat në total me "By the Sea"? I njohim detyrat e juaja të tjera, sigurisht, por nga idetë e juaja të para për këtë roman deri sa u botua, sa e gjatë ishte kjo periudhë?

U botua në 2001... Mendoj se e mbarova së shkruari në fund të 1999. Do të thoja se procesi i të shkruarit zgjati rreth një vit, një vit e pak, dhe më pas duhet një vit deri sa një botues të thotë, po, në rregull, e dua këtë libër dhe ti nënshkruan një kontatë, e deri sa shfaqet në librari, nëse nuk ka diçka që botuesit duan ta ndryshojnë, nëse nuk ka nevojë për rishikime të tjera. Kështu, në rastin e "By the Sea", ishte rreth një vit, por ndonjëherë duhet dhe më shumë kohë, sidomos për dikë si mua që jetonte në Brighton dhe jepte mësim në Canterbury, udhëtoja para-mbrapa çdo ditë, pakashumë. Mendoj se pati një ditë përgjatë semestrit, kur nuk më duhej të shkoja në punë dhe munda të mos punoja dhe të shkruaja



njëkohësisht, sepse nuk kisha energji mjaftueshëm për ta bërë. Kështu të shkruarit duhet të priste rastin, por të shkruarit në vetvete nuk merr kohë të gjatë kur i ke gjithë skicat paraprake gati. Të duhet më shumë kohë të bëhesh gati, të organizosh idetë në kokën tënde. Kur arrin në pikën se je i sigurt që mund të fillosh të shkruash, ose të paktën nga eksperienca ime, të duhet rreth një vit e pak, pastaj fillon të shpresosh që botuesi dhe redaktori nuk duan të ndryshojnë pjesë të shkrimit, pasi kjo mund të marrë dhe një vit tjetër në varësi të kohës që gjen për ta bërë, nëse ke angazhime të tjera... mund të ketë kaq shumë gjëra të tjera sa nuk mund të gjesh hapësira më të gjata se dy orë, aq sa është koha që të duhet që të futesh sërish në atë gjë e ta rinisësh. Rishikimi mund të jetë një proces i gjatë, siç mund të jetë dhe vetë procesi i të shkruarit.

Ndërkohë që mendon për idetë që ke në kokë, çfarë rolesh luan kujtesa në procesin krijues, kujtesa juaj personale, ndoshta dhe e familjes ose ndonjë kujtesë kolektive?

Epo ka të bëjë me kujtesën por jo veçanërisht me kujtesën në sensin e të mbajtjes mend të gjërave që më kanë ndodhur mua apo anëtarëve të familjes time. Nuk mendoj se kam shkruar ndonjë histori që tregon të vërtetën sipas një kujtese të caktuar, por fragmente të vogla mund t'i referohen diçkaje që i ka ndodhur një të afërmi ose dikujt që njoh. Së fundmi, historia nuk shfaq të vërtetën, por një detaj i vogël mund të jetë diçka që kam përjetuar ose dëgjuar, mund të shohësh paralele, lidhje, edhe pse mund të varet nga historia që shkruan. Një shkrimtar historish me struktura specifike formale si një shkrimtar i romaneve me detektivë, romaneve dramatike, ku ka gjëra të caktuara që duhet të ndodhin, mund ta bëjë këtë ndryshe nga një shkrimtar i cili nuk i ndjek këto struktura formale. Nuk ndodh sikur mendon "histori e bukur, do ta përdor", por mund të shohësh një lidhje me idetë e tua, diçka që mund të shpjegojë një gjë tjetër në kokën tënde, ose të zgjerojë kuptimin tënd mbi dhe gjërat ecin përpara. Problemi është, që përmes këtij procesi mund të humbasësh sensin e çfarë ndodhi në të vërtet apo çfarë imagjinove se do të ndodhte, dhe ndonjëherë i mendon gjërat sikur kanë ndodhur por në fakt nuk kanë ndodhur – sapo i kishe shpikur, ose njerëzit të thonë gjërat që kanë ndodhur dhe ti i thua që jo sepse ti e ke ndryshuar kujtesën tënde mbi këtë gjë. Mund të jetë e krahasueshme me ëndrrat: nëse ke imagjinuar diçka, dhe ndodh në të vërtetë dhe askush nuk ta sfidon, gjashtë vite më vonë, ajo është e vërteta. E ke harruar historinë e vërtetë, dhe kështu funksionon imagjinata dhe kujtesa, kujtesa është shumë e rëndësishme, i bën gjërat e vërteta, por jo në mënyrën që të jep një histori të tërë që ta shkruash.

Si do ta shpjegonit marrëdhënien Jug-Jug në letërsi?

Përshkrimi i marrëdhënieve Jug-Jug në letërsi nuk është diçka e re. Kur dikush thotë që vepra ime është e interesuar te Oqeani Indian, për shembull, kjo është tashmë një temë Jug-Jug, ideja e një historie të ndërlidhur dhe kulture në zonën e Oqeanit Indian, kam qenë duke shkruar për këtë temë në trillimet e mia që nga fillimi dhe te



disa nga punimet e fundit akademike. Është diçka në vazhdimësi, kryesisht për idenë tonë si kozmopolitanë të cilët nuk janë të qendërzuar në Perëndim, kështu ndërkohë që papritur bëhet një frazë e nevojshme për disa njerëz, në të vërtetë është diçka që vazhdon prej kohësh.

Së fundmi – a ka diçka ose dikë që ka ndikuar në stilin tuaj të të shkruarit ose në interesimin tuaj për të shkruar trillime në veçanti?

Nuk do ta thoja kështu. Ndoshta nuk është diçka që kam thënë se do të doja të bëja në një moshë të caktuar, unë thjesht arrita në një moshë të caktuar dhe mendova me veten time se kjo është diçka që unë do të kisha dëshirë të bëja, siç ishte për shembull të shkoja në Angli me vështirësitë e të qenurit në atë moshë dhe lëvizja nga një vend në tjetrin. Të qenurit i huaj, jetesa mes vështirësive për të gjetur rrugën time, braktisja e shtëpisë, gjëra të tilla më kanë ndikuar. Nuk jam si Virginia Wolf, e cila e dinte që në moshën dhjetëvjeçare që donte të ishte shkrimtare. Thjesht e gjeta veten duke shkruar këto gjëra një ditë, siç bëjnë njerëzit zakonisht, dhe gjeta faqe të tjera që ndërtoheshin nga këto ide dhe më pas erdhi pika ku mendova: Çfarë është kjo? Çfarë po bëj me këtë? Dhe aty arrin ndryshimi mes të mbajturit të gjërave shënim dhe të shkruarit. Unë shkruaj diçka dhe më pas më duhet ta organizoj, kështu që është më shumë se sa thjesht të shkruash pasi duhet ta flasësh nga trupi yt. Në një pikë u duk si roman, mund të vijë si një proces i tillë, dhe pastaj duhet të provosh ta përmirësosh dhe pasi i përkushtohesh, nuk ke nga t'ia mbash, përpiqesh të bëhesh më i mirë dhe fillon të gjesh një botues e kështu me radhë... dhe pastaj je shkrimtar.

Shumë faleminderit për kohën tuaj. Ishte një intervistë e këndshme! Faleminderit

Intervistë nga Fabienne Roth, Mara Hlzenthal and Lisa Zingel (Frankfurt, 21 janar, 2016).
Përktheu Enxhi Hudhri

NGA VIJMË? ÇFARË JEMI? KU PO SHKOJMË?

Dr. Bledar Kurti

Nga vijmë? Çfarë jemi? Ku po shkojmë? A nuk është kjo dilema e çdo njeriu? A nuk është kjo esenca e ekzistencës sonë njerëzore? Dhe, a nuk e ka munduar ajo njerëzimin përgjatë gjashtë mijë viteve qytetërim? Mbretër e faraonë, perandorë e filozofë, njerëz të ditur e vdekatarë të zakonshëm e kanë shtruar këtë pyetje me gojë, me penë, me mendje apo me ndjesi të brendshme, pa gjetur ende një përgjigje, duke u dorëzuar ndaj kësaj torture ekzistenciale të pashmangshme, thjeshtë faktike.

Ndër shekuj krishterimi i ishte përgjigjur me lehtësi kësaj pyetje: ne vijmë nga vende qiellore, jemi krijesa të Perëndisë, e do përballemi sërish përpara fronit të Tij, ndaj artistët evropianë nuk e konsideruan të nevojshme ta përdornin këtë temë në artin e tyre, përkundrazi, të vetëdijshëm për origjinën dhe statusin e njeriut, e përdorën artin si ilustrim të kësaj historie me origjinë hyjnore, por, pas lindjes dhe zgjerimit të Iluminizmit në Evropë, artistët nisën të përqendroheshin tek emocionet dhe mendimet e brendshme. Dhe, shtyrë edhe nga lëvizja e Romantizmit në letërsi e art, e cila promovonte ndjenjat dhe individualizmin, dukej më joshëse dhe më artistike, e padyshim më trilluese, që emocionet dhe frika e brendshme të integroheshin me tematikat më të rëndësishme të ekzistencës njerëzore.

Vepra *Nga vijmë? Çfarë jemi? Ku po shkojmë?* (D'où Venons Nous / Que Sommes Nous / Où Allons Nous, 1898) është piktura më e shquar e Paul Gauguin (1848-1903) dhe simbol i tre kohëve të ekzistencës njerëzore. Vetë Gauguin dha një përshkrim të hollësishëm të imazheve ezoterikë të pikturës në një letër, shkruar në shkurt të vitit 1898 ku ai e vetë e përmend këtë integrim të romantizmit me Ungjillin:

> *Kjo është një kanavacë katër metra e pesëdhjetë centimetra në gjerësi, dhe një metër e shtatëdhjetë centimetra në lartësi. Dy qoshet e sipërme janë ngjyrë të verdhë kromi, me një mbishkrim në të majtë dhe emrin tim në të djathtë, porsi një afresk, qoshet e të cilit janë prishur prej kohës, dhe që aplikohet mbi një mur të artë. Në të djathtë në pjesën e poshtme, gjenden një fëmijë i fjetur dhe tri gra që qëndrojnë të ulura në gju. Dy figura të veshura me ngjyrë vjollce ndajnë mendimet e tyre me njëra-tjetrën. Një figurë madhështore, jashtë të gjitha proporcioneve dhe e bërë kështu në mënyrë të qëllimshme, ngre krahët dhe i vështron ata me habi, ata të cilët guxojnë të mendojnë për fatin e tyre. Një figurë në qendër po këput një fryt. Ka dy mace pranë një fëmije. Një dhi e bardhë. Një idhull, krahët e të cilit ngrihen plot mister në një lloj ritmi, duket se tregojnë të Përtejmen. Pastaj së fundi, një grua e vjetër në prag të vdekjes duket se pranon gjithçka, e dorëzuar ndaj mendimeve të saj. Ajo e përfundon historinë! Në këmbët e saj gjendet një zog i çuditshëm i bardhë, duke mbajtur një hardhucë në kthetrat e tij, që përfaqëson kotësinë e fjalëve ... Kështu që unë kam mbaruar një tablo filozofike me një temë të krahasueshme me atë të Ungjillit.*

Vepra *Nga vijmë? Çfarë jemi? Ku po shkojmë?* është një tablo me përmasa të mëdha. Ajo ka sfond të errët por ngjyrat e disa figurave janë të ndezura dhe të guximshme. E gjithë vepra duket tejet enigmatike, e pikturuar në leckë të ashpër dhe të rëndë që përdorej për të qepur thasët. Piktura përmban figura të shumta njerëzore, shtazore dhe simbolika të pozicionuara në një peizazh ishullor. Deti dhe malet vullkanike të Tahitit janë të dukshme në sfond. Paul Gauguin ka kombinuar elemente paganë dhe të krishterë, duke ndër-këmbyer mite biblike në një mjedis polinezian të Paqësorit. Figurat kanë kuptime simbolike dhe misterioze të cilat mund t'i përgjigjen pyetjeve të parashtruara nga titulli i veprës. Dhe, porsi një pergamenë e shenjtë e shkruar në një gjuhë të lashtë, piktura duhet lexuar nga e djathta në të majtë: nga foshnja e fjetur, e cila mundohet t'i japë përgjigje pyetjes *Nga vijmë?* - në figurën kryesore në qendër, si përgjigje e Çfarë jemi? - duke përfunduar në të majtë me gruan plakë të gjunjëzuar e dorëzuar – pra, *Ku po shkojmë*.

Ngjyrat janë të errëta, por me shpërthime të verdhës dhe blusë. Figurat e Gauguin shpalosen të largëta, indiferente, hieratike, të frikshme. Ato qëndrojnë shtrirë ose të ulura në një botë që është pa ajër dhe çuditërisht jashtë kufijve. Në mënyrë jo të pazakontë për tablotë e tij, disa prej figurave i kthejnë shpinën shikuesit, shikojnë larg, e të përhumbura. Për shkak se ai jetonte në Tahiti, skena e tablosë paraqitet si një parajsë tahitiane duke krijuar kështu bërthamën e temës së pikturës.

"Thelbi i një vepre qëndron pikërisht në atë që nuk shprehet," shkroi ai. Dhe kjo vepër nuk shpreh asgjë në mënyrë të qartë, por me enigmën dhe misterin e saj shpaloset si një përmbledhje e ideve të artistit dhe si një ilustrim i betejës artistike në vigjilje të shekullit të 20-të, periudhës më moderne të historisë.

Gauguin iu referua kësaj vepre edhe si një shprehi e fortë e pasionit të tij. Në një letër të vitit 1898 ai shkruan kështu për këtë pikturë:

> *Njerëzit do thonë se kjo vepër është e kryer pa kujdes, dhe që duket e papërfunduar. Është e vërtetë që artisti e ka të vështirë të gjykojë punën e vet, megjithatë unë besoj se kjo tablo jo vetëm ua kalon veprave të mia të mëparshme, por që nuk kam për të pikturuar ndonjë tjetër më të mirë sesa ajo, apo të ngjashme me të.*

Gratë në tablo kanë shprehje pasive, madje ato duken të nënshtruara, tipike e vendeve të kolonizuara. Të zhveshura e primitive ato shpalosen si objekte të kënaqësive tokësore, por edhe një lloj "zgjimi shpirtëror" i artistit. Në fakt i gjithë shekulli 19-të ishte një zgjim për artistët. Të sfiduar nga shpikjet e shumta dhe të irrituar e rebeluar ndaj industrializimit, hijes së rëndë të makinerive mbi brishtësinë e natyrës, artistët u shpërngulën nga qendrat urbane të qyteteve, në kërkim të vendeve të paprekura nga njeriu, e të pa rrënuara nga industria. Edhe jeta sociale dhe argëtimi nisi të zhvendosej në periferitë e qyteteve. Njerëzit e zakonshëm nisën t'i kalonin fundjavat në fshatrat përreth, duke bërë banjë në liqene e lumenj, duke vozitur me varka, apo duke bërë shëtitje në lëndina. Artistët ndjenë shtysën të arratiseshin nga jeta industriale dhe nisën të kërkonin parajsën e tyre krijuese, e të ndërmerrnin një udhëtim në kohë, drejt primitives, në kërkim të origjinës së pa ndotur e të paprekur nga vrazhdësia njerëzore. Këtë arrati dhe pelegrinazh Gauguin e nisi jashtë Parisit dhe e përfundoi në Tahiti, në Detet Jugorë të Paqësorit, për t'u shndërruar vetë në një njeri primitiv por në një artist i cili kapërceu caqet e guximit.

Thirrja e artit e çoi Paul Gauguin në zemrën e 'primitivizmit'. Kjo fjalë buron nga fjala e vjetër franceze *primitif*, që do të thotë "e para, origjinalja", e cila rrjedh nga fjala latine *primitivus*, që do të thotë "e para, ose më e hershmja e një lloji." Dhe në fakt, arti primitiv dallohet qartë në këtë vepër, por mund të konsiderohet edhe si e para, më e hershmja e llojit të vet, një themel i fortë i artit dhe perceptimit modern që do karakterizonte shekullin e 20-të.

Një nga shtysat për arratinë e Gauguin në vende aq të largëta ishte edhe përvoja e vështirë që ai kishte kaluar gjatë qëndrimit në Arles me Vincent van Gogh, e sidomos incidenti i prerjes së veshit. I tronditur nga shpërthimi i dhunshëm emocional i Van Gogh-ut, kur u largua prej tij dhe u kthye në Paris, vetëm dy ditë më pas, Gauguin u bë dëshmitar i një spektakli të dhunshëm. Ai pa ekzekutimin publik të vrasësit të shquar me emrin Prado. Ai ekzekutim përfundoi edhe më keq se sa mund të pritej. Gijotina nuk ra mbi qafën e Prados por i preu vetëm hundën. I burgosuri, duke ulëritur nga dhimbja e paimagjinueshme, u de-

tyrua të pozicionohej sërish, vuri qafën aty ku duhej dhe tehu i gijotinës e kreu më në fund punën për t'i prerë kokën.

Prerje veshi, hunde dhe koke brenda pak ditëve, duket se ishin një arsye e fortë për artistin të largohej nga Franca moderne e të shkonte larg në kërkim të prehjes shpirtërore dhe frymëzimit artistik.

Paul Gauguin ishte një njeri dhe artist paradoksal. Ai lindi në Paris por e kaloi fëmijërinë e tij në Lima, Peru. Në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare u kthye në Francë dhe punoi si marinar, më vonë si toger, në anije të ndryshme tregtare dhe udhëtoi në Amerikën e Jugut, Norvegji, Danimarkë dhe në të gjithë Mesdheun. Më pas ai punoi si agjent tregtar për një bankë parisiene. Ai jetoi një jetë borgjeze dhe ishte një biznesmen i suksesshëm. U martua dhe jeta e tij familjare ishte e qetë, e kënaqshme dhe e begatë. Në vitin 1883, në mënyrë krejt të papritur, ai e braktisi punën e tij në bursë dhe financë për t'u kushtuar tërësisht ndaj pikturës. Rrjedhimisht, të ardhurat e familjes u zvogëluan me shpejtësi dhe kështu ai vendosi të braktiste bashkëshorten dhe fëmijët e tij.

"Po shkoj për në Panama për të jetuar si një njeri i egër," i shkroi ai gruas së tij, "po marr bojërat dhe penelat e mia me vete dhe atje unë do të zhytem i tëri në natyrë, larg nga të gjithë njerëzit." Por me të arrirë në Panama ai ndjeu shtysën të shkonte në Martinikë, ku gjeti një parajsë të vërtetë. Atje ai jetoi si një fëmijë i egër, e tërhiqej vazhdimisht nga dëshira për të shkuar gjithnjë e më larg në zonat e thella. Ndaj edhe teksa jetonte në Tahiti ai u strehua në një fshat njëzetë e pesë milje nga kryeqyteti, e shumë shpejt dëshironte të shkonte edhe më larg në të panjohurën primitive. Dhe më pak se një vit pas shpërnguljes së tij ai shprehu dëshirën për të shkuar në ishullin Dominikan (Hiva-Oa) në Markezë, "një ishull i vogël ku ka vetëm tre evropianë dhe bregdeti oqeanik është më pak i prishur nga qytetërimi evropian," shkroi ai. Dy vjet para vdekjes së tij, ai arriti të shkonte të jetonte në izolim të plotë, duke u bërë një me natyrën. Tre muaj para se të vdiste ai shkroi, "jam i kënaqur, këtu në vetminë time."

Gauguin rridhte nga një familje e krishterë. Mësimi i katekizmit që në fëmijëri duket se manifestohet edhe tek titulli i veprës *Nga Vijmë? Çfarë jemi? Ku po shkojmë?* pasi është tejet e ngjashme me pyetjet e katekizmit, si për shembull: *Kush të krijoi ty? Cilët janë prindërit tanë? Çfarë do ndodhë me të drejtin? Çfarë është parajsa?* etj. Që në fëmijëri ai ishte njohur me historitë mbi vuajtjen dhe sakrificën e Krishtit, ndaj ai e konsideronte vuajtjen si një element të ngjashëm me atë të Krishtit. E duket qartë në pikturat dhe letrat e tij që ai lulëzonte nga vuajtjet dhe vështirësitë, duke pëlqyer të jetonte me ato sesa pa ato. Vuajtjet e bënin të ndihej një artist i vërtetë, i përvuajtur, e jo dikush që bënte kompromis me rehatinë dhe jetën moderne.

Vështirësitë e Gauguin ishin si ekonomike ashtu edhe artistike. Ai jetoi pjesën e fundit të jetës në varfëri të plotë. Por, vështirësitë që ai hasi ishin të vetë-krijuara, ndaj edhe ai u shndërrua menjëherë në një simbol dhe u vlerësua më shumë se sa kolegët e tij artistë. Ai ishte idealisti që hoqi dorë nga siguria financiare, braktisi rehatinë e shtëpisë, të gruas dhe të fëmijëve, la pas miqtë dhe vendlindjen për të ndjekur një vizion artistik që mund të realizohej vetëm përmes vuajtjes. Dhe sot ai njihet si artisti i cili për të ndjekur thirrjen e artit, u nda nga familja dhe refuzoi të bënte punë të zakonshme jashtë fushës së artit. Për të, vlerat themelore të shoqërisë së asaj kohe ishin kundër traditës romantike të artistit ndaj edhe ai jetoi në arrati duke kërkuar një jetë më të thjeshtë e të pa korruptuar nga qytetërimi perëndimor.

Por, ai nuk e gjeti kurrë atë lloj jete. Shëndeti i tij ishte tejet i dobët dhe i ligë, financat e tij ishin katastrofë dhe vajza e tij e preferuar, Aline, vdiq nga ethet, në moshën 19 vjeçare. Gauguin ishte larguar nga qytetërimi, por tre pyetjet e paraqitura nga artisti në këtë vepër përmbledhin atë që çdo individ i çdo qytetërimi përpiqet për të kuptuar: cili është kuptimi i jetës?

Me marrjen e lajmit të vdekjes së vajzës, ai vendosi t'i jepte fund jetës së tij, por më parë do të pikturonte kryeveprën *Nga vijmë? Çfarë jemi? Ku po shkojmë?* Ai punoi ditë e natë, i sëmurë e nën ethe të shumta. Me të përfunduar pikturën, ai piu arsenik për të vrarë veten por mbijetoi.

Gruaja e tij nuk mundi ta falte kurrë për braktisjen që ai i bëri dhe për varfërinë në të cilën gjendej familja, ndërsa Gauguin nuk mundi të shpëtonte dot nga vetmia e tij. Pasi la familjen e vendosi të merrej me art ai i shkroi gruas: "Ti ke fëmijët me vete, bashkatdhetarët e tu, vëllezërit dhe motrat e tua, shtëpinë tënde". Më pas ai përmendte se atij i mungonin fëmijët, dhe se trishtohej nga fakti që ata nuk i shkruanin, as edhe një kartolinë nuk i dërgonin, as për ditëlindjet e tij. Kur mori lajmin e vdekjes së vajzës ai shkroi me një ton paradoksal vetë-vuajtje dhe arrogance artistike, e cila e karakterizonte atë gjithmonë: "Lajmi nuk më tronditi, pasi jam mësuar prej kohësh me vuajtjet, por pastaj dita-ditës, kur kujtimet më riktheheshin, plaga hapej gjithnjë e më thellë, dhe në këtë moment që po shkruaj unë jam plotësisht i dekurajuar." Në një letër tjetër ai shkroi: "Të gjithë dashurojnë sipas mënyrës së tyre, sepse për disa dashuria bëhet më e fortë në varr, ndërsa për të tjerët - nuk e di. Varri i saj gjendet larg, bashkë me lulet, gjithçka është një iluzion. Varri i saj është këtu pranë meje; lotët e mi janë lule të gjalla." Kjo ishte letra e tij e fundit, e cila kurrë nuk mori përgjigje nga gruaja e tij. Në vitin 1902 ai i shkroi një miku: "Unë ende nuk kam marrë asnjë lajm nga gruaja ime dhe fëmijët e mi më njohin gjithnjë e më pak. Ç'të bësh! Plaga po shërohet pak nga pak në vetminë time.

Si artist Gauguin njihet në histori si një nga figurat më të rëndësishme të artit dhe botëkuptimit modern, por si njeri ai ishte tejet kompleks dhe ndoshta i papëlqyer. Edhe Vincent van Gogh e përmend me dyjëzim natyrën e personalitetit të Gauguin. Në një letër drejtuar të vëllait Theo, Van Gogh e përshkroi atë si dikush që bën "gjëra që unë dhe ti nuk do t'i bënim kurrsesi, sepse ne kemi ndërgjegje". Megjithatë, në një kontekst tjetër, ai deklaroi se shoku i tij kishte "vlera më shumë si njeri sesa artist."

Gauguin nuk është njeri i lehtë për t'u pëlqyer. Nga shkrimet e tij dhe dëshmia e bashkëshortes, miqve dhe bashkëpunëtorëve të tij ai na shfaqet figura e një maniaku dhe një ngacmuesi vetë-mëshirues. Ai jetoi fantazitë e tij artistike dhe mashkullore e dyshohet se vdiq nga sifilizi ose overdoza. Shpesh i çuditshëm dhe i zjarrtë, i guximshëm dhe i çuditshëm. Ai ishte i kobshëm në çdo gjë përtej ambicieve të tij artistike. Ai ishte gjithnjë në kërkim të Kopshtit të Edenit të kohëve moderne dhe pelegrinazhi i tij shoqërohej nga një aureolë romantizmi, enigme, primitivizmi, simbolizmi, minimalizmi, dhe ekspresionizmi. Në veprat e tij vërehet atmosfera arkaike por edhe penelatat e guximshme të cilat manifestohen me trupa femërore të egra, me qenë të zi, rozë apo me ngjyrë portokalli, me pemë ngjyrë blu, e peizazhe larg industrisë e dëmit njerëzor e më pranë vetë natyrës.

Për Gauguin, periudha e jetës në Paqësor ishte artistikisht më revolucionarja. Tahiti ishte për të si Kopshti i Edenit. Ai ndihej si Adami dhe figurat femërore të zhveshura ishin porsi Eva e egër ende teksa ecte lakuriq, pa turpin mbi veten, me të gjithë bukurinë e saj kafshërore, por me një buzëqeshje ironike në buzët e saj e cila na shfaqet në çdo tablo të artistit, herë duke na parë enigmatikisht e herë e përhënur në indiferencën e saj.

Ai vetë ndihej si një njeri i egër, i arratisur nga qytetërimi dhe kjo dallohet lehtë teksa shpaloset në artin e tij të thjeshtëzuar. Me primitivizmin e tij ai e urrente simetrinë, ndaj edhe guxoi të kritikonte qytetërimin grek, ikonën e simetrisë dhe gjeometrisë. "Gabimi i madh i historinë është Greqia" mendonte ai. Egjipti, Persia, Kamboxhia, druri japonez, imazhet e Epinalit, sipërfaqet e sheshta dhe linjat e guximshme, këto ishin ato që ai preferonte, dhe qytetërimet e tjera i konsideronte si derivate të atyre primitive. Ai dëshironte të minimizonte mjetet e tij. Ishte gjithmonë në kërkim të formës së thjeshtëzuar. Si një *peintre maudit* (piktor i mallkuar) dhe artist "i arratisur", ai kundërshtoi fuqishëm realitetin e jashtëm, racionalizmin e madje mbarë qytetërimin perëndimor. Por sado u largua nga qytetërimi ai ndihmoi në ecurinë dhe përshpejtimin e modernizmit në artin dhe qytetërimin perëndimor, e sa më shumë ai i referohej primitives aq më shumë ndikonte në themelimin e një botëkuptimi avant-garde. Dhe ai e bëri këtë jo vetëm përmes figurave por edhe sipas qasjes ndaj artit, e cila buronte nga imagjinata në trurin e artistit, dhe askund tjetër, dhe nga ku arti shpalosej edhe më i fortë sepse krijohej nga brenda artistit. Dhe ishin këto elementë, origjina, imagjinata dhe burimi i brendshëm, ato që mbizotëruan artin dhe botëkuptimin e shekullit të 20-të, të cilin ai e preku vetëm për pak vite.

Sot Gauguin njihet si një prej etërve të artit modern. Ai e hodhi poshtë traditën e natyralizmit perëndimor, duke përdorur simbole abstrakte. Ai theksoi modelimet lineare dhe harmonitë e kontrasteve të ngjyrave, duke i mbuluar pikturat e tij me një ndjenjë të thellë misteri. Evropianët i konsideruan barbare dhe të egra tablotë e tij, dhe kjo ishte pikërisht ajo që kërkonte Gauguin. Ai ndihej krenar kur e quanin *barbar*. Por, vepra *Nga vijmë? Çfarë jemi? Ku po shkojmë?* nuk pëlqehej e nuk preferohej nga blerësit dhe humbi për shumë vite. Emri i Paul Gauguin u harrua për tre vite pas vdekjes por më pas mori famën e zuri vendin që meritonte në historinë e artit.

Arti na shpalos fytyrat e tij për të na komunikuar një mesazh. Me këtë vepër arti na tregon udhëtimin e njeriut modern pas në kohë, dhe se si ai zbulon ende edhe sot po të njëjtin mister, dilemë, dhe yshtje, dhe na fton të gjejmë përgjigjen e asaj pyetje e cila e ka shoqëruar njerëzimin gjatë të gjithë epokave, *Nga vijmë? Çfarë jemi? Ku po shkojmë?*

(Post scriptum: Për Shpresa Beqiri, mësuesen time e cila që në fëmijëri më frymëzoi të përjetoj magjinë e ngjyrave e të eci në gjurmët e mistershme të artit.)

TIRANA – GATE 2021, FESTIVALI NDËRKOMBËTAR LETRAR I TË RINJVE

Me rastin e Festivalit Ndërkombëtar Letrar të të Rinjve "Tirana-Gate 2021" në datat 8-10 tetor 2021, Tirana do të kthehet në një pikëtakim me lexues, autorë, përkthyes, shtëpi botuese e kritikë letrarë.

Ky festival është një projekt i realizuar nga Instituti i Librit dhe i Promocionit në kuadër të një projektit rajonal READ (Rrjeti Rajonal për Dialog Ndërkulturor) i mbështetur nga Bashkimi Europian.

Në të marrin pjesë autorë nga vendet ballkanike. Gjithashtu pjesë e festivalit do të jenë autorë nga Europa, fitues të çmimit prestigjioz ndërkombëtar European Union Prize in Literature, ku edhe Shqipëria bën pjesë me 3 autorë të saj.

Ky festival trazon për mirë jetën e kryeqytetit me temën "Kufijtë, shtëpia, identiteti, qendra dhe periferia" , me panelet e diskutimit mes shkrimtarëve të Europës Qendrore dhe Ballkanit Perëndimor. Në tridhjetë vite ky rajon po përballet me histori të ngjashme, shkëputjen nga regjimet totalitare dhe histori arratie e dëbimi.

Do të flasim për librin-pasaporta jonë europiane, fqinjësinë, për Tjetrin, e ndryshëm, por dhe të ngjashëm përmes autorëve dhe fjalës së shkruar dhe të përkthyer bukur.

Festivali e kthen Tiranën në një shtëpi të madhe mikpritëse idesh, vizioni dhe emocioni, jo vetëm për autorët, por edhe për të gjithë pasionantët e rinj, sepse ka meritën, jo thjesht të një festivali, por të një atmosfere artistike me të gjitha moshat.

Autorët pjesëmarrës, fitues të EUPL: Laura Freudenthaler, Tom Kuka, Jan Carson, Nikos Chrysos, Lidija Dimkovska, Ben Blushi si dhe autorët e përvojës dhe çmimeve ndërkombëtare : Besnik Mustafaj, Rita Petro, Bashkim Shehu, Diana Çuli, Zija Çela, Ylljet Aliçka, Fatos Kongoli, Robert Ëilton, Virgjil Muçi, Manjola Nasi, Ndriçim Ademaj, Mehmet Berk Yaltik, Alban Tufa, Renis Hyka.

Përkthyesit pjesëmarrës: Ben Andoni, Milena Selimi, Maniela Sota, Maklena Nika, Irena Nasi.

Mes të tjerash do të diskutohet edhe për eksperiencat e përkthimit, tejçimit të Tjetrit dhe gjuhës së tij në Tënden dhe gjuhën tonë. Në vijim, disa nga eksperiencat e këtij procesi, treguar nga vetë përkthyesit.

***

Sfida e përkthimit të romanit "Ditë e re", të autorit Nikos Chrysos

Nga Maklena Nika

Të përkthesh nga njëra gjuhë në tjetrën është një nga ushtrimet më delikate intelektuale. Të marrësh një copë nga Greqia dhe ta vendosësh brenda anglishtes pa derdhur asnjë pikë, një sfidë e madhe, do të thotë Cyril Connolly për përkthimin letrar. E njëjta gjë ndodh edhe me përkthimin e "Ditës së re" të Nikos Chrysos në gjuhën shqipe, këtij romani shumëfaqësh që ndërthur në vetvete teknika të ndryshme rrëfimi, që shtresëzohen në një fjalor të pasur intelektual, letrar, filozofik apo të rëndomtë. Është një rrëfim me gjerësi dhe thellësi të madhe që të vendos përpara një sfide të re të Ditës së Re, dhe të bën të kuptosh se duke përdorur të njëjtat fjalë nuk është një garanci e mjaftueshme e të kuptuarit; duhet të përdorësh të njëjtat fjalë për të njëjtën gjini të eksperiencës së brendshme, duhet të kesh të njëjtën eksperiencë me autorin, sipas Nietzche-s. Ky libër nuk është një libër për të gjithë lexuesit apo përkthyesit, por për ata që durojnë, për ata që kanë kohë, për ata që nuk gjejnë kënaqësi në gjërat minimaliste, por janë në kërkim të diçkaje tronditëse, diçkaje pabesueshmërisht dinamike, diçkaje të paparashikueshme.

Përballë këtyre sfidave e gjeta veten si përkthyese e "Ditës së re", një eksperiencë unike kompromisesh në përpjekjen për të qënë letrare dhe idiomatike. Të lexosh rreth 700 faqe është një ndërmarrje e jashtëzakonshme intelektuale, por të përkthesh 700 faqe me një arkitekturë të veçantë rrëfimi, bazuar në Dhiatën e Re, në personazhet e saj, disi të ndërkombëtarizuar për të qenë më të kuptueshëm edhe në përkthimet në gjuhët e tjera (psh. Laki, një ndër personazhet kryesore personifikon fatlumin, i huazuar nga Lukasi si personazh biblik), është vërtet një nga bashkëidentifikimet më të vështira përkthimore me veprën në origjinal.

Në komunikimet e vazhdueshme me vetë autorin, Nikos Chrysos, i cili për fatin tim të mirë ishte gjithmonë i pranishëm dhe i disponueshëm gjatë procesit të përkthimit, arrita të kuptoja se bëhej fjalë për një kombinat ngjarjesh, të ndërthura ndërmjet tyre me një mjeshtëri të jashtëzakoshme gjuhësore. U gjenda përballë një leksiku shumëdimensional, pjesë të huazuara nga Dhiata e Re, fjalor rrugësh, dialekte të ndryshme të gjuhës greke, përshkrime të papërsëritshme të shpirtit njerëzor, të atij shpirti që ka njohur dhimbjen, urinë, të ftohtin e rrugës, të nxehtin e asfaltit dhe magjinë e ujërave detare. M'u desh të gjeja fjalët e duhura në gjuhën shqipe, të lojërave të fjalëve bazuar në përsëritje bashtingëlloresh apo zanoresh, të fjalëve të rralla të gjuhës greke, që nuk ekzistojnë as në fjalorë, të gjeja zgjidhjet më të përshtatshme të kombinimeve gjuhësore, të jepja të gjitha ngjyrimet e një fjale të përdorur në mënyra të ndryshme në tekst, apo të gjeja fjalën apo termin e përshtatshëm në gjuhën shqipe sipas ngjyrimit të përdorur në gjuhën greke (psh. në të gjithë tekstin, është përdorur vetëm një herë fjala e vjetër greke për fjalën e vjetër shqipe - *tabut*, ndërsa në pak vende është përdorur fjala turke *qivur* dhe në më të shumtën e herëve kam përzgjedhur të përdor fjalën *arkëmort* dhe disa herë arkivol, sipas konotacioneve përkatëse në gjuhën greke).

Përshkrimet analitike dhe të detajuara të disa fushave të veprimtarive njerëzore, si detari, tekstile, peshkim, legjislacion, gazetari, etj.më vunë përballë vështirësisë, por edhe sfidës me vetveten për të gjetur termat e duhura në gjuhën shqipe, jo rrallëherë sfilitëse. Përballë boshtit kryesor rreth të cilit shtjellohen të gjitha historitë e romanit, Limanit, duhet të qëndrosh dhe të ndjesh të gjitha përjetimet e personazheve, historitë e tyre rrëqethëse, fjalorin e tyre shumëngjyrësh, të cilin duhet pikë së pari ta perceptosh dhe ta ndjesh, pastaj ta deshifrosh dhe ta shqipërosh.

Përkthimi i këtij romani ka qënë një botë e re për mua, bota e vërtetë, ajo e rrugës, ajo e përderësve, ajo e tragjedisë së jetës njerëzore, e mbijetesës, e luftës ndaj urisë, e prostitucionit, e krimit, e ndëshkimit të vetvetes për një krim të ndodhur që kthehet në një makth të vërtetë për njërin nga personazhet kryesorë.

Sipas Chomsky-t, gjuha është një proces i një krijimi të lirë; ligjet dhe parimet e saj janë të njohura për të gjithë, por mënyra që përdoren këto parime është e lirë dhe e ndryshme për këdo. Për përkthimin e Ditës së re" u bashkëidentifikova me autorin, me të gjithë personazhet e veprës, perceptova dhe kuptova botën e tyre të brendshme shpirtërore, nevojat e tyre, pritshmëritë e tyre nga jeta, ndërgjegjen e tyre, dhe mbi të gjitha ndërgjegjen e njeriut "që ka uri, që mërdhin, që ka frikë", por që e ka kuptuar se çdo ditë e re është e kundërta e vdekjes.

***





"Tili" - Vallëzim letrar mbi tel

Nga Anna Kove

Njohja me Daniel Kehlmann, autorin e "Tilit"

Ishte qershori i vitit 2015; atë muaj të bukur gjendesha në rezidencën e shkrimtarëve dhe përkthyesve LCB në Berlin. Përveç punës individuale dhe krejt në izolim, në ato ambiente të denja pune, siç i kanë hije letërsisë së sërës, kisha fatin të ndiqja pasditeve aktivitet e rëndësishme letrare që organizonte Kolegjiumi i Letrarëve të Berlinit. Ishte data 30 qershor dhe po shijoja orët e fundit në Berlin. Atë pasdite në *open air*, buzë liqenit në Wannsee, së bashku me shkrimtarin amerikan Teju Cole, rezident edhe ai në LCB, do të zhvillohej një takim me shkrimtarin Daniel Kehlmann, i njohur dhe i përkthyer në atë kohë thuajse në të gjithë botën për librin e tij "Matja e botës". E gjithë lëndina e bukur dhe shumë e madhe mbi liqen u mbush plot me adhurues të letërsisë së Kehlmann-it, me lexues dhe adhurues të letërsisë në përgjithësi. Isha e magjepsur. Për mua që vija nga një vend si Shqipëria, ishte çudi e madhe, si mund të mblidheshin aq shumë njerëz në një shesh a park, pa qenë tubim politik; vetëm për letërsinë disa qindra e qindra vetë, madje edhe të paguanin biletën e hyrjes? M'u duk se deri atëherë s'kisha parë njerëz më të bukur. U ulën si mundën, ca mbi stola e ca mbi bar. Në duar kishin të gjithë libra të autorit, të cilët prisnin autografin në fund të takimit. Autori s'ishte atë qershor më shumë se 40 vjet, ishte i ri, ishte i famshëm dhe njëkohësisht shumë mbresëlënës për modestinë para lexuesve të vet. Romani "Tili" nuk ishte shkruar ende. "Tili" lindi në 2017-n. Po përktheja aso kohe nobelisten Herta Müller dhe s'kisha pse të mos e mendoja veten përkthyese të këtij autori të ri e të talentuar të gjuhës gjermane, që po magjepste gjithë botën me romanet e tij. Madje edhe të rinjtë. Madje, ata më tepër.

Si jetova me "Tilin", kur bota u mbyll

Pastaj erdhi viti 2020. Shtëpia botuese "Toena" vendosi ta bënte "Tilin" të njohur për lexuesin shqiptar pikërisht përmes përkthimit tim. Tili, gaztori, akrobati, zhongleri, magjistari, kishte dy vjet që vallëzonte tashmë nëpër botë mbi litarin e tij prej ekuilibristi. Në 2020-n, madje ishte në vitin e tij më të suksesshëm të vallëzimit letrar, pasi atë fillimviti ai libër u shpall si një nga më të mirët, pjesë e listës së shkurtër për çmimin e madh letrar "International Booker Prize 2020", njëkohësisht bestseller nga "Spiegel". Isha shumë e lumtur që magjistari Til do të fliste shqip. E dija, po ashtu, se nuk ishte shumë e lehtë. Libri ishte voluminoz. Në faqet e tij kalonte lufta 30-vjeçare mes katolikëve dhe protestantëve në shekullin e 17-të, jo vetëm në Gjermani, por në të gjithë Europën Qendrore; ai realiteti historik përcillej edhe përmes shumë personazheve të rëndësishme të historisë së asaj kohe, për të cilët duhet të lexoja unë shumë, që të mos mërzitej lexuesi më pas.

Çdo punë e tillë kërkon izolimin e përkthyesit nga realiteti për t'u futur i plotë në realitetin e veprës. Por rasti i përkthimit të "Tillit" do të ngelet unik besoj në të gjithë përvojën time si përkthyese, në atë që ka shkuar dhe në atë që do të vijë. Të tillë izolim besoj se askush nuk e kish provuar asnjëherë. Nga data 10 mars, dita kur filloi përkthimi, dhe deri ditën kur mbaroi, këmbët e mia nuk bënë asnjë hap fizik jashtë dere, por vallëzonin edhe ato mbi litarin letrar të Tilit. Izolimi total i gjithë botës prej pandemisë, bëri që të zhytem më thellë brenda realitetit të personazheve, që fati i kishte ndëshkuar edhe ata të jetonin përmes dramave më të mëdha, që historia

u ka hedhur përjetësisht mbi shpinë njerëzve të saj: luftëra, persekutime, gjyqe të inskenuara, inkuizicion, pamundësi për t'u mbrojtur, malarie dhe epidemi të tjera; uri, deformimin psikologjik, dhunimin, përçmimin, mashtrimin. Dhe ashtu faqe pas faqeje, i thosha vetes se duhet të mos dorëzohesha as unë brenda shtjellës së të keqes së madhe që na pllakosi, dhe të atyre të këqijave që paskëshin qenë gjithmonë aty në historinë e njerëzimit: jo, jo tani, mos u dorëzo, sa të mbarosh edhe faqen e fundit.

Si ndodh ta duash dikë që s'e beson?

Mos i beso këtij tregimtari, më thërriste së brendshmi edhe mua zëri që shungullonte brenda faqeve të librit. Po, po, mos i beso Tilit, figurës emblematike, që paraqiti një realitet të tërë historik, siç ia deshi qejfi. Po unë e ndiqja shqip gjuhën e tij, të fjalëve dhe të trupit, e ndiqja si në jerm, ashtu siç ndiqet në fakt vetëm një magjistar. Tili luante me historinë, me realitetin, me të vërtetën, luante me të gjithë; luante edhe me mua. Por, loja është aq argëtuese, aq e zgjuar dhe tërheqëse, saqë do të pëlqeni edhe ju të mashtroheni, ashtu siç më pëlqeu edhe mua të mashtrohem nga faqja e parë gjer në të fundit. A na mërzit historia brenda faqeve të romanit? Autori ynë e lë mjeshtërisht kuadrin historik të paprekur. Ai vërtet përshkruan disa ngjarje kryesore të historisë; aty njerëzit më të shquar të kohës, mbretër dhe mbretëresha, princër e princesha shfaqen personalisht; disa mizori të tyre na bëjnë të dridhemi, por ato nuk janë në qendër të vëmendjes. Aspak. Fokusi i këtij romani janë njerëzit e thjeshtë, thelbi i tyre, jeta e tyre e përditshme në një epokë, barrën e hidhur të së cilës ata e mbartin pa qenë në gjendje të shohin përmes kuptimit të saj, e lëre më të ndikojnë në të. Jemi ne, o miq, njerëzit e sotëm, treqind vjet më vonë; njësoj të pafuqishëm përballë ca forcave të çuditshme, që gjithkush mund t'u verë emrin që do. Thjesht kanë ndryshuar sipërfaqshëm rrethanat historike dhe shoqërore. Thelbi është i njëjtë.

Abstrakti - si fillim apo si fund

Qendra e këtij romanit është Tili, personazhi i titullit, tharmi letrar i Kehlmann-it fillon me të. Sigurisht që aludon te Til Eulenspiegel, figura mitologjike e njohur, mashtruesi i librit të famshëm popullor të vitit 1510. Ky Tili ynë është shumë i ndryshëm nga gaztori treqind vjet më i ri prej tij. Ky është një personalitet shumë më kompleks, ka një biografi të vërtetë, shndërrohet në një provokator dhe komentator cinik. Sipas krijuesit të tij, vetë Kehlmann-it, ai është një figurë "demoniake". Terreni i shumimit është një botë që po copëtohet nga largimi prej Mesjetës së vazhdueshme në kohërat e pasigurta moderne. Themeli i stilit të Kehlmann-it në këtë libër është sintaksa rrjedhëse e pakomplikuar, fjalori i thjeshtë, por me shumë shtresa, zgjedhja e fjalëve me mençuri, në mënyrë që strukturimi i tyre të jetë i aftë për ta orientuar lexuesin drejt efektit. Trillimi dhe historia, fantazia, faktet dhe misteri, magjia dhe realiteti e bëjnë këtë libër të pangjashëm me askënd që kemi lexuar deri më tash. Përshkrimet e gjalla ndjesore dhe zbavitëse, ironia e lehtë, e pazakontë dhe humori, sidomos kur gjërat bëhen shumë serioze, sigurojnë lehtësi e kënaqësi leximi dhe tërheqje estetike të padiskutueshme, që të ngelet gjatë në kujtesë. Shumë gjatë.

***

Mbi romanin "Histori shpirtrash"
Nga Irena Nasi

Të përkthesh Laura Freudenthaler

Shkrimtarja austriake, Laura Freudenthaler, është një autore e re, e cila pasi ka shkruar vetëm disa vepra, si: vëllimin me tregime "Kafka e Madalenës", si edhe romanet "Mbretëresha hesht" dhe "Histori shpirtrash", ka arritur të krijojë një stil të shkruari të vetin me një zë shprehës dhe të patjetërsueshëm, të cilin kritikët e letërsisë e quajnë stili *Freudenthaler*. Një stil i përmbajtur, por që me çdo rrokje dhe fjali të shkurtër, arrin të depërtojë në thellësitë më të panjohura të shpirtit.

Romani "Histori shpirtrash", botuar në vitin 2019, u nderua po atë vit me çmimin "Europian të Letërsisë". Në këtë roman, Laura Freudenthaler shkruan për pianisten 50-vjeçare, Anën, dhe skenaristin Tomas. Romani rrëfehet nëpërmjet botës së brendshme dhe ëndërrimtare të personazhit kryesor. Ana pesëdhjetëvjeçare, pianiste dhe njëkohësisht mësuese pianoje, tashmë ka lënë prej dy dekadash vendlindjen e saj, Parisin, për t'u vendosur në Vjenë, qytetin ku jeton partneri i saj, Tomasi.

Dikur Ana krijon bindjen se Tomasi ka një lidhje të fshehtë. Dhe është ky momenti, kur fillojnë e shkrihen kufijtë ndërmjet realitetit dhe fantazisë. Në plan të parë kjo si ide për të shkruar një roman mund të mos duket shumë origjinale, por si gjithmonë në letërsi, kjo varet nga mënyra se si tregohet. Laura Freudenthaler zgjedh një perspektivë ngacmuese, me anë të së cilës ajo ndërlidh pamjen brenda me atë jashtë.

Për mua si përkthyese sjellja në shqip e këtij romani, ka qenë një udhëtim tejet interesant, edhe pse plot sfida, ndërmjet Vjenës dhe Salzburgut, në një prej liqeneve ku çifti kishte një shtëpi pushimesh, ku ata shkonin për t'iu larguar zhurmës dhe tollovisë së kryeqytetit. Shtëpia e pushimeve për Anën ishte vendi, ku ajo vinte shpirtin në qetësi.

Autorja arrin me mjeshtëri të na shkëpusë nga realiteti nëpërmjet dyshimeve të Anës për marrëdhënien e fshehtë të Tomasit; realiteti me fantazinë janë dy perspektiva të ngërthyera me njëra-tjetrën, saqë shpesh edhe brenda një kapitulli më duhej të mendohesha disa herë për të përcjellë në shqip ndjesinë e vërtetë të autores. Deri në faqen e fundit të romanit kufiri ndërmjet realitetit dhe fantazisë mbetet i paqartë, dhe për mua si përkthyese ishte e rëndësishme të imagjinoja se ku mbaronte njëri dhe fillonte tjetri. E përpos narrativës mjaft komplekse dhe të thellë të autores, të arrija të depërtoja në imagjinatën e saj për të kuptuar, nëse *vajza* (të dashurën e fshehtë të partnerit të saj, Ana e quante *vajza*) është një krijesë e fantazisë së saj, apo ekziston vërtet?

***

Mbi romanin "Gërsheti"
Nga Blerta Hyska

Përvoja e përkthimi të romanit "Gërsheti" është së pari një përvojë leximi. Thuhet që përkthyesi është lexuesi më i mirë i veprës që përkthen, ai familjarizohet me tekstin, i rri pranë për njëfarë kohe, i njeh pikat e forta dhe të dobëta. Kështu ishte kur lexova dhe propozova për përkthim romanin "Gërsheti" të autores Laetitia Colombani. Në gjuhën e botimeve, ky libër është një *bestseller*, i përkthyer në të gjithë botën. Paradoksalisht, kam një si lloj mosbesimi ndaj librave që bëjnë kaq shumë bujë, pa i lexuar mendoj se nuk kanë kushedi ç'vlerë, është thjesht efekt marketingu etj. Përpiqem të gjej ndonjë perlë të rrallë, më pak të ekspozuar, por që meriton vëmendjen e lexuesit. Kështu që me kokëfortësi rezistova pa e lexuar. Por në një nga ato të dielat kur nuk të bëhet asgjë, më shkoi mendja dhe e fillova ta lexoja, sigurisht pa e ulur nivelin e vigjilencës dhe mosbesimit. Por tani mund ta pohoj se ky libër ishte një befasi e këndshme. Pa pretenduar të jetë kryevepër letërsie, ai të bën për vete me mënyrën e përkorë që ka zgjedhur autorja për të trajtuar personazhet, pastaj në një plan të dytë me historitë që ajo rrëfen në lidhje me ta. Kur lexoj një libër, përpiqem të ndiej stilin e shkrimtarit ose shkrimtares, nëse më sjell një atmosferë tjetër apo më krijon një gjendje të caktuar shpirtërore. Kurse intriga apo ngjarja për mua është dytësore. Te romani "Gërsheti", të gjitha këto elemente janë dozuar në masën e duhur, stili është mjaft fluid, ka ritëm, ka emocion gjithashtu. M'u duk gjetje e bukur lidhja që krijon shkrimtarja me tri personazhet gra, nga tri kontinente të ndryshme, dhe që ajo i ka përshkruar si luftëtare, secila në llogoren e saj. Nuk mund të mos ndiesh frymëzim dhe dëshirë për ta ndarë këtë libër me sa më shumë lexues, për t'i përfshirë edhe ata në këtë ndërthurje të bukur të fateve të tri grave. Ato përballen me fatin e tyre, me brishtësinë e ekzistencës dhe refuzojnë të pësojnë fatalitetin që jeta do t'u imponojë. Ato vendosin të thonë "Jo" dhe kjo iu jep energjinë që u duhet për të ecur përpara.

Autorja do të thotë se pak rëndësi ka vendi ku ndodhet, gruaja shpesh detyrohet të pranojë situata që i imponohen kur i refuzohet mundësia për të ëndërruar. Edhe pse romani i parë i autores, ai vjen fuqishëm, sepse e tillë është fuqia e imagjinatës dhe fatet që ndërlidhen. Puna e përkthimit u lehtësua nga thjeshtësia e të shkruarit, saktësia dhe fluiditeti nëpër rreshta. Humanizmi që përshkon historitë e tri personazheve është universal, dhe si i tillë qëndron pa mundim në gjuhë të ndryshme të botës.

***

Mbi përkthimin e romanit "Zjarrvënësit" të autores Jan Carson
Nga Maniela Sotaj

Doktori Xhonatan Mëri ka frikë se e bija e tij e porsalindur mund të mos jetë aq e padëmshme sa duket. Semi Ënju po lufton me të kaluarën e tij të errët dhe ka frikë se dhunën që ka në gjak e ka trashëguar edhe tek i biri.

Qyteti është në flakë dhe autoritetet po humbasin kontrollin e situatës. Ndërsa gjendja kalon në kaos dhe kufijtë midis fantazisë dhe së vërtetës, të drejtës dhe të gabuarës, fillojnë të mjegullohen, kë do të zgjedhin të mbrojnë këta dy baballarë?

Në sfondin e një vere të nxehtë dhe të çuditshme në Belfast, romani tejet magjik i Carson-it "Zjarrvënësit", është historia e dy baballarëve, të cilët, në mënyra krejt të ndryshme, kanë frikë nga fëmijët e tyre: Semi i trembet djalit të tij Mark që komploton nga dhoma e tij e gjumit në papafingo dhe Xhonatani nga e bija, e cila mund të ketë trashëguar fuqitë e çuditshme të nënës së saj. Ndërkohë Belfasti po digjet në flakë, i frymëzuar nga një *YouTuber* misterioz, i cili nxit moshatarët e tij të rrethojnë kufijtë e lartësisë gjashtë metra duke ndezur zjarret e mëdha të korrikut.

Ashtu si në pjesën më të madhe të shkrimeve të saj të mëparshme, Carson ndërthur së bashku fantastiken me të përditshmen në "Zjarrvënësit". Përse i pëlqen asaj realizmi magjik? "Unë arrij në një pikë të caktuar me realizmin dhe thjesht mendoj, a mund të shkojmë edhe pak më larg? A ka ndonjë shtresë tjetër? Po sikur ajo të fluturonte? Po sikur të zhdukej? Dhe kështu, është si një lojë brenda meje, të cilës i pëlqen të shtyjë kufijtë e asaj që mundem."

Ajo mendon se rrënjët e interesit të saj për fantastiken shtrihen në edukimin e saj fetar në fëmijëri. "Cilado qoftë forma kryesore e gjuhës së rrëfimit që mësoni, ajo është si gjuha juaj e parë," thotë ajo. "Absurdi dhe surrealja, - shton ajo, - mund të jenë një mënyrë efikase për të eksploruar çështje të mëdha".

Heronjtë e saj janë "njerëz si Gabriel Garcia Marquez, të cilët përdorin absurdizëm, metafora dhe figura për të thënë disa gjëra vërtet të vështira, që do të kishin qenë tepër të rënda për ta, nëse do t'i thoshin drejtpërdrejt."



LIBRI PASAPORTA

EUROPIANE

FTESË

FESTIVALI NDËRKOMBËTAR LETRAR I TË RINJVE
"TIRANA-GATE 2021"

me pjesëmarrjen e autorëve më në zë shqiptarë dhe europianë

8 - 9 - 10 tetor 2021
Salla "Unesco", Muzeu Historik Kombëtar

Ceremonia e çeljes - 8 tetor, ora 10:30
Hyrja e lirë

#CreativeEurope4Books

Organizator — ILP Instituti i Librit dhe i Promocionit · Ministria e Kulturës · Bashkia Tiranë · Regional Network for Cultural Diversity · Me mbështetjen e Programit "Europa Krijuese" të Komisionit Europian · Botimet Toena · RTSH Radio Televizioni Shqiptar · Ambasada Austriake Tiranë · ExLibris · Yunus Emre Enstitüsü — Bashkëpunëtor